REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROGRAMI I REFORMAVE EKONOMIKE
2017-2019

Janar 2017

Tabela e përmbajtjes

1. KUADRI I PËRGJITHSHËM I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT 3
2. KUADRI MAKROEKONOMIK 5
   2.1. Zhvillimet e fundit ekonomike 6
   2.2. Skenari makroekonomik afatmesëm 7
   2.3. Skenarë alternativë dhe risqet 19
3. KUADRI FISKAL 21
   3.1. Implementimi i buxhetit për 2016 21
   3.2. Perspektiva buxhetore afatmesme 31
   3.3. Bilanci strukturor 36
   3.4. Niveli i borxhit dhe zhvillimet 38
   3.5. Analizë e ndjeshmërisë dhe krahasimi me programin e mëparshëm 48
   3.6. Qeverisja fiskale dhe kornizat buxhetore 51
4. REFORMAT STRUKTURORE PRIORITARE NË 2017-2019 52
   4.1. Identifikimi i pengesave kyçe për rritjen dhe konkurrueshmërinë 52
   4.2. Përmbledhje e reformave prioritare 52
   4.3. Analizë sipas fushave dhe reformat strukturore prioritare 53
      4.3.1. Menaxhimi i financave publike 53
      4.3.2. Energjia, transporti dhe tregjet e telekomit 55
      4.3.3. Zhvillime sektoriale 63
      4.3.4. Klima e biznesit dhe ulja e ekonomisë informale 68
      4.3.5. Kërkim dhe inovacion 72
      4.3.6. Tregtia e jashtme dhe lehtësimi i investimeve 75
      4.3.7. Arsimi dhe aftësitë 79
      4.3.8. Punësimi dhe tregu i punës 83
      4.3.9. Përfshirja sociale, ulja e varfërisë dhe shanset e barabarta 87
5. IMPLIKIMET BUXHETORE TË REFORMAVE STRUKTURORE 91
6. ÇËSHTJE INSTITUCIONALE DHE ANGAZHIMI I GRUPEVE TË INTERESIT 97

ANEKSI 1 – TABELAT E PROGRAMIT TË REFORMAVE EKONOMIKE 98

ANEKSI 2 – KONTRIBUTET E JASHTME TEK ERP 2017-2019 137

1. KUADRI I PËRGJITHSHËM I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT

Rruga drejt qëndrueshmërisë ekonomike dhe konsolidimit fiskal, në përputhje me objektivat e integrimit të Bashkimit Evropian dhe me kërkesat për rritje të qëndrueshme, i kane dhënë forme modelit ekonomik dhe reformave të marra përsipër nga Qeveria e Shqipërisë gjatë 3 viteve të fundit. Shqipëria ka bërë përpjekje drejt krijimit të një ekonomie tregu të mirë strukturuar e afte për të përballuar presionet e konkurrueshmërisë dhe forcave të tregut pasi t'i jetë bashkuar BE-së.

Programi i Reformave Ekonomike të Shqipërisë 2017-2019 nënvizon politikat kryesore makroekonomike dhe ato fiskale duke synuar të vendosë një balancë të qartë midis forcave të brendshme dhe kërcënimeve nga jashtë, për të mundësuar rritje të qëndrueshme, rritje të punësimit dhe ulje të borxhit publik. Për më tepër, ERP paraqet dhe reformat strukturore prioritare të parashikuara nga Qeveria e Shqipërisë për periudhën afatmesme për të rritur prodhimin e brendshëm, për të stimuluar investime të reja dhe për të siguruar rritje të qëndrueshme dhe konkurrueshmëri. Prioritetet e Qeverisë Shqiptare janë të orientuara kah konsolidimit fiskal dhe përmirësimit të menaxhimit të shpenzimeve publike, uljes së deficitit infrastrukturor, reformës rregullatore dhe institucionale dhe përmirësimit të sistemeve të mbrojtjes sociale. Reformat e propozuara janë projektuar për të adresuar pengesat e rritjes dhe të konkurrueshmërisë, ndërkohë duke i mundësuar Shqipërisë të konkurrojë dhe të marrë pjesë në zinxhirët e vlerave rajonalë e ato globalë.

Politikat ekonomike të 3 viteve të fundit kanë gjeneruar rritje, duke shënuar rikuperim nga 2014, megjithëse rritja e qëndrueshme është një objektiv që ende duhet arrirë. Gjenerimi i punësimit të sigurt, përmirësimit të përhershëm të standardit të jetesës së shqiptarëve dhe një ekonomie më konkurruese, e aftë për t'u integruar në zinxhirët e vlerave evropiane, janë në thelb të reformave ekonomike. Si rezultat i reformave të ndërmarra, parashikimi ekonomik pritet të vazhdojë të përmirësohet në periudhën e ardhshme afatmesme. Pritshmëritë e Qeverisë Shqiptare janë konfirmuar nga Përfundimet e Përbashkëta të Dialogut Ekonomik dhe Financiar midis BE dhe vendeve të Ballkanit dhe Turqisë në Maj 2016. Shqipëria po përjeton një ngritje graduale ekonomike që pritet të vazhdojë në 2017-2019. Në shifra, rritja ekonomike pritet të përshpejtojë duke kapur 3.8% (2017) dhe 4.1% (2018).

Politika fiskale në afatmesëm do të jetë rreptësishtë e orientuar kah konsolidimit fiskal. Konsolidimi fiskal dhe ulja e deficit publik janë të nevojshme për të ulur vulnerabilitetet që vijnë nga borxhi, të cilat pengojnë rritjen dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike. Konsolidimi fiskal do të vazhdojë në 2017 dhe 2018 duke synuar deficitin fiskal prej 2% dhe 1.8% përkatësisht të PBB-së. Konsolidimi fiskal dhe reformat e tjera të ndërmarra në këtë drejtim kontribuan për herë të parë që prej 2010 për të ulur borxhin si pjesë e PBB-së në 2016 dhe ulja pritet të vazhdojë me ritme të qëndrueshme. Borxhi publik parashikohet të zbresë në 71.4% të PBB në 2016, 69.1% në 2017 dhe 66.5% në 2018.

Reforma në energji dhe transport – të diversifikosh mënyrat e ndërlidhjes (konektivitetit) për Shqipërinë dhe t'i afrohesh korridoreve ekonomike – janë kyçe për një rritje ekonomike të qëndrueshme, rritje të konkurrueshmërisë dhe mbështetje të uljes së kostove të transportit dhe konektivitetit për produktet shqiptare. Prandaj, Shqipëria ka thelluar, reformat në këto fusha dhe siç u paraqitën edhe në ERP-in e mëparshëm.

Reformat strukturore prioritare burojnë nga buxheti afatmesëm dhe dokumentet strategjike kombëtare, duke pasqyruar sfidat e ekonomisë shqiptare në të njëjtën kohë duke ofruar të formojmë zgjidhje për pengesat e rritjes. Reformat e planifikuara janë në linjë me SKZHI 2015-202, strategjitë sektoriale, PBA, ligjin e buxhetit për 2016 dhe dokumente të tjera strategjike si SEE 2020, SBA etj. Reformat strukturore kane një qasje të balancuar midis nevojës për të rritur aftësitë në treg dhe për të përhapur/shpërndarë kontribuuesit e prodhimit, për të siguruar një integrim të lehtë të ekonomisë në tregjet rajonale dhe evropiane. Reformat e propozuara janë një përgjigje ndaj analizave dhe rekomandimeve të BE-së për Shqipërinë nëpërmjet Raportit për Shqipërinë 2016, Raporti Ekonomik i OECD 2016, Raporti Doing Business, Raporti Konkurrueshmëria Botërore etj. te cilat shërbejnë si një bazë e mirë për diagnostikën dhe reformat potenciale. ERP 2017-2019 përfshin një gamë të gjerë të reformave strukturore, të plotësuara me masa të buta dhe investime në infrastrukturë.

Reformat e planifikuara janë një përgjigje ndaj nevojës për të adresuar rekomandimet specifike ndaj vendit propozuar Shqipërisë nga Përfundimet e Përbashkëta të Maj 2016. Disa prej reformave janë vazhdim i reformave të ERP 2016-2018 të pasuruara me prioritete të reja për periudhën në vijim. ERP 2017-2019 përmban 19 reforma strukturore në të gjitha fushat e metodologjisë së ERP ku përfshijnë investime dhe masa të buta në infrastrukturë (liberalizimi I mëtejshëm e I tregut të energjisë; gazifikimi; studim fizibiliteti për korridorin Adriatik-Jonian; rehabilitimi dhe ndërtimi i segmentit hekurudhor Durrës-TIA-Tiranë; infrastruktura broadband) reforma strukturore etj.

Zhvillimi i sektorit privat vazhdon të mbetet një prioritet dhe ky ERP vijon zbatimin e reformave të propozuara në

ERP 2016. Fokusi mbetet ulja e pengesave rregullatore ndaj biznesit, përmirësimi I aksesit në financë përmes zbatimit efektiv te planit kombëtar për uljen e nivelit të kredive të këqija, përmirësimit të kapaciteteve institucionale për kërkim dhe inovacion etj. Tregtia dhe investimet, si pjese integrale e axhendës rajonale dhe të procesit të Berlinit adresojnë nevojat primare për të lehtësuar tregtinë në nivel kombëtar – në kufi dhe përtej kufijve – përmes zbatimit efektiv të planit kombëtar për lehtësimin e Tregtisë 2017-2020, ndërkohë duke rregulluar nevojat kombëtare dhe prioritete me axhendën rajonale të lehtësimit të tregtisë dhe konektivitetit. Thithja e IHD-ve, si një rezultat fundor i të gjitha përpjekjeve të investuara nga Shqipëria, që synon diversifikimin e prodhimit të potencialit eksportues dhe rritjes se potencialit eksporteve, mbeten prioritet i reformave strukturore. Me qëllimin për t'iu bashkuar zhvillimit në politikat rajonale të investimeve, Shqipëria do te fokusohet ne ERP 2017 ne krijimin e një regjimit te unifikuar për investimet, përmes hartimit të një ligji të ri për investimet. Për me tepër, shërbimi *after care* do të forcohet më tej përmes reformës së propozuar mbi investimet.

Përmirësimi i aftësive në tregun e punës dhe forcimi i përfshirjes sociale, janë paraqitur në këtë ERP përmes reformave për të përmirësuar cilësinë dhe trajtimin e AFP-së, duke siguruar kështu lidhje me tregun e punës, modernizimin e shërbimeve publike të punësimit, rritjen e numrit të grave të punësuara, të rinjve dhe njerëzve në nevojë, forcimin e mbrojtjes sociale dhe masat e përfshirjes sociale, hartimin dhe zbatimin e kurrikulës bazuar në kompetenca dhe trajnimin e mësuesve. Reformat e propozuara për ERP 2017 në këtë fushë janë një vazhdim i ERP 2016.

Përgatitja e ERP 2017-2019 ishte rezultat i një bashkëpunimi të gjatë, konstruktiv dhe frytdhënës midis anëtarëve të grupit ndërinstitucional të punës, me përfaqësues nga institucione të ndryshme të Qeverisë dhe Bankës së Shqipërisë (BSH). Procesi i përgatitjes së ERP është paraprirë nga prezantime të veçanta të organizuara në bashkëpunim me OECD dhe Komisionin Evropian. Tryeza të veçanta dhe takime të dedikuara janë mbajtur edhe për të diskutuar metodologjinë, pengesat për rritjen dhe përcaktimin e fushave, si dhe metoda mbi përcaktimin e përparësive të masave reformuese. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) ka monitoruar progresin dhe zbatimin e reformave të paraqitura të Programit të Reformave Ekonomike Kombëtare të Shqipërisë 2016-2018 në (ERP 2016) për të lejuar vazhdimin logjik të reformave dhe për të siguruar qëndrueshmëri në agjendën prioritare të reformave përveç kësaj, rekomandimet e Konkluzioneve të përbashkëta të Dialogut Ekonomik dhe Financiar ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë janë monitoruar dhe trajtuar në këtë ERP, për të treguar progres dhe për të siguruar vazhdimësi.

MZHETTS, si institucioni lider në përgatitjen e ERP 2017-2019, ka konsultuar gjerësisht programin me donatorët dhe institucionet ndërkombëtare, shoqërinë civile, akademikët, shoqatat e biznesit dhe Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, me qëllim për të pasuruar dokumentin me opinione dhe qasje të palëve të ndryshme. Konsultimi me shoqërinë civile, shoqatat e biznesit dhe Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë u zhvillua në datën 28 dhjetor 2016 dhe takimi me organizatat ndërkombëtare dhe donatorët, të cilët mbështesin disa nga reformat e ndërmarra, në datën 11 janar 2017. Dokumenti i ERP 2017-2019 është depozituar për shqyrtim në Kuvend gjatë muajit Janar 2017, në vijim të takimeve konsultuese me shoqërinë civile dhe partnerët për zhvillim dhe integrim.

2. KUADRI MAKROEKONOMIK

Rritja globale është parashikuar në 3.4 për qind në vitin 2016, me një përmirësim të lehtë prej 3.1 për qind nga viti 2015. Parashikimi i rishikuar me një rënie prej 0.1 pikë përqindje për vitin 2016 dhe 2017 në krahasim me muajin prill, reflekton një pikëpamje më të ndrydhur për ekonomitë e zhvilluara si pasojë e zgjedhjeve të muajit qershor në Mbretërinë e Bashkuar në favor të largimit nga Bashkimi Evropian (Brexit) dhe rritjes më të dobët se sa pritej në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto zhvillime kanë ushtruar presion të mëtejshëm duke ulur normat e interesit global ndërkohë që politika monetare pritet të mbetet akomoduese për më gjatë. Edhe pse tregu ndërkombëtar pas tronditjes së Brexit ishte i qetë, ndikimi përfundimtar mbetet i paqartë, pasi fati i marrëveshjeve institucionale dhe tregtare ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar dhe Bashkimit Evropian është i pasigurt.

Ndjeshmëria e tregut financiar përkundrejt ekonomive në zhvillim është përmirësuar me pritshmërinë e normave më të ulëta të interesit në vendet e zhvilluara, e cila ka ulur shqetësimin rreth perspektivave afat-shkurtra të Kinës lidhur me politikat mbështetëse për rritje dhe ngrirjes së çmimeve të mallrave. Megjithatë perspektivat ndryshojnë ndjeshëm nëpër vende dhe rajone me zhvillimin e Azisë në përgjithësi dhe të Indisë në veçanti duke treguar një rritje të fuqishme, ndërkohë që vendet në Afrikën nën-Sahariane po përjetojnë një rënie të fortë.

Në vendet e zhvilluara, një pikëpamje e ndrydhur me paqartësi të konsiderueshme dhe me risk negativ, mund të nxisë pakënaqësi të mëtejshme politike duke i hapur rrugë politikave anti-integruese. Disa nga ekonomitë dhe tregjet në zhvillim vazhdojnë të përballen me sfida të mëdha të politikës në përshtatjen me çmimet e ulta të mallrave. Këto perspektiva shqetësuese krijojnë nevojën për një përgjigje urgjente me anë të një politikë të gjerë për rritje ekonomike dhe për menaxhimin e dobësive.

Në vitin 2015, Inflacioni i Çmimeve të Konsumit në vendet e zhvilluara shënoi vlerën 0.3 për qind, duke regjistruar një nga nivelet më të ulëta që nga kriza globale financiare. Inflacioni shënoi një rritje deri në 0.5 për qind në gjysmën e parë të vitit 2016, ndërkohë që përgjatë kësaj periudhe ndikimi në inflacion nga çmimet e lëndëve djegëse u zvogëlua edhe më shumë. Inflacioni ka përjetuar rritje dhe rënie gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016 në shtetet e Euro zonës. Në shtator të vitit 2016 inflacioni regjistroi një nivel pozitiv prej 0.4%, ndërsa në muajin nëntor (dy muaj më pas) u regjistrua një nivel negativ prej -0.1%. Ndërkohë, për muajin dhjetor të vitit 2016 EUROSTAT vlerëson një nivel pozitiv prej 0.5% (në terma mujorë). Ndërkohë, në lidhje me kursin e këmbimit, Euro ka treguar një zhvlerësim të lehtë kundrejt monedhave kombëtare të shteteve në zhvillim. Një sërë arsyesh mund t'i atribuohen të tilla si paqëndrueshmëria politike dhe masat ushtarake të ndërmarra nga vendet e BE-së të cilat janë kërcënuar apo janë ndjerë të kërcënuara nga sulmet terroriste. Gjithashtu kjo situatë ka vijuar nën këtë klimë edhe për shkak të një niveli të ulët të importeve dhe të burimeve intensive për investim; si dhe nga të ardhurat e ulëta nga një sërë mallrash eksporti dhe nga kërkesa vazhdimisht e dobët e vendeve me ekonomi të zhvilluar. Ekonomia e shteteve të Euro zonës u rrit me 0.3 për qind gjatë tremujorit të tretë (korrik-shtator të vitit 2016), me një ritëm të njëjtë si një tremujor më parë dhe në përputhje me vlerësimet paraprake të EUROSTAT. Konsumi familjar dhe shpenzimet publike ishin nxitësit kryesorë të rritjes, ndërsa investimet fikse ngadalësuan ndjeshëm dhe kërkesa e jashtme neto kontribuoi negativisht. Në anën e shpenzimeve, konsumi familjar u rrit me 0.3 për qind dhe shpenzimet e qeverisë u rriten me 0.5 për qind gjatë tremujorit të tretë të 2016. Ndërkohë, formimi i kapitalit fiks bruto u rrit me ritëm të ngadaltë prej 0.2 për qind dhe ndryshimet në inventar shtuan 0.1 p.p. për zgjerim gjatë tremujorit të tretë të 2016-ës nga -0.2 p.p. në tremujorin e dytë të të njëjtit vit. Kontributi i tregtisë së jashtme ishte negativ, me eksportet në rritje me 0.1 përqind dhe importet në rritje më të shpejtë prej 0.2 për qind gjatë tremujorit të tretë të 2016-ës duke treguar një ritëm pozitiv si tremujorin e mëparshëm.

Në anën e prodhimit, industria u rrit me 0.4 për qind përgjatë tremujorit të tretë të 2016-ës nxitur nga prodhimi (me +0.3 për qind nga -0.1 për qind në tremujorin e dytë të të njëjtit vit). Ndërtimi u rrit me 0.5 për qind në tremujorin e tretë të 2016-ës nga -0.1 për qind në tremujorin e dytë të të njëjtit vit. Për sa i përket shërbimeve, gjatë tremujorit të tretë të 2016-ës, prodhimi u rrit për: tregti, transport, akomodim dhe aktivitete të shërbimit të ushqimit (+0.4 për qind); administratën dhe shërbime të tjera publike (+0.3 për qind), aktivitetet e pasurive të patundshme (+0.1 për qind); aktivitetet profesionale dhe mbështetëse të shërbimit (+0.3 për qind) dhe aktivitetet financiare dhe të sigurimit (+0.1 për qind nga -0.4 për qind në tremujorin e dytë). Nga ana tjetër, gjatë tremujorit të tretë të 2016-ës prodhimit ra për bujqësinë, pylltarinë dhe peshkimin rreth -0.6 për qind, duke mos shfaqur rritje në tremujorin e dytë të të njëjtit vit.

Nga viti në vit, ekonomia u rrit me 1.7 për qind, pas një rritje prej 1.6 për qind në tre muajt e mëparshëm duke shënuar përmirësim nga shifrat paraprake.

Duke marrë shkas nga përshpejtimi i rrugëtimit drejt BE-së, pritet që aktiviteti ekonomik në Shqipëri, të ndikohet

nga zhvillimet në mjedisin ekonomik ndërkombëtar. Partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë janë shtetet anëtare të eurozonës si Italia dhe Greqia me kanale ekonomike si eksportet (veçanërisht përmes Italisë), remitancat, si dhe Investimet e Huaja Direkte (IHD).
Rritja ekonomike në Itali është vlerësuar të jetë 0.8% në 2016-ën. Parashikimet tregojnë se PBB do të rritet me 0.9% në 2017-ën dhe me 1% në vitin 2018. Pavarësisht fitimeve të punës, rritja e konsumit privat është dobësuar pas rritjes së pasigurisë dhe rënies së besimit të konsumatorit. Stoku i madh i kredive me probleme dhe rimëkëmbja e pasigurt pengojnë disbursimet e kredive të bankave, duke vështirësuar rimëkëmbjen e investimeve. Rritja e ulët në tregjet e eksportit të Italisë dhe tensionet gjeopolitike kanë penguar eksportet.
Pas një tkurrje të butë të PBB-së reale me 0.2% në vitin 2015, aktiviteti ekonomik në Greqi pritet të rimëkëmbet gradualisht që nga gjysma e dytë e vitit 2016 dhe ritmi të përshpejtohet dukshëm në vitin 2017, për shkak të përforcimit të ndjeshmërisë ekonomike pas përfundimit të shqyrtimit të parë të programit të Mekanizmit të Qëndrueshmërisë Evropiane (ESM), dhe stabilizimin e financave publike. Papunësia do të vazhdojë të ulet në nivele shumë të larta.
Pritshmëria relativisht pozitive për vendet e BE-në, veçanërisht për ekonominë italiane dhe greke, dhe materializimi i tyre në periudhën afat-mesme, pritet të kenë një efekt pozitiv edhe për ekonominë shqiptare.

2.1. Zhvillimet e fundit ekonomike

Aktiviteti ekonomik i Shqipërisë ka vijuar të performojë pozitivisht dhe ka shënuar një përshpejtim përgjatë 9 muajve të vitit 2016. Pas rritjes prej 3.21% të shënuar në tremujorin e dytë të vitit 2016, rritja reale e Prodhimit të Brëndshëm Bruto shënoi vlerën pozitive prej 3.08% përgjatë tremujorit të tretë të vitit, sipas të dhënave tremujore të publikuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ndërkohë që rritja për 9 muajt e vitit 2016 regjistroi vlerën 3.27%. Ky përshpejtim vijues tregon se ekonomia Shqiptare në mënyrë të qëndrueshme është duke arritur ritmin potencial të rritjes.
Kërkesa agregate u rrit në mënyrë të qëndrueshme përgjatë 9 muajve të vitit 2016, e mbështetur kryesisht nga rritja në kërkesën e brëndshme. Konsumi final i popullatës, i cili përbën pëshën kryesore në ekonomi u rrit me rreth 1.65% përgjatë tremujorit të tretë të vitit 2016 (në terma vjetorë), e mbështetur kryesisht nga normat e ulëta të interesit dhe nga përmirësimi i besimit të biznesit në përgjithësi. Konsumi final i qeverisë u rrit me 2.75 % përgjatë tremujorit të tretë të vitit 2016, krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, pavarësisht konsolidimit fiskal i cili ndikoi negativisht për nivelin e konsumit publik. Komponenti i Formimit bruto të kapitalit fiks u rrit me 11.89 %, si rezultat i projekteve madhore në sektorin e ndërtimit. Eksportet e mallrave dhe shërbimeve u rritën me 19.12 %, ndërsa Importet e mallrave dhe shërbimeve u rritën me 5.64 %, duke shtyrë kërkesën e jashtme të kontribuoi relativisht mirë në rritjen ekonomike, e drejtuar kryesisht nga eksporti i shërbimeve. Indikatorët e shfrytëzimit të kapaciteteve dhe shenja të përmirësimit të besimit të të biznesit tregojnë për një ecuri pozitive të aktivitetit ekonomik edhe përgjatë tremujorëve në vijim.
Një situatë e përmirësuar e indikatorëve ekonomik përgjatë nëntë (9) muajve të vitit 2016 kanë ndikuar në rënien e nivelit të papunësisë në 15.5% në përfundim të tremujorit të tretë të vitit 2016, në një rënie të konsiderueshme prej vlerës 17.5% që ishte në të njëjtin tremujor të një viti më parë. Për të gjithë vitin 2016, aktiviteti ekonomik pritet të rritet nën ritme më të larta se rritja e shënuar në vitin 2015. Ky zhvillim do të mbështetet nga përmirësimi i vazhdueshëm në sektorin e punësimit, nga ndjeshmëria e përmirësuar e mjedisit ekonomik në përgjithësi dhe nga kushtet më lehtësuese financiare.
Rritja ekonomike sipas aktivitetit ekonomik përgjatë tremujorit të tretë të vitit 2016 është gjeneruar kryesisht nga performanca e vazhdueshme pozitive e sektorit të Tregtisë, Transportit, dhe Hotele, e cila shënoi një rritje prej respektivisht 6.7% (me një kontribut ndaj PBB-së prej 1.12 pikë përqindje), krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2015. Po ashtu, kjo rritje u përkrah edhe nga një performancë tejet pozitive e sektorit të Ndërtimit, e cila shënoi një rritje prej 8.3% (me një kontribut prej 0.77 pikë përqindje ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto). Për t'u përmendur është edhe sektori i Aktivitete financiare dhe të sigurimit, e cila u rrit konsiderueshëm me 15.4%, duke gjeneruar një kontribut drejt PBB-së prej 0.42 pikë përqindje.
Deficiti i llogarisë korrente shënoi një zgjerim vjetor prej 26.7% në tre tremujorët e parë të vitit 2016, i ndikuar kryesisht nga zgjerimi i deficitit tregtar. Importi i mallrave rezultoi në rritje, ndërkohë që eksporti pati një performancë negative. Nga ana tjetër, llogaria e shërbimeve rezultoi në suficit në reflektim të rritjes së vrullshme të eksportit të shpenzimeve për udhëtim dhe prodhimeve industriale të industrisë së tekstileve. Remitancat u tkurrën në gjysmën e parë të vitit, por rritja e tyre e ndjeshme në tremujorin e tretë përcaktoi rritjen e tyre vjetore për 9 mujorin. Deficiti i llogarisë korrente qëndron në 9.8% i PBB-së nominale në fund të nëntëmujorit të parë të vitit 2016. Deficiti i llogarisë korrente u financua në pjesën më të madhe nga flukset jo-borxh-krijuese. Peshën kryesore në këtë drejtim e zënë flukset neto të investimeve të huaja direkte me rreth 83.3% në terma mesatarë

për nëntëmujorin e parë. Mjetet e rezervës ndërkombëtare arritën në 2.76 miliardë euro në fund të tremujorit të tretë, të mjaftueshme për të mbuluar 6.8 muaj importe dhe 170% të borxhit të huaj afatshkurtër.
Inflacioni ka ardhur në rritje, pas niveleve të ulëta në fillim të vitit 2016. Goditje të ofertës të materializuara në rënien e shpejtë të inflacionit të ushqimeve dhe të çmimit të naftës kontribuan në reduktimin e inflacionit në fillim të vitit. Në linjë me pritjet, këto goditje rezultuan të përkohshme dhe norma e inflacionit u rrit gradualisht gjatë vitit duke arritur në 2.2% në muajin dhjetor. Forcimi i rritjes ekonomike dhe ngushtimi i hendekut negativ të prodhimit është shoqëruar me forcimin e presioneve të brendshme inflacioniste. Gjithashtu, zbutja e presioneve të huaja disinflacioniste dhe rritja e pritjeve inflacioniste kanë mbështetur rritjen e inflacionit. Këto tendenca pritet të vazhdojnë edhe gjatë këtij viti duke mbështetur rritjen graduale të inflacionit drejt objektivit të bankës qendrore.
Politika fiskale ka qëndruar e konsoliduar, me një balancë të përgjithshme pozitive përgjatë periudhës janar-nëntor 2016. Stimujt fiskal priten të vijojnë të jenë neutral ose negativ për muajin e fundit të vitit 2016.
Banka e Shqipërisë ka vijuar politikën e saj lehtësuese edhe gjatë vitit 2016. Stimuli monetar është përcjellë nëpërmjet instrumentit të normës bazë të interesit, nëpërmjet operacioneve injektuese të likuiditetit, si dhe nëpërmjet komunikimit e orientimit të tregjeve financiare për kursin e ardhshëm të politikës monetare. Norma bazë e interesit u reduktua me 50 pikë bazë në pjesën e parë të vitit, duke qëndruar në nivelin 1.25%. Lehtësimi i politikës monetare dhe likuiditeti i bollshëm janë pasqyruar në tregjet financiare. Normat e interesit të depozitave e kredive qëndrojnë në nivele të ulëta historike, duke krijuar kushte për nxitjen e konsumit dhe investimeve. Megjithatë, luhatje afatshkurtra vërehen rreth trendit të tyre rënës
Sistemi bankar vazhdon të qëndroi i mirë kapitalizuar dhe indikatorët financiar janë të shëndoshë. Ndërkohë, normat e interesit kanë qëndruar të ulëta për të gjitha maturitetet. Norma e lartë e kapitalizimit, sëbashku me likuiditetin e lartë ka shtyrë bankat tregtare të zgjerojnë kredidhënien për ekonominë edhe pse kjo është realizuar me një ritëm disi të ulët. Norma mesatare e rritjes së kredidhënies për vitin 2016 deri në muajin nëntor ishte 0.2%, ndërkohë që rritja e kredidhënies vetëm për muajin nëntor ishte 0.8% (në terma vjetore). Ndërsa e zhveshur nga efekti i shuarjes së "kredive të humbura" që u realizua vjet, rritja e stokut total të kredive rezulton rreth 3.2%. Sidoqoftë, normat e rritjes mujore reflektojnë qëndrimin e kujdesur të bankave tregtare për të lëshuar kredi drejt një mejdisi i konsideruar si 'me risk të lartë' për shkak të rritjes së nivelit të kredive të këqija në fund të muajit nëntor 2016 (rreth 20.4%), krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2015 (rreth 19.9%).

2.2. Skenari makroekonomik afatmesëm

Kuadri i përgjithshëm ekonomik pritet të vazhdojë përmirësimin e tij për periudhën afat-mesme. Rritja ekonomike (e cila ka treguar shenjat e rikuperimit që prej vitit 2014 - vit në të cilin shënoi vlerën e rritjes prej 1.8%), pritet që të përshpejtojë ritmin e saj duke arrirë nivelin 3.8% në vitin 2017 dhe të vazhdojë rritjen mbi nivelin 4% në vit për periudhën 2018 - 2020.
Konsumi dhe investimet private pritet që të jenë shtysa kryesore për rritjen ekonomike. Eksportet e shërbimeve, kryesisht ato turistike, pritet të përformojnë tejet pozitivisht në periudhën afat-mesme, duke u rritur me 7.4% (në terma nominale) përgjatë vitit 2017. Sidoqoftë, kërkesa e jashtme neto pritet të vazhdojë të kontribuojë negativisht në drejtim të rritjes ekonomike si rezultat i një niveli të lartë të pritur të importeve të të mirave kapitale, të destinuara kryesisht për dy prej projekteve më të mëdha investuese (TAP dhe Hidroçentrali i Statkraft-Devollit). Si pasojë, kontributi pozitiv i investimeve private për vitin 2017 parashikohet të jetë rreth 1.5 pikë përqindje më i lartë se një vit më parë.
Pavarësisht faktit se politikat fiskale do të vijojnë të jenë të orientuara drejt konsolidimit për periudhën afast-mesme dhe afat-gjatë, politikat buxhetore të qëverisë për të ruajtur një nivel të investimeve publike rreth 6 përqind të PBB-së në vitin 2017 (nga të cilat 4.9 përqind janë investime të qeverisë qëndrore) do të stimulojnë formimin e kapitalit fiks drejt ekonomisë së vendit, e cila është thelbësore për mbajtjen e një niveli të lartë të rritjes ekonomike për periudhën afat-mesme dhe afat-gjatë. Ndërkohë, politikat fiskale gjatë vitit 2017 të planifikuara për periudhën në vijim do të reflektojnë kryesisht nivele të përmirësuara të konsumit publik, kundrejt performancës negative që shënoi një vit më parë. Ndërsa konsumi privat pritet të vazhdojë ritmin e tij pozitiv meqënëse besimi konsumator është përmirësuar që prej reformave dhe taksave të ndërmarra në vitin 2015. Në të njëjtën kohë, politika monetare akomoduese e ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë për periudhën e ardhshme afat-mesme, për aq kohë sa presionet inflacioniste do të vazhdojnë të qëndrojnë të ulëta, do të mund të japë një kontribut pozitiv si konsumit ashtu edhe investimeve private.
Rritja e konsumit privat përgjatë horizontit afat-mesëm pritet të mbështetet nga përmirësime të tregut të punës, si reflektim i një rritje të qëndrueshme të punësimit dhe pagave. Kjo automatikisht do të influencojë të hyrat në dispozicion të individëve. Rritja e kredisë dhënë konsumatorëve parashikohet të mbështetet nga përmirësimi i kushteve financiare të familjarëve dhe nga lehtësimi i standarteve të huadhënies. Ndërkohë, sjellja disi

parandaluese do të ketë ende efekt në ritmin e rritjes konsumit.
Rimëkëmbja graduale e kërkesës për investime pritet të mbështetet nga përmirësimi i normës së shfrytëzimit të kapaciteteve dhe nga përmirësim i klimës së biznesit për periudhën afat-mesme, si në vend ashtu edhe në mjedisin e jashtëm të partnerëve më të qënësishëm tregtar të Shqipërisë. Rimëkëmbja e investimeve për vitet në vijim do të mbështetet nga tre zhvillime të pavarura nga njëri-tjetri. Së pari, nga një nivel më i lartë i Investimeve të Huaja Direkte (rreth 9.2% të PBB-së në vitin 2017), veçanërisht në sektorin energjitik. Së dyti, investimet private do të përfitojnë nga pritshmëritë për përmirësimin e kushteve financiare. Së treti, mjedisi i biznesit nën regjimin e ulët të normës bazë të interesit, si dhe kushtet më lehtësuese financiare, do të mbështesin drejtpërsëdrejti projektet madhore të investimeve.

Tabela 1: Rritja reale (majtas, në %) dhe kontributet në rritje (djathtas, në %) sipas komponentëve të shpenzimeve

		2012	2013	2014	2015	2016 Par.	2017 Par.	2018 Par.	2019 Par.	2012	2013	2014	2015	2016 Par.	2017 Par.	2018 Par.	2019 Par.
1	**Konsumi Final (a+b+c)**	**0.1**	**2.0**	**3.4**	**0.8**	**2.6**	**3.2**	**2.8**	**3.1**	**0.1**	**1.7**	**3.1**	**0.7**	**2.4**	**2.9**	**2.5**	**2.8**
1.1	Konsumi Final i Popullatës	0.1	1.8	3.0	0.9	3.1	2.7	2.7	3.4	0.1	1.4	2.4	0.7	2.5	2.2	2.1	2.6
1.2	Konsumi Final i Administratës Publike	0.1	2.9	6.4	-0.3	-1.1	7.0	3.9	1.4	0.0	0.3	0.7	0.0	-0.1	0.7	0.4	0.1
1.2.1	Konsumi Individual	0.9	5.2	5.3	-2.2	-0.7	7.0	3.8	0.9	0.0	0.3	0.3	-0.1	0.0	0.4	0.2	0.0
1.2.2	Konsumi Kolektiv	-0.7	0.7	7.5	1.7	-1.5	6.9	3.9	1.8	0.0	0.0	0.4	0.1	-0.1	0.4	0.2	0.1
1.2.3	Konsumi i Institucioneve Jo-fitimprurëse	0.6	3.7	10.0	-0.2	1.0	1.0	1.0	1.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
2	**Formimi Bruto i Kapitalit Fiks**	**-7.9**	**-2.0**	**-4.0**	**10.3**	**9.1**	**8.4**	**5.4**	**2.6**	**-2.3**	**-0.5**	**-1.0**	**2.5**	**2.4**	**2.4**	**1.6**	**0.8**
2.1	Publik	-14.5	7.7	-4.8	5.2	19.8	0.4	2.0	0.6	-0.9	0.4	-0.3	0.3	1.0	0.0	0.1	0.0
2.1.1	nga e cila qeveria qendrore	-12.8	6.2	-7.2	5.4	9.2	5.4	2.3	0.5	-0.7	0.3	-0.4	0.2	0.4	0.3	0.1	0.0
2.1.2	Privat	-6.1	-4.3	-3.7	11.7	6.4	10.7	6.3	3.1	-1.4	-0.9	-0.8	2.3	1.3	2.3	1.5	0.7
2.2	**Kërkesa e brendshme (1+2)**	**-1.9**	**1.1**	**1.8**	**2.8**	**4.0**	**4.4**	**3.5**	**3.0**	**-2.2**	**1.2**	**2.1**	**3.2**	**4.8**	**5.3**	**4.1**	**3.6**
2.3	**Eksporti neto^ (a-b)**	**-15.5**	**0.3**	**9.0**	**-9.3**	**8.1**	**8.1**	**0.0**	**-3.8**	**3.5**	**0.0**	**-1.6**	**1.8**	**-1.4**	**-1.5**	**0.0**	**0.7**
2.3.1	Eksportet e mallrave e shërbimeve (fob)	-0.6	-12.4	1.8	1.0	2.2	4.8	6.8	6.0	-0.2	-4.1	0.5	0.3	0.6	1.3	1.9	1.7
2.3.1.1	Eksportet e mallrave	6.4	-30.3	-11.5	-17.1	-3.5	6.1	10.1	8.4	1.0	-4.8	-1.3	-1.6	-0.3	0.4	0.7	0.6
2.3.1.2	Eksportet e shërbimeve	-6.3	4.0	9.9	9.9	4.4	4.3	5.7	5.2	-1.2	0.7	1.8	1.9	0.9	0.9	1.2	1.1
2.3.2	Importet e mallrave e shërbimeve (fob)	-6.6	-7.9	4.6	-3.1	4.5	6.1	4.1	2.3	-3.7	-4.1	2.2	-1.5	2.0	2.8	1.9	1.0
2.3.2.1	Importet e mallrave	-4.4	-11.6	5.2	-2.3	6.3	6.6	4.0	1.3	-1.7	-4.3	1.6	-0.7	1.9	2.0	1.3	0.4
2.3.2.2	Importet e shërbimeve	-11.5	1.2	3.4	-4.9	0.9	5.0	4.4	4.4	-2.0	0.2	0.5	-0.77	0.1	0.7	0.6	0.6
2.4	**Ndryshimet e gjendjeve**	**-8.7**	**1.1**	**14.4**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**-0.2**	**0.0**	**0.3**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
2.5	**Mospërputhje statistikore**	**12.9**	**-13.0**	**-124.8**	**280.8**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**0.26**	**-0.19**	**1.11**	**-2.42**	**0**	**0**	**0**	**0**
2.6	**PRODHIM I BRËNDSHËM BRUTO (3+4+5)**	**1.4**	**1.0**	**1.8**	**2.6**	**3.4**	**3.8**	**4.1**	**4.2**	**1.4**	**1.0**	**1.8**	**2.6**	**3.4**	**3.8**	**4.1**	**4.2**

Burimi: INSTAT, Ministria e Financave

Kërkesa e përgjithshme e sektorit publik do të vazhdojë të jetë disi e ngurtësuar nga konsolidimi fiskal edhe për vitin 2017. Si rrjedhojë, ky indikator nuk pritet që të jetë një gjenerator për rritjen ekonomike në vend për periudhën afat-mesme. Sidoqoftë, konsolidimi fiskal do të reduktojë riskun për periudhën afat-mesme dhe do të mundësojnë mbështetjen buxhetore për sektorin privat.
Në të njëjtën kohë, përbërja e politikave buxhetore të planifikuara janë mbështetëse ndaj rritjes dhe si rrjedhojë pritet që të kompensojnë deri në një farë mase efektet shtrënguese të konsolidimit fiskal. Më specifikisht, investimet publike në periudhën afat-shkurtër dhe afat-mesëm do të ruhen në nivelin 6% të PBB-së për vitin 2017, e cila ka një ndikim si një multiplikator në drejtim të kërkesës agregate afat-shkurtër dhe është e qënësishme për rimëkëmbjen e rritjes potenciale në periudhën afat-mesëm dhe më tej. Po ashtu, rritja e pagave në sektorin publik për vitin 2017, pritet që të stimulojnë konsumin.
Presioni i brëndshëm dis-inflacionist përgjatë periudhës janar-nëntor 2016 pritet që të rifutet në të njëjtat nivele të targetuar nga Banka e Shqipërisë. Megjithatë, nën këto ritme, inflacioni pritet që të vazhdojë të jetë i ulët, nën objektivin e BSH deri në fund të vitit 2018.
- Faktorët e favorshëm për presione të dobëta inflacioniste do të përfshijnë edhe:
(i) Çmime të qëndrueshme të mallrave dhe të konsumit në tregjet ndërkombëtare;
(ii) Pritshmëri të ulëta inflacioniste dhe një ngurrim nga ana e bizneseve për të mbuluar një nivel më të lartë të shpenzimeve dhe rikthimi drejt fitimit.
Duke qënë se kërkesa e brëndshme rritet dhe stimujt e politikës monetare përçohen plotësisht në ekonominë reale, inflacioni do të arrijë objektivin e BSH brenda periudhës afat-mesme.

Tabela 2: Rritja reale (majtas, në %) dhe kontributet në rritje (djathtas, në %) sipas komponentëve të prodhimit

		2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
						Par.	Par.	Par.	Par.					Par.	Par.	Par.	Par.
1	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	5.4	1.1	2.0	0.8	0.3	3.2	3.3	3.5	1.0	0.2	0.4	0.2	0.1	0.6	0.7	0.7
2.1	Industria nxjerrëse	17.4	13.0	11.5	-11.2	-17.8	5.9	8.7	9.8	0.6	0.6	0.6	-0.6	-0.5	0.1	0.2	0.2
2.2	Industria përpunuese	-15.7	9.8	8.3	5.0	6.9	5.2	5.9	5.9	-0.9	0.5	0.4	0.3	0.4	0.3	0.3	0.4
2.3	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar	0.7	36.3	-22.8	13.6	12.8	4.6	4.9	5.3	0.0	0.6	-0.5	0.3	0.3	0.1	0.1	0.2
2.4	Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetj	-13.1	3.9	3.6	11.6	6.3	2.1	2.7	3.2	-0.1	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
3	Ndërtimi	-8.8	-9.3	-12.4	14.1	6.6	9.6	5.6	4.7	-1.1	-1.1	-1.3	1.2	0.6	1.0	0.6	0.5
4	Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorcikleta	1.5	1.4	3.4	-3.3	4.7	2.4	3.2	4.0	0.2	0.2	0.4	-0.4	0.5	0.3	0.3	0.4
5	Transporti dhe magazinimi	5.0	-25.1	-2.8	7.6	3.8	2.3	3.3	3.9	0.2	-1.1	-0.1	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1
6	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	-2.6	-7.1	3.2	2.9	2.1	1.1	2.2	3.3	0.0	-0.1	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.1
7	Informacioni dhe komunikacioni	-5.6	-10.1	2.6	4.5	12.3	0.9	1.8	2.4	-0.2	-0.3	0.1	0.1	0.4	0.0	0.1	0.1
8	Aktivitete financiare dhe të sigurimit	2.3	1.7	2.1	5.1	2.4	0.4	1.3	2.0	0.1	0.0	0.0	0.1	0.1	0.0	0.0	0.1
9	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	1.7	8.8	0.1	1.1	5.7	0.7	1.4	1.9	0.1	0.5	0.0	0.1	0.3	0.0	0.1	0.1
10	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	22.4	2.2	17.3	15.2	7.3	3.1	5.8	4.7	0.4	0.0	0.4	0.4	0.2	0.1	0.2	0.1
11	Shërbime administrative dhe mbështetëse	50.5	20.7	19.8	11.3	2.7	4.7	8.1	5.8	0.6	0.4	0.4	0.3	0.1	0.1	0.2	0.2
12	Administrim publik dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm	4.6	1.5	6.9	2.2	2.0	3.4	4.8	4.1	0.2	0.1	0.3	0.1	0.1	0.1	0.2	0.2
13	Arsimimi	11.2	5.7	-4.4	-0.3	2.9	3.8	4.4	4.5	0.4	0.2	-0.2	0.0	0.1	0.2	0.2	0.2
14	Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	3.4	4.4	14.2	9.3	3.2	6.5	4.7	4.9	0.1	0.1	0.4	0.3	0.1	0.2	0.1	0.1
15	Arte, argëtim dhe çlodhje	-16.5	-3.7	52.9	-1.6	3.4	2.1	4.1	3.2	-0.2	0.0	0.4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
16	Aktivitete të tjera shërbimi;	-27.7	13.5	3.7	16.1	0.9	1.4	4.3	4.4	-0.4	0.1	0.0	0.2	0.0	0.0	0.1	0.1
17	**Vlera e Shtuar Bruto me çmime bazë**	1.0	1.1	2.1	3.2	3.4	3.8	4.1	4.2	0.9	1.0	1.8	2.8	3.0	3.4	3.6	3.7
17.1	Taksa neto mbi produktet	4.0	0.2	-0.1	-1.8	3.5	3.9	4.2	4.3	0.5	0.0	0.0	-0.2	0.4	0.5	0.5	0.5
18	**PBB ME ÇMIMET E TREGUT**	**1.4**	**1.0**	**1.8**	**2.6**	**3.4**	**3.8**	**4.1**	**4.2**	**1.4**	**1.0**	**1.8**	**2.6**	**3.4**	**3.8**	**4.1**	**4.2**

Burimi: INSTAT Ministria e Financave

Rritja për periudhën afat-mesme pritet të jetë e fokusuar në krijimin e një niveli më të lartë punësimi për individët seç është realizuar në vitet e mëparshme, e mbështetur edhe nga një performancë e pritshme tejet më pozitive të sektorit të prodhimit. Më specifikisht, Bujqësia, Tekstilet dhe industria e këpucëve po ashtu edhe shërbimet e turizmit pritet që të jenë mbështetësit kryesorë, duke reflektuar kështu edhe një prioritet më të lartë të qeverisë në drejtim të këtyre sektorëve apo nën-sektorë për periudhën afat-mesme. Si rrjedhojë, rritja në punësimin e përgjithshëm pritet të përshpejtohet përgjatë periudhës 2017-2019. Pavarësisht pritshmërisë së lartë për rritjen e nivelit të punësimit, produktiviteti i përgjithshëm i punës parashikohet të ketë një përmirësim të lehtë në periudhën afat-mesme. Në të njëjtën kohë, skenari bazë supozon një rritje të forcës së punës me 1.3% vetëm përgjatë vitit 2017, gjë që reflekton një rritje të normës së pjesëmarrjes në forcën e punës duke arritur vlerën 64.9% në vitin 2017 nga 62.3% në vitin 2015 dhe 62.5% në vitin 2016. Parashikimet për rritjen e popullatës kanë një efekt tejet të vogël në rritjen e forcës së punës. Si pasojë, skenari bazë projekton një rënie të njëtrajtshme të normës së papunësisë në 14.4% në vitin 2017, në 13.3% në vitin 2018 dhe në 12.5% në vitin 2019, nga 15.7% në vitin 2016.

Sektori i Ndërtimit parashikohet të vazhdojë performancën e tij pozitive edhe përgjatë vitit 2017 me një rritje vjetore prej 9.6% (me një rritje mesatare prej 6.7% gjatë 2017-2019), duke reflektuar kështu një nivel të lartë të formimit të kapitalit fiks bruto. Industria nxjerrëse pritet që të rimëkëmbet gjatë vitit 2017 (me një rritje vjetore prej 5.9%), nga performanca negative që shënoi në vitet 2015 dhe 2016, si pasojë e rënies së çmimit të lëndës djegëse.

Duhet theksuar se, risku i cili mund të ketë efekt mbi ekonominë Shqiptare qëndron në nivele relativisht të ulëta. Në afat-shkurtër, rimëkëmbja do të vazhdojë të përforcohet nga: parandalimi i nivelit të lartë të papunësisë; shfrytëzimi jo optimal i kapaciteteve dhe luhatshmërisë së rritjes së kreditimit për sektorin privat dhe familjet. Në periudhën afat-mesme dhe afat-gjatë, reformat strukturore në vijim duhet të sjellin një përmirësim të mjedisit të biznesit për firmat private dhe të stimulojë potencialin ekonomik.

Politika Monetare, Kursit të këmbimit dhe Inflacionit

Objektivi kryesor i politikës monetare është stabiliteti i çmimeve. Banka e Shqipërisë zbaton një regjim shënjestrimi inflacioni, me objektivin për inflacionin 3.0% në termin afatmesëm. Instrumenti kryesor për të arritur këtë objektiv është norma e interesit e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me maturitet një javor. Ky instrument mbështetet edhe nga instrumente të tjerë të politikës monetare si operacionet e tregut të hapur, lehtësirat e përhershme dhe rezerva e detyrueshme. Banka e Shqipërisë zbaton një regjim të lirë të kursit të këmbimit. Në përputhje me të, banka qendrore nuk ndërhyn në treg, me përjashtim të rasteve që lidhen me menaxhimin e rezervës valutore, me devijime të forta nga ekuilibrat dhe korrigjime të çrregullimeve të tregut.

Në linjë me objektivin e stabilitetit të çmimeve, politika monetare ka qenë në një cikël lehtësimi në pesë vitet e fundit. Politika monetare lehtësuese ka mbështetur rikuperimin e ekonomisë dhe rritjen e inflacionit. Megjithëse në përmirësim, presionet inflacioniste mbetet të ulëta në reflektim të rritjes së ekonomisë nën potencial dhe presioneve disinflacioniste nga mjedisi i huaj.

Me qëllim arritjen e objektivit 3.0% të inflacionit në afat të mesëm, Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare lehtësuese në 5 vitet e fundit. Stimuli monetar është forcuar në pjesën e parë të vitit 2016 në përgjigje të presioneve të ulëta inflacioniste dhe zhvendosjes për poshtë të balancës së rreziqeve në këtë periudhë. Norma bazë e interesit u ul në muajt prill e maj, duke arritur në vlerën më të ulët historike prej 1.25%. Në të njëjtën kohë, korridori i lehtësirave të përhershme u ngushtua me 150 pikë bazë, për të ndihmuar transmetimin e politikës monetare. Përveç uljes së normës, Banka e Shqipërisë ka vijuar të injektojë likuiditet në tregun financiar dhe të përdorë sinjalizimin e politikës monetare për të ardhmen për të ulur primet e rrezikut dhe drejtuar pritjet për inflacionin. Këto masa, së bashku me përmirësimin e kushteve ekonomike në vend dhe zbutjen e presioneve disinflacioniste nga jashtë kanë ndikuar në rritjen e inflacionit dhe afrimin e tij me objektivin.
Politika monetare lehtësuese është konsistente me ndjekjen e një politike fiskale konsoliduese. Ky miks i politikave makroekonomike i shërben mbështetjes së aktivitetit ekonomik.
Stimuli monetare është transmetuar në norma më të ulëta të kredive në tregjet financiare. Kreditimi është përmirësuar, por vijon të kushtëzohet nga kërkesa e dobët dhe niveli i lartë i kredive me probleme. Banka e Shqipërisë po adreson këtë të fundit nëpërmjet masave makroprudenciale dhe një plani veprimi kombëtar në bashkëpunim më qeverinë për zgjidhjen e kredive me probleme. Ulja e nivelit të këtyre kredive do të ndihmojë në zbutjen e kufizimeve në transmetimin e stimulit monetar në ekonomi.
Banka e Shqipërisë pret që presionet inflacioniste të forcohen në termin afatmesëm. I mbështetur nga politika monetare lehtësuese dhe rikuperimi i vazhduar i ekonomisë, inflacioni pritet të kthehet në objektiv në mesin e vitit 2018. Gjithashtu, ndikimi dizinflacionist nga ambienti i huaj pritet të pakësohet.
Politika monetare duhet të vazhdojë të mbetet në kah stimulues gjatë periudhës së ardhshme, për të mbështetur rikuperimin e kërkesës së brendshme dhe për të siguruar kthimin e inflacionit në objektiv. Kushtet monetare aktualisht konsiderohen të përshtatshme për të mbështetur aktivitetin ekonomik dhe rritjen e inflacionit drejt nivelit të shënjestruar. Sinjalizimi i dhënë për tregjet nënkupton se normat do të qëndrojnë në këto nivele deri në mesin e vitit 2017. Sidoqoftë, balanca e rreziqeve anon në krahun e poshtëm. Paqartësitë në lidhje me realizimin e objektivit të inflacionit lidhen kryesisht me zhvillimet në tregjet botërore të mallrave bazë dhe zhvillimeve ekonomike e financiare në Eurozonë.

Zhvillimet në Bilancin e Pagesave dhe Tregtinë e mallrave
Deficiti i llogarisë korrente është zgjeruar mesatarisht me 26.7% në terma vjetorë gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2016. Ai qëndroi në nivelin 9.8% të PBB-së në fund të nëntëmujorit. Ai ka shfaqur zhvillime të ndryshme nga një tremujor në tjetrin.
Rigjallërimi i importeve shoqëruar me pakësim të remitancave dhe një performancë të dobët të eksporteve kanë prodhuar një zgjerim të shpejtë të deficitit korrent gjatë dy tremujorëve të parë të vitit. Zgjerimi i lartë vërehet kryesisht në tremujorin e dytë (rritja vjetorë shënoi 116%), kryesisht për shkak të importeve të larta të lidhura me operacionet e Gazsjellësit Trans-Adriatik. Deficiti shënonte raportin 12.5% ndaj PBB nominale. Zhvillimet ishin mjaft të ndryshme gjatë tremujorit të tretë të vitit. Deficiti u ngushtua me 33.6% veçanërisht si rrjedhojë e rritjes së eksportit të shërbimeve dhe prurjeve më të larta të remitancave. Gjatë këtij tremujori, deficiti shënoi 7.5% ndaj PBB nominale.
Në vlerësimin tonë deficiti i llogarisë korrente do të zgjerohet me rreth 15% gjatë gjithë vitit 2016. Deficiti i tregtisë së mallrave pritet të jetë shkaku kryesor i këtij zgjerimi. Importet e mallrave – të cilat janë rritur në terma vjetorë me rreth 6.5% gjatë 11 muajve të parë të vitit 2016 – pritet të ruajnë këtë trend edhe në vitin në vazhdim. Rritja e lartë e parashikuar për kërkesën e brendshme kërkon kontribute nga importet për mallra të konsumit final, mallra kapitale dhe mallra të konsumit të ndërmjetëm.
Eksporti i mallrave është karakterizuar nga një tendencë rënëse gjatë 11 muajve të parë të vitit 2016, një ecuri e nisur që prej gjysmës së dytë të vitit 2015. Eksportet rënëse të lëndës djegëse dhe mineraleve përbëjnë kontribuesin kryesor. Në veçanti, kërkesa e dobët dhe çmimet e ulëta të lëndës djegëse kanë qenë të dëmshme për industrinë vendase. Kompania kryesore koncesionare në këtë fushë, Bankers-Petroleum ka raportuar të dhëna për pakësim të prodhimit deri në çastin kur iu shit Geo-Jade petroleum. Kushte të ngjashme kanë përcaktuar edhe ecurinë e eksporteve të metaleve. Kërkesa e huaj në pakësim dhe çmimet jo të favorshme kanë qenë faktorët pas tkurrjes së eksporteve të kësaj kategorie. Si rrjedhojë, prodhuesi kryesor i gizës dhe çelikut në Shqipëri, "Kurum", u ballafaqua me vështirësi dhe depozitoi kërkesën për falimentim në shkurt 2016. Gjatë muajve tetor dhe nëntor u vunë re disa zhvillime të lehta pozitive në lidhje me eksportin nga burimet natyrore si rrjedhojë e çmimeve më të favorshme ndërkombëtare për xeherorët (veçanërisht nga Kina). Megjithatë është ende herët për të vlerësuar nëse këto zhvillime janë të përkohshme apo përfaqësojnë një prirje të re për të ardhmen.

Zhvillime pozitive kanë karakterizuar industrinë e tekstileve dhe veshjeve (fasonet) me kontribute kryesore prej eksporteve të veshjeve të këmbëve (kryesisht drejt Italisë). Këto tendenca pritet të ruhen edhe në vazhdimësi të mbështetura në pritjet pozitive për ecurinë e industrisë së veshjeve në Itali. Nga ana tjetër, vlerësimet në lidhje me koston e punës për njësi, megjithëse në rritje, tregojnë për një ritëm më të ngadaltë rritjeje të këtij treguesi gjatë dy viteve të fundit. Për më tepër, në raportin më i fundit zyrtar për kostot e punës në Shqipëri, publikuar nga Instituti i Statistikave, raportohet se kostot e punës për njësi në Shqipëri kanë qenë më të ulëta krahasuar me rajonin për vitin 2013. Gjithashtu, kontribute pozitive kanë ardhur edhe nga eksportet e ushqimeve. Eksportet bujqësore primare (kryesisht perimet) janë rritur me vlera dyshifrore për disa kohë tashmë. Përmirësimi i pikave të grumbullimit dhe lehtësitë administrative kanë qenë arsyet kryesore për këto zhvillime.
Megjithatë, zhvillimet pozitive në kategoritë e tekstileve dhe ushqimeve nuk kanë qenë të pamjaftueshme për të kompensuar humbjet e përjetuara në eksportet me bazë burimet natyrore. Si rrjedhojë, eksportet totale janë pakësuar me 1.6% në terma vjetorë gjatë 11 muajve të parë të vitit 2016.
Italia mbetet partneri kryesor tregtar në eksportet e vendit tonë pasuar nga Kosovo, Turqia dhe Kina. Disa partnerë tregtarë jo-rajonalë (Spanja dhe Malta) të cilët u shfaqën gjatë viteve të rritjes së shpejtë të eksporteve të lëndës djegëse janë pothuajse zhdukur plotësisht. Gjithashtu, eksportet drejt Turqisë dhe Kinës janë pakësuar ndjeshëm si pasojë e përformancës së dobët të xeherorëve, materialeve të ndërtimit dhe metaleve. Sikurse u përmend më lart, disa zhvillime pozitive me eksportet drejt këtyre tregjeve janë vënë re në muajt e fundit, por perspektiva mbetet ende e paqartë. Nga ana tjetër, rritja e eksporteve të ushqimeve është shoqëruar me rritjen e kontributeve të vendeve fqinje sikurse Kosova, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Bullgaria.
Struktura e eksporteve mbetet mjaft e përqendruar për sa i përket kategorive dhe partnerëve. Treguesit në rënie të eksporteve dëshmojnë se ato pika të dobëta të theksuara në raporte të kaluar janë materializuar në të tashmen dhe struktura mbetet mjaft e ndjeshme ndaj zhvillime ndërkombëtare të çmimeve dhe kërkesës.
Zhvillimet në kursin e këmbimit gjatë vitit 2016, nuk kanë favorizuar konkurueshmërinë e ekonomisë shqiptare. Monedha vendase është vlerësuar në terma realë, duke vazhduar tendencën e shfaqur në muajt e fundit të vitit 2015. Deri në muajin nëntor 2016, indeksi Kursit Real Efektiv të Këmbimit (KREK) është reduktuar mesatarisht me 3.6% në vit. Mbiçmimi vjetor real i lekut ndaj monedhave të shportës reflekton më së shumti mbiçmim e tij në terma nominalë ndaj pothuajse të gjitha monedhave kryesore, ndërsa diferenca e inflacionit me vendet partnere ka ardhur duke u ngushtuar. Në ndryshim nga pjesa e parë e vitit 2016, mbiçmimi lekut ndaj monedhave të shportës ka reflektuar mbiçmimin e fortë të Lekut (llogaritur indirekt nëpërmjet kursit me dollarin amerikan) kundrejt monedhave të dy partnerëve tregtarë: Kina dhe Turqia. Zhvlerësimi i monedhave të këtyre dy vendeve kundrejt dollarit amerikan, gjatë kësaj periudhe, është reflektuar në rritje të konsiderueshme të mbiçmimit vjetor të lekut, si në terma nominal ashtu edhe real. Duke përjashtuar këtë faktor, mbiçmimi real i indeksit në tremujorin e fundit është ngushtuar në krahasim me gjysmën e parë të vitit 2016[1] .

[1] Në ecurinë e indekseve nominale dhe reale të këmbimit një ndikim të rëndësishëm ka edhe mbiçmimi i lekut ndaj lirës turke dhe renminbi-t kinez. Në harkun kohor të një viti, leku është mbiçmuar ndjeshëm ndaj këtyre monedhave me 15% dhe 9% përkatësisht. Nisur nga pesha e transaksioneve tregtare me këto dy vende (rreth 10.6% secila), ndikimi i zhvillimeve të këtyre monedhave ka një kontribut vjetor rreth 2.5pp në ecurinë vjetore të të dy indekseve. Në mungesë të këtyre zhvillimeve, mbiçmimi i lekut ndaj shportës së kompozuar do të ishte më i moderuar, ai vlerësohet rreth 1.7% dhe 2.2% mesatarisht për vitin 2016.

Grafiku 1: Hapja tregtare, eksporti, importi dhe Investimet Direkte neto ndaj PBB nominale



Grafiku 2: Ndryshimet vjetore në kursin nominal dhe real efektiv të këmbimit (%)



Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT

Sipas dekompozimit të eksporteve shqiptare bazuar në metodën e Përpjesëve Konstante të Tregut (PKT), pakësimi i konkurueshmërisë (komponenti mbetës) ka rezultuar kontribuuesi kryesor në pakësimin e eksporteve drejt vendeve të EU-15 gjatë vitit 2015. Në të njëjtën kohë, kontribute negative lidhen me strukturën e kategorive dhe shpërndarjen e tregut. I vetmi kontribut pozitiv lidhet me rritjen e eksporteve botërore. Një pasqyrë e kundërt karakterizon eksportet drejt vendeve të CEFTA. Të gjithë komponentët kanë prodhuar kontribute pozitive me konkurueshmërinë si faktor kryesor. Rritja e eksporteve botërore dhe struktura e kategorive kanë ndikuar gjithashtu pozitivisht në rritjen e eksporteve drejt rajonit me disa ndikime të vogla edhe nga shpërndarja e tregut.

Tabela 3: Dekompozimi i eksporteve shqiptare sipas metodës PKT (në milion Euro)

	2015	
	EU -15	CEFTA
Rritja e eksporteve botërore	55.4	9.9
Struktura e kategorive	-17.3	6.7
Shpërndarja e tregut	-26.4	1.8
Konkurueshmëria	-103.7	17.0
Total	-92.0	35.3

Burimi: Banka e Shqipërisë INSTAT, UN Comtrade

Llogaria e shërbimeve ka shfaqur zhvillime pozitive gjatë vitit 2015 dhe gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2016. Eksportet e shërbimeve janë zgjeruar si rrjedhojë e zhvillimeve pozitive të sektorin e turizmit. Këto përmirësime lidhen me zgjerimin dhe modernizimin e infrastrukturës akomoduese dhe një ndërgjegjësim më të lartë në lidhje me Shqipërinë. Gjithashtu, shërbimet industriale të lidhura me input-et fizike kanë prodhuar kontribute suplementare pozitive. Këto të fundit kanë të bëjnë me zgjerimin e eksporteve të fasonit të lidhura me industrinë e tekstileve dhe veshjeve në vend. Si rrjedhojë, eksporti i shërbimeve është rritur me 17.8% në terma vjetorë agregatë gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2016. Rritja rezultoi veçanërisht e fortë gjatë tremujorit të tretë të vitit kur eksporti i shërbimeve u zgjerua me 24.1% në terma vjetorë nxitur kryesisht nga shërbimet e udhëtimeve.
Importi i shërbimeve shfaqi një rritje të moderuar gjatë tremujorit të parë të vitit 2016. Nga ana tjetër, zgjerimi rezultoi mjaft i lartë gjatë tremujorit të dytë të vitit, i ndikuar nga shërbimet e transportit (rritja vjetore rezultoi 22.3%). Në terma agregatë, importi i shërbimeve u zgjerua me 8.8% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, ndërkohë që suficiti i llogarisë përkatëse u zgjeruar me 46.5% gjatë të njëjtës periudhë.
Deficiti i llogarisë së të ardhurave parësore u ngushtua me 81.9% në terma vjetorë agregatë gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2016. Përgjithësisht, këto zhvillime janë ndikuar nga të ardhurat nga investimet. Daljet në këtë llogari u pakësuan me rreth 14.5% në terma vjetorë, ndërkohë që hyrjet u zgjeruan. Në të dy rastet, ecuria është përcaktuar nga zhvillimet në të ardhurat nga IHD. Riatdhesimi i fitimeve nga IHD rezulton lehtësisht i

pakësuar. Në të njëjtën kohë, të ardhurat hyrëse nga IHD janë zgjeruar. Hyrjet e IHD pritet të rriten gjatë tremujorit të mbetur të 2016, duke sugjeruar për rritjen e të ardhurat dalëse të lidhura me to. Teprica e përgjithshme parashikohet të shfaqë një deficit të moderuar.
Transfertat korrente janë rritur me 4.9% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2016, por zhvillimet nuk kanë qenë të njëtrajtshme gjatë periudhës. Gjatë pjesës së parë të vitit, remitancat u pakësuan me rreth 5%, një tendencë kjo e nisur që në vitin 2015. Përveç vështirësive të hasura në ekonomi me prani të emigracionit shqiptar (veçanërisht Greqia), remitancat bartin edhe një efekt bazë të krijuar në gjysmën e dytë të vitit 2014 dhe të trashëguar në gjysmën e parë të vitit 2015. Gjatë këtyre periudhave, remitancat hyrëse u zgjeruan në mënyrë të konsiderueshme. Më pas, hyrjet e remitancave filluan të shfaqin norma vjetore negative (prej tremujorit të tretë të vitit 2015). Gjatë tremujori të tretë të vitit 2016, remitancat u gjallëruan përsëri duke u rritur me 13.9% dhe duke përmbysur tkurrjen e pjesës së parë[2] . Rritja pritet të jetë e moderuar përgjatë vitit 2016.
Investimet direkte neto janë pakësuar me 5.5% në terma mesatarë gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2016. Kjo ka ardhur kryesisht si pasojë e pakësimit të hyrjeve të IHD gjatë periudhës. Por zhvillimet kanë qenë të ndryshme nga një tremujor në tjetrin. Gjatë tremujorit të parë të vitit, IHD neto u pakësuan me 43.4%. Gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë, IHD neto u zgjeruan me 22.2% dhe 11.4% respektivisht. Këto zhvillime lidhen me çastin e ndodhjes së IHD. Me intensifikimin e punimeve në projekte të rëndësishëm (sikurse Gazsjellësi Trans-Adriatik), rritja e hyrjeve të IHD, e nisur që prej tremujorit të dytë, pritet të vijojë edhe në tremujorin e fundit. Për gjithë vitin 2016, hyrjet e IHD mendohet të zgjerohen me 12%.
Aktivet e investimeve të portofolit u shtuan me rreth 93.3 milion Euro gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2016 krahasuar me një pakësim prej 138.7 milion Euro gjatë vitit të kaluar. Kjo ka ardhur kryesisht nga investimet në rritje për tituj borxhi jashtë vendit. Nga ana tjetër, pasivet janë pakësuar si pasojë e uljes së detyrimeve të borxhit. Teprica e përgjithshme ka shfaqur një pozicion suficitar veçanërisht gjatë tremujorit të parë të vitit 2016.
Gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2016, flukset jo-borxh-krijuese janë përsëri kontribuuesi kryesor në financimin e deficitit të llogarisë korrente. Mendohet që këto flukse të vazhdojnë të rrisin kontributin e tyre në financimin e deficitit korrent si pasojë e pritshmërive për IHD hyrëse më të larta gjatë pjesës së mbetur të vitit 2016.

Zhvillime të borxhit të jashtëm
Stoku i borxhit të jashtëm bruto të Shqipërisë arriti 7,924.2 milionë Euro në tremujorin e tretë të vitit 2016, duke qëndruar në nivelin 73.8% ndaj PBB nominale. Borxhi afatgjatë përbën 80.2% të borxhit të përgjithshëm përbërë kryesisht nga detyrimet e qeverisë së përgjithshme dhe sektorëve të tjerë. Borxhi afatshkurtër përbën 19.7% të borxhit të përgjithshëm me kontribute kryesore nga detyrimet e jashtme të bankave.
Nga pikëpamja e qëndrueshmërisë, treguesit e aftësisë ripaguese afatgjatë të borxhit të jashtëm të Shqipërisë janë përkeqësuar. Raporti i borxhit të jashtëm bruto ndaj eksportit të mallrave dhe shërbimeve qëndronte në nivelin 213.4% në fund të tremujorit të tretë të vitit 2016. Ky tregues është rritur në formë të vazhdueshme prej fundit të vitit 2007. Gjithashtu, raporti i borxhit të jashtëm bruto ndaj të ardhurave fiskale qëndronte në nivelin 275.8%. Në të njëjtën kohë, raporti i borxhit të jashtëm të qeverisë së përgjithshme ndaj të ardhurave fiskale qëndronte në nivelin 116.8%. Të dy treguesit kanë shfaqur prirje përkeqësuese prej vitit 2007. Treguesit e likuiditetit dëshmojnë për trysni të dobëta për sa i përket shërbimit të borxhit. Raporti i aktiveve të rezervës ndaj borxhit të jashtëm afatshkurtër qëndronte në nivelin 170% në fund të tremujorit të tretë të vitit 2016. Në të njëjtën kohë, raporti i amortizimit të borxhit të jashtëm ndaj eksportit të mallrave dhe shërbimeve qëndronte në nivelin 6.9%.

[2] Rritja agregate e nëntëmujorit të parë ishte 1.2%

Grafiku 3: Borxhi i jashtëm ndaj eksportit të mallrave edhe shërbimeve (majtas) dhe ndaj të ardhurave fiskale (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Raporti i borxhit të jashtëm afatshkurtër ndaj PBB nominale qëndronte në nivelin 14.6% në fund të tremujorit të tretë 2016. Borxhi i jashtëm afatshkurtër përbën 19.7% të borxhit të jashtëm total. Maturiteti mesatar i borxhit të jashtëm qëndron në nivelin 17.8 vite në fund të tremujorit të tretë të vitit 2016. Ky tregues ka shfaqur rritje të vazhdueshme prej vitit 2010.

Figura 1: Borxhi i jashtëm afatshkurtër ndaj PBB (majtas) dhe maturiteti mesatar i borxhit të jashtëm (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Analiza e rreziqeve ndaj qëndrueshmërisë së borxhit të jashtëm në të ardhmen dëshmon për ndjeshmëri më të lartë ndaj kursit të këmbimit krahasuar me goditjet ndaj normës së interesit. Në këtë drejtim, janë zhvilluar dy simulime paralele të goditjeve. Në skenarin e parë, interesit të borxhit të jashtëm i jepet një goditje e përhershme prej dy devijimesh standarde në horizontin e ardhshëm. Në skenarin e dytë, një zhvlerësim real i përkohshëm i monedhës vendase në masën 10% zbatohet në vitin 2016. Devijimi i trajektores së borxhit të jashtëm është qartësisht më i dukshëm në skenarin e zhvlerësimit të monedhës. Grafikët e mëposhtëm shfaqin ecurinë e raportit të borxhit të jashtëm ndaj PBB nominale sipas skenarit bazë dhe sipas secilit prej skenarëve të goditjes respektivisht.

Grafiku 4: Goditje ndaj normës nominale të interesit (majtas) dhe zhvlerësimit real të kursit të këmbimit (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Zhvillimet në rezervën valutore

Në fund të muajit shtator 2016, stoku i rezervave valutore mbulon rreth 6.8 muaj importe mallrash dhe shërbimesh dhe rreth 170% të borxhit të jashtëm afatshkurtër, duke qëndruar kështu mbi nivelin e mjaftueshëm të përcaktuar nga kriteret, me prirje të ngjashme edhe për 3 vitet në vijim.

Grafiku 5: Projeksionet e rezervës valutore në terma të mbulimit me muaj importe dhe me borxh të jashtëm afatshkurtër; niveli i pritur i rezervave valutore dhe ai i parashikuar nga modeli optimal (% ndaj PBB)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Sistemi financiar

Gjatë vitit 2016[3], treguesit e veprimtarisë së sistemit financiar ishin të qëndrueshëm. Sektori bankar rezultoi me fitim dhe me tregues të mirë të kapitalit dhe likuiditetit. Segmentet e tjera të sistemit financiar kanë zgjeruar aktivitetin. Pesha e institucioneve financiare që kryejnë aktivitet jobankar në totalin e aktiveve të sistemit financiar vijon të mbajë peshën 10%, ku peshën kryesore e kanë fondet e investimeve (4.6%). Sipas madhësisë së ekspozimeve të ndërsjella, vlerësohet që rreziku i drejtpërdrejtë i përcjelljes së rreziqeve në sektorin bankar prej segmenteve të tjera të sistemit financiar është i ulët; ndërsa qëndrueshmëria e sektorit bankar është me rëndësi

[3] Zhvillimet përgjatë vitit 2016 i referohen të dhënave më të fundit pranë Bankës së Shqipërisë- Nëntor 2016. Për treguesit tremujorë që lidhen me kapitalizimin, huanë me probleme të pambuluar nga kursi i këmbimit,mbulimi me kolateral, treguesit e riçmimit që masin rrezikun ndaj normës së interesit si dhe zhvillimet në sektorin jobankar i referohen muajit Shtator 2016.

kritike edhe për institucionet financiare jobankare. Gjatë periudhës, treguesit kryesorë të veprimtarisë së sistemit financiar ishin të qëndrueshëm, dhe ndërmjetësimi financiar shënoi zgjerim. Ky i fundit i matur nga raporti i aktiveve të sistemit ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) arriti nivelin 104.4%, duke shënuar rritje ndaj niveleve të dy viteve të fundit. Kontributin kryesor në këtë rritje e ka dhënë aktiviteti i sektorit bankar, i cili është zgjeruar me ritme më të larta se rritja e PBB-së. Struktura e aktiveve të sistemit financiar mbizotërohet nga bankat, aktivet e të cilave zënë rreth 90.2% të aktiveve të sistemit ose rreth 94.1% e PBB-së.

Sektori bankar

Përgjatë 11- mujorit të vitit 2016, sektori bankar zgjeroi veprimtarinë me ritme më të larta se një vit më parë, mbështetur kryesisht në investimet ndërbankare dhe në letra me vlerë. Treguesit prudencialë në terma të aftësisë paguese, likuditetit dhe krijimit të fondeve rezervë për rreziqet përkatëse u shfaqën në nivele të përshtatshme, duke qenë në përputhje me kërkesat rregullatore. Cilësia e portofolit eshte përmirësuar ne terma mujore, si rrjedhojë e rritjes së nivelit të shlyerjeve kombinuar dhe më procesin e vazhdueshëm të fshirjes së kredive të humbura nga bilancet e bankave. Megjithatë, cilësia e portofolit të kredisë eshte me e dobet se nje vit me pare, ku kontributin e ka dhene zgjerimi i kredive ne klasën "nënstandard". Ekspozimi ndaj rreziqeve të tregut mbetet i kontrollueshëm, por kërkon një monitorim dhe vlerësim të rregullt.

Me konkretisht:

Gjatë muajit nëntor 2016, aktivet e sektorit bankar u zgjeruan me rreth 0.9% duke arritur nivelin 1,388.3 mld Lek. Në terma vjetorë, rritja e aktiveve shënoi 5.1%, duke iu afruar ritmeve të rritjes së gjysmës së parë të vitit 2015. Kontributin kryesor në rritjen e aktiveve e ka dhënë rritja në zërat "Veprime me thesarin dhe veprime ndërbankare"[4] dhe "Veprime me letrat me vlerë"[5] dhe në një masë më të vogël, rritja në zërin "Veprime me klientë"[6] . Portofoli në titujt e borxhit qeveritar të mbajtura nga rezidentët ka qene i qëndrueshëm dhe përfaqëson rreth 22.0% të totalit të aktiveve[7] . Fondi i provigjionimit u rrit me rreth 1.9 mld Lek duke arritur në nivelin 85.6 mld Lek. Në krahasim me një vit më parë, fondi i provigjionimit ishte 2.9% më i lartë. Në financimin e veprimtarisë, depozitat nga publiku zënë rreth 82%.

Teprica e kredisë gjatë muajit nëntor u zgjerua me 0.4% duke arritur në 604 mld Lek. Zgjerimi ka ardhur kryesisht nga rritja e kredisë afatmesme me 2%. Teprica e kredisë afatgjatë, që zë peshën kryesore në tepricën e kredisë (48%), dhe kredia afatshkurtër, mbetën pothuajse të pandryshuara ndaj një muaji më parë. Kredia për bizneset (67% e totalit) u rrit me 0.5% dhe dha kontributin kryesor në zgjerimin e tepricës së kredisë. Kredia për individët u rrit me 0.3%. Kredia në Lek ka ndikuar në zgjerimin e kredisë gjatë muajit, duke u rritur në mënyrë të konsiderueshme me 3.4 mld Lek (ose me 1.4%). Teprica e kredisë në valutë, që përbën 59% të totalit të kredisë, ra me 0.3%. Kredia për rezidentët (kryesisht bizneset) u rrit me 0.5% (2.6 mld Lek), për shkak të rritjes së kredisë për blerje pajisjesh dhe asaj në formën e 'Overdraft'-it. Kredia për subjektet jo-rezidente u ngushtua lehtësisht gjatë muajit me rreth 0.2 mld Lek. Në terma vjetorë, portofoli i kredisë është zgjeruar me 1.4%, duke shënuar një rritje pozitive për të katërtin muaj radhazi. Rritja vjetore është mbështetur nga zgjerimi: i kredisë në Lek me 8.4%, kredisë afatmesme me 8.7% dhe kredisë për individët me 9.6%. Gjatë një viti, nga bilancet e bankave janë fshirë

---

[4] *Veprimet me thesarin dhe ndërbankare u rritën me rreth 7 mld lekë ose 1.5% krahasuar me një muaj më parë në nivelin 467.2 mld lekë. Kontributin kryesor e dhanë kryesisht marrëdhëniet me Bankën Qendrore në formën e llogarive rrjedhëse, të cilat u rritën me rreth 5 mld lekë, në nivelin 127.3 mld lekë. Investimet ndërbankare, në formën e llogarive rrjedhëse në bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare (kryesisht jorezidente) u rritën me 1.8 mld lekë (ose 2.6%), në nivelin 71.5 mld lekë. Ndërkohë, investimet ndërbankare në formën e "huave" ranë me rreth 2.4 mld lekë, duke zbritur në nivelin 60.9 mld lekë (kryesisht rezidente -2.0 mld lekë dhe jorezidente -332 milionë lekë). Investimet ndërbankare në formën e depozitave kanë kontribuar me rreth 210.4 milionë lekë në rritjen e aktiveve. Pavarësisht zgjerimit me rezidentët të këtij zëri (+2.0 mld lekë), rënia e vendosjeve me jorezidentët (-1.8 mld lekë), solli një kontribut neto të ulët. Në terma vjetorë, "Veprimet me thesarin dhe ndërbankare shënuan një rritje me rreth 6.7%.*

[5] *Në muajin nëntor 2016, investimet në letrat me vlerë shënuan një rritje me rreth 7.1 mld lekë (ose 2.1%), në nivelin 349.7 mld lekë. Rritja ka ardhur nga rritja e investimit të një banke në letra me vlerë të jorezidentëve në valutë. Në terma vjetorë, portofoli i letrave me vlerë u rrit me 9.6%.*

[6] *Portofoli i kredisë së sektorit bankar shënoi një rritje me rreth 2.1 mld lekë (ose 0.35%), në nivelin 599.4 mld lekë (pa përfshirë interesat e përllogaritur) kryesisht dhënë për rezidentët. Në terma vjetorë, zgjerimi mbetet i ngadaltë me rreth 1.46%.*

[7] *Gjatë muajit nëntor 2016, portofoli i bankave në bono thesari shënoi rritje me 1.8 mld lekë, duke u ngjitur në nivelin 66.6 mld lekë. Investimet në obligacione ranë me 1.6 mld lekë, duke zbritur në nivelin 239.2 mld lekë. Borxhi i qeverisë i mbajtur nga bankat u rrit me 114 milionë lekë (ose 0.04%) duke arritur në 305.8 mld lekë.*

rreth 14 mld Lek kredi të klasifikuara si të humbura[8]. Nëse nuk do të përfshihej efekti i fshirjeve, rritja vjetore e tepricës së kredisë do të ishte rreth 3.8%.
Rritja vjetore dhe mujore e kredisë se re ishte pozitive. Rritja është mbështetur nga zgjerimi i konsiderueshëm i kredisë së re kryesisht në monedhën vendase për biznesin dhe në afate më të gjata maturimi. Gjate nëntorit, vlera e kredisë se re ishte rreth 28% me e larte se ne tetor, dhe gati 8% me e larte se ne nëntor 2015.
Depozitat u rritën me rreth 7 mld Lek gjatë muajit nëntor 2016, duke regjistruar rritje për të katërtin muaj radhazi. Teprica e depozitave në fund të muajit ishte 1,137 mld Lek. Rritja ka ardhur si pasojë e rritjes së llogarive rrjedhëse me 5.3 mld Lek ose me 1.5% dhe depozitave pa afat me 2.2 mld Lek ose me 2.6%. Ndërkohë, depozitat me afat ranë me rreth 1.5 mld Lek ose me 0.2%. Rritja e depozitave është vënë re në të tre sektorët: publik, privat dhe individë. Më shumë se 90% e rritjes në stokun e depozitave ka ardhur nga rritja e depozitave në valutë me 6.4 mld ose 1.1%, të cilat vijojnë të zënë mbi 50% të depozitave të përgjithshme. Ne terma vjetore, depozitat u rritën me 4.3%. Rritja është ndikuar kryesisht nga: rritja e llogarive rrjedhëse me 27%; rritja e depozitave të individëve me 2.2% dhe rritja e depozitave në valutë me 6.6%. Depozitat me afat që përbëjnë rreth 60% të depozitave gjithsej, janë tkurrur me 6.4% në terma vjetorë.
Treguesit mesatarë të rentabilitetit shënuan renie nëntor të vitit 2016. Në krahasim me një vit më parë rezultati financiar neto (pas taksave) ra me rreth 6.9 mld Lek, në nivelin 7.3 mld Lek. Dy faktorët që kontribuan në këtë zhvillim ishin rritja e shpenzimeve për provigjione për kredi dhe, në një masë më të vogël, rënia e rezultatit neto nga interesat. Pas një periudhe kur rezultati neto nga interesat rritej si pasojë e riçmimit të depozitave, aktiviteti kryesor bankar ndikoi negativisht në fitimin e sistemit bankar, ndërkohë që të ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera shënuan një rritje të lehtë. Rezultati neto nga interesat ra me rreth 1.4 mld Lek, në 42.8 mld Lek, pasi rënia e të ardhurave nga interesat rezultoi më e lartë sesa rënia e shpenzimeve për to. Si rrjedhojë, marzhi neto nga interesat gjithashtu ra në 4.2% nga 4.4% një vit më parë. Shpenzimet për provigjione kredish u rritën me 5.7 mld Lek, duke qenë faktor kryesor në rënien e rezultatit financiar të sistemit. Rezultati nga veprimtaritë e tjera u rrit me rreth 0.9 mld Lek, si pasojë e rritjes së të ardhurave nga veprimet me letrat me vlerë. Treguesit mesatarë të rentabilitetit të sektorit bankar kanë shënuar rënie të ndjeshme: RoA ra në 0.6% (nga 1.2% një vit më parë), ndërsa RoE ra në 6.1% (nga 13% një vit më parë).
Kapitalizimi i sektorit bankar vlerësohet i mirë. Gjithsesi, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit ra në 15.6% në Shtator 2016 nga 16.1% një tremujor më parë dhe 15.8% një vit më parë . Niveli i kapitalit rregullator është mbështetur nga një rezultat financiar pozitiv dhe nga injektimi me kapital. Në Shtator 2016, kapitali rregullator u zgjerua me 3.9% krahasuar me një tremujor më parë dhe arriti nivelin 139.0 mld Lek. Aktivet e peshuara me rrezik u rritën me 7.0% duke arritur nivelin 890.9 mld Lek. Në të njëjtën kohë, aktivet e peshuara me rrezik për rrezikun e kredisë ranë me 3.2 mld Lek. Në terma vjetorë, aktivet e peshuara me rrezik shënuan një rritje më të lartë (9.8%) krahasuar me rritjen e kapitali rregullator (8.2%).
Raporti i kredive me probleme (RKMP) gjatë muajit nëntor 2016, ra me 0.9 p.p, në nivelin 20.4%. Në krahasim me një vit më parë, RKMP u rrit me 0.6 p.p nga niveli 19.9%. Teprica e kredive me probleme ra me 5 mld Lek ose me 3.9% duke arritur në nivelin 123.5 mld Lek. Nëse nuk do të përfshihej efekti i fshirjeve që, gjatë nëntorit, shënuan vlerën 1.2 mld leke, teprica e kredive me probleme do të rezultonte 124.7 mld Lek dhe rënia e saj do të ishte 3.04%. Ngushtim në stokun e kredive me probleme është vërejtur kryesisht: në kredinë me maturitet afatshkurtër; në kredinë për biznesin dhe në kredinë në Lek. Përmirësimi i cilësisë së kredisë, ose rënia në stokun e kredive me probleme ka ardhur kryesisht si rezultat i shlyerjeve të kredive në klasën "nënstandard". Kredia "nënstandard" ra me 12.8% gjatë muajit. Ndërkohë, kredia e klasifikuar si "e humbur" u rrit me 2.9% dhe vijon të zërë peshën kryesore të kredive me probleme (52.4% nga 49% një muaj më parë). Në terma vjetorë, teprica e kredive me probleme është zgjeruar me rreth 4.4% si pasojë e prurjeve të reja në klasën "nënstandard". Vlera e provigjioneve për rrezikun e kredisë zë 68.1% të kredive me probleme, duke qenë rreth 3.4 p.p më e lartë sesa në muajin paraardhës, dhe 1.4 p.p më e ulët në krahasim me një vit më parë.
Mbulimi me kolateral, një element i rëndësishëm i mbrojtjes ndaj rrezikut të kredisë, mbetet në nivel të kënaqshëm dhe te qëndrueshëm përgjatë vitit te fundit (rreth 71%), por ka shënuar rënie të dukshme në krahasim me nivelin prej 76% të fillimit të vitit 2015. Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2016, është vërejtur një zgjerim i lehtë i kredisë së kolateralizuar. Sektori bankar është i varur nga mirëfunksionimi i tregut të pasurive të paluajtshme dhe procesi i ekzekutimit te kolateralit. Cilësia e portofolit për kredinë e kolateralizuar ka ardhur duke u përkeqësuar që nga fundi i vitit 2015, si rrjedhojë e zgjerimit të stokut të kredive me probleme. RKP për

[8] *Duke filluar nga janari 2015, bankat janë detyruar nga kërkesat rregullative të ndërmarrin procesin e pastrimit të bilanceve – fshirjen e kredive që gjenden në kategorinë "të humbura" për më shumë se 3 vjet. Gjatë periudhës janar 2015-nëntor 2016 vlera totale e fshirjeve raportohet të ketë arritur në 35 mld lekë.*

kredinë e kolateralizuar u ngjit në nivelin 21.4%. Në totalin e kredive të kolateralizuara, kreditë me kolateral në formën e pasurive të paluajtshme (komerciale, rezidenciale dhe tokë) zënë 70.2% të vlerës. RKP për kredinë e kolateralizuar me pasuri të paluajtshme u zgjerua lehtësisht, në nivelin 21.1%. Rritja ka ardhur si pasojë e zgjerimit të stokut të kredive me probleme.
Treguesit e likuiditetit në monedhën vendase dhe në valutë janë mbi nivelet minimale të kërkesave rregullatore. Burim kryesor financimi vazhdojnë të jenë depozitat të cilat mbulojnë thuajse dyfishin e vëllimit të huave. Në nëntor 2016 raporti "depozita/kredi" shënon 188.2% (ndërsa "kredi/depozita" 53.2%). Sipas monedhës ky raport regjistron 215.6% për monedhën vendase dhe 169.1% për monedhën e huaj. Aktivet likuide në bilancin e bankave vazhdojnë të qëndrojnë në nivele të larta, si rrjedhojë e performancës së ngadaltë të huadhënies. Në fund të muajit nëntor, aktivet likuide përbëjnë 30.4% të totalit të aktiveve të sektorit bankar. Treguesi tjetër i likuiditetit që është raporti "aktive likuide/detyrime totale afatshkurtra" shënon 39.5% në fund të periudhës.

Vlerësimi i rreziqeve
Rreziku i kredisë vlerësohet rreziku kryesor i sektorit bankar. Pavarësisht rënies së raportit të kredive me probleme për muajin nëntor 2016, niveli i lartë i tyre tregon për vështirësinë që ka procesi i zgjidhjes së tyre dhe nevojën për monitorimin nga afër të këtij procesi.
Banka e Shqipërisë pret që prirja e kurbës së kredive me probleme të vijë në rënie, ndonëse mund të ketë luhatshmëri të vlerës së tyre përgjatë kohës. Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë do të mbikëqyrë me kujdes proaktivitetin me të cilin veprojnë bankat për të evidentuar në kohë kredinë me probleme dhe për ta provigjionuar atë, si edhe mënyrën se si ato po zbatojnë kërkesat rregullative për largimin nga bilanci të kredive të humbura.
Ekspozimi ndaj rrezikut të tërthortë të kredisë vijon të mbetet i lartë. Pesha e kredisë së pambrojtur në totalin e kredisë në valutë (44.4%), vijon të jetë e konsiderueshme, por ka shënuar një rënie të lehtë në krahasim me nivelin e një viti më parë (46.9%). Cilësia e portofolit për kredinë e pambrojtur në valutë (kryesisht në Euro) është përmirësuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2016, si pasojë e ngushtimit të stokut të kredive me probleme.
Rreziku i likuiditetit është i ulët. Vlera e ulët e raportit të kredive ndaj depozitave, vijimi i rritjes së depozitave, dhe prania e lartë e aktiveve likuide mbi kërkesat minimale të kuadrit rregullator, tregojnë për një situatë mjaft të mirë të gjendjes së likuiditetit të sektorit bankar. Kjo gjendje evidenton edhe hapësirën dhe nevojën që ekziston për përmirësimin e ndërmjetësimit financiar, si një dukuri të nevojshme për të ndikuar, mes të tjerash, në përmirësimin e eficiencës së veprimtarisë bankare. Megjithatë, këtu duhet pasur në vëmendje fakti që pesha e burimeve shumë afatshkurtra të sektorit bankar, në formën e llogarive rrjedhëse dhe të depozitave pa afat, vijon të rritet. Kjo ecuri dikton ruajtjen e niveleve të larta të aktiveve likuide dhe ndikon negativisht në ecurinë e të ardhurave nga interesat.
Sektori bankar mbetet i ekspozuar ndaj rrezikut të tregut (që përfshin rrezikun e kursit të këmbimit dhe rrezikun e normave të interesit) megjithatë ky ekspozim mbetet i kufizuar. Pozicioni i hapur neto valutor "në blerje" ndaj kapitalit rregullator ka shënuar rënie në vlerën 8.6% nga 10.0% një muaj më parë dhe nga 9.8% një vit më parë, duke paraqitur një mbrojte të kënaqëshme ndaj luhatjeve të kursit të këmimit. Rreziku direkt ndaj kursit të këmbimit në aktivitetin bankar është i limituar, pasi mjetet dhe detyrimet në valutë kanë vlera të përafërta. Rreziku rritet kur në vlerësim përfshihet dhe ndikimi i kursit të këmbimit, i transmetuar kryesisht përmes dhënies së huasë në valutë sektorëve rezidentë, të cilët i kanë të ardhurat kryesore në Lek. Ekspozimi ndaj rrezikut të tërthortë të kredisë vijon të mbetet i lartë. Pesha e kredisë së pambrojtur në totalin e kredisë në valutë (44.4%), vijon të jetë e konsiderueshme, por ka shënuar një rënie të lehtë në krahasim me nivelin e një viti më parë (46.9%).
Si bankat ashtu dhe klientët huamarrës duhet të vlerësojnë me kujdes rreziqet që rrjedhin nga huadhënia në valutë, ku palët janë të ekspozuar nga lëvizjet e pafavorshme të kursit të këmbimit.
Rreziku i normës së interesit është prezent në aktivitetin bankar në mënyrë direkte dhe indirekte. Rreziku direkt i normës së interesit shfaqet përmes diferencës që ekziston midis mjeteve dhe detyrimeve të sektorit bankar sipas periudhave të riçmimit. Kjo diferencë është negative dhe kryesisht më e thelluar për periudhën afatshkurtër. Pozicioni negativ në Lek dhe në euro ka rezultuar fitimprurës në mjedisin e karakterizuar nga rënia e vazhdueshme e normave të interesit, në kushtet kur rivendosja e pasiveve me vlera më të ulëta interesi është në vlerë më të madhe se ajo e aktiveve për të njëjtën periudhë, Gjithsesi, në rast se mjedisi financiar do të shoqërohej me një rritje të shpejtë të normës së interesit në Lek dhe euro, efekti në rezultatin financiar të sektorit bankar do të ishte i negativ. Ky efekt do të zbutej disi në afat më të gjatë nga pesha e lartë e kredisë me normë të ndryshueshme interesi (rreth 89% e totalit).
Prania e ndjeshme e bankave të huaja në vend si edhe ekspozimi i sektorit bankar me jorezidentët, ruan nevojën për monitorimin e afërt të zhvillimeve ndërkombëtare. Gjatë vitit 2016, tregjet financiare evropiane treguan një

rritje të luhatshmërisë në veprimtarinë e tyre në fund të saj, në vijim të rezultatit disi të papritur të “Brexit”. Lëvizjet më të mëdha ishin në tregjet e këmbimit të valutave, ku monedha britanike u nënçmua me shpejtësi. Humbja e vlerës së monedhës britanike, mund të shoqërohej në afat të shkurtër me rënie të vlerës së produkteve bankare shqiptare në këtë monedhë. Nga analiza e kryer, Banka e Shqipërisë vlerësoi se ky efekt ishte minimal, pasi kredia dhe depozitat e publikut në monedhën britanike ishin në vlera të papërfillshme.

Ndryshime rregullative dhe mbikëqyrëse të planifikuara

Në mënyrë që të trajtohet niveli i konsiderueshëm i euroizimit në sistemin financiar dhe ekonomi, dhe kontrolli mbi ndikimin negativ që euroizimi ka mbi qëndrueshmërinë financiare dhe efektivitetin e politikës monetare, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave janë duke diskutuar mbi një strategji për të vepruar kundër këtij fenomeni. Strategjia do të rikonfirmojë angazhimin e Qeverisë dhe Bankës së Shqipërisë për të ndjekur politika që do të mbështesin qëndrueshmërinë makroekonomike e financiare, si parakusht për ruajtjen e besimit në monedhën kombëtare dhe për të arritur një rritje të qëndrueshme ekonomike.Përveç kësaj, strategjia gjithashtu do të identifikojë fushat përkatëse të përgjegjësisë ku masat do të ndërmerren nga autoritetet për të forcuar përdorimin e monedhës kombëtare.

Nga pikëpamja e Bankës së Shqipërisë, masat e mundshme do të përfshijnë zbatimin e një norme më të lartë të rezervës së kërkuar për depozitat në monedhë të huaj, nivele më të larta rregullatore për aktivet likuide në monedhë të huaj dhe kërkesa më të forta për të rritur ndërgjegjësimin e huamarrësit mbi rreziqet që shoqërojnë huamarrjen në monedhë të huaj.

Me mirëkuptimin se këto masa do të jenë të dobishme në kuadër të qëndrueshmërisë financiare dhe politikës monetare në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, i duhet kushtuar vëmendja e duhur që të sigurohet që prezantimi i këtyre masave mos të shkaktojë luhatshmëri të panevojshme në treguesit e sektorit bankar në periudhën afatshkurtër. Prandaj, është parashikuar një përqasje graduale në implementimin e masave.

2.3. Skenarë alternativë dhe risqet

Skenari bazë vlerësohet të ketë një shans relativ më të lartë për t’u materializuar. Megjithatë parashikimi i skenarëve alternative - duke supozuar se një pjesë e arsyeshme e rreziqeve të ndryshme që rrethojnë skenarin bazë mund të materializohen – janë një komponent i rëndësishëm i planifikimit të financave publike. Me qëllim ngritjen e cilësisë së planifikimit, për të pasur një menaxhim më efikas të fondeve publike në çdo situatë që ka një probabilitet të caktuar që të ndodhë, më poshtë janë paraqitur shkurtimisht dy skenare alternative, veçanërisht një "pesimist" dhe një "optimist".

Sejcili prej skenarëve alternativë supozon që një grup rreziqesh negativë (në rast të një skenari "pesimist") ose pozitivë (në rastin "optimist") do të materializohen. Ky grup i rreziqeve supozon devijime nga parashikimet përkatëse të skenarit bazë për disa indikatorë bazë makroekonomikë, duke përfshirë kreditimin në ekonomi, performancën e ekonomisë së eurozonës me efekte të njëpasnjëshme mbi eksportet e mallrave dhe shërbimeve, për remitancat, në qarkullimin e kapitalit të huaj si dhe kursit të këmbimit, masat e ndikimeve gjithëpërfshirëse dhe ritmin e politikave të planifikuara të reformave strukturore për periudhën afatmesme dhe në vazhdim, etj. Efekti i përgjithshëm neto i të gjitha rreziqeve të supozuara, negative ose pozitive, përcaktohet dhe prezantohet në termat e një variabli të vetëm të rritjes reale ekonomike. Për më tepër, skenarët alternativë bazohen në supozime të ndryshme të rritjes ekonomike nga skenari bazë për sejcilin vit 2017-2019. Implikimi i skenarëve të ndryshëm makroekonomik në kuadrin fiskal shpejgohen në seksionin 3.6.

Tabela 4: Supozimet alternative në secilin skenar

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
						Par.	Par.	Par.	Par.	Par.
Rritja reale e PBB (%)										
Bazë	3.7	2.5	1.4	1.0	1.8	2.6	3.4	3.8	4.1	4.2
Pesimist								2.3	2.6	2.7
Optimist								4.8	5.1	5.2
PBB nominal (në miliard Lek)										
Bazë	1,240	1,301	1,333	1,350	1,394	1,435	1,502	1,596	1,707	1,833
Pesimist							0	1,573	1,659	1,755
Optimist							0	1,612	1,740	1,886
Të ardhurat (% të PBB)										
Bazë	26.2	25.4	24.8	24.2	26.3	26.4	27.6	27.3	27.3	27.3
Pesimist						26.4	27.1	26.8	26.8	26.8
Optimist						26.4	27.6	27.3	27.3	27.3
Defiçiti fiskal (në miliard Lek)										
Shënim: Deficiti i përgjithshëm fiskal në terma nominale për çdo skenar alternativ targetohet të jetë më tepër (më pak) në rastin e skenarit pesimist (optimist) se defiçiti nominal i skenarit bazë me diferencë në 50% të të ardhurave totale ndërmjet skenarit bazë dhe skenareve të tjerë alternativ										
Bazë	-38.0	-45.8	-45.9	-66.9	-72.1	-58.2	-35.7	-31.2	-30.9	-17.5
Pesimist							-35.7	-38.3	-41.7	-32.6
Optimist							-35.7	-29.1	-26.4	-10.3

3. KUADRI FISKAL

3.1. Implementimi i buxhetit për 2016

Zbatimi i buxhetit të shtetit në kohë dhe në respekt të përcaktimeve ligjore, përveçse një faktor orientues, është edhe një instrument stimulues për aktivitetin ekonomik nëpërmjet ekzekutimit të shpenzimeve publike. Realizimi me efektivitet i shpenzimeve buxhetore sipas programit, mbetet një prioritet i Qeverisë, duke krijuar në këtë mënyrë një pasqyrë të saktë të shpenzimeve 11 mujore të realizuara për vitin 2016. Ministria e Financave ka kontribuar në lehtësimin e këtij procesi duke harmonizuar kërkesat e institucioneve buxhetore me politikën fiskale të Qeverisë dhe si rezultat i monitorimit të vazhdueshëm, ka trajtuar me kompetencë çdo specifikë të luhatjes së shpenzimeve qeveritare.

Tabela 5: Treguesit fiskalë të konsoliduar për 11 mujorin e vitit 2016 (në milion Lek)

Emertimi	Nentor 2016		Diferenca		Viti 2016	
	Plan	Fakt	Fakt-Plan	ne % mbi Plan	Plani Vjetor	% e realizimit vjetor
Te ardhurat e pergjithshme	373,682	368,310	-5,372	98.6%	414,494	88.9%
Shpenzimet e Pergjithshme	388,039	361,216	-26,823	93.1%	450,224	80.2%
Shpenzimet Korente	*335,627*	*316,433*	*-19,194*	*94.3%*	*382,466*	*82.7%*
Shpenzimet Kapitale	*46,286*	*44,783*	*-1,503*	*96.8%*	*59,258*	*75.6%*
Deficit/Suficit	-14,357	7,094	21,451	-49.4%	-35,730	-19.9%

Burimi: Ministria e Financave

Të ardhurat e përgjithshme për 11 mujorin e vitit 2016 arritën në 368 miliardë lek me një realizim prej 98.6 për qind të planit të periudhës dhe 88.9 përqind të plani vjetor. Krahasuar me një vit më parë të ardhurat totale ishin 7.3 përqind më të larta. Të ardhurat nga ndihmat për 11mujorin ishin 10.6 miliardë lek, rreth 696 milionë lek mbi planin e periudhës dhe rreth 2 miliardë lek më shumë se një vit më parë.

Të ardhurat që administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për periudhën 11 mujore 2016 janë realizuar në nivelin 98.75%, duke shënuar një përmirësim të ndjeshëm të përformancës së të ardhurave krahasuar me periudhat e mëparshme. Këto të ardhura, përbëjnë 21.13% të PBB-së me një përmirësim 0.23% e PBB-së krahasuar me vitin 2015. Ky rezultat është efekt i drejtpërdrejtë i mirëadministrimit në tatime dhe dogana gjatë vitit 2016, përpjekjeve intensive për uljen e informalitetit në ekonomi si edhe e rritjes së nivelit të pajtueshmërisë së tatimpaguesve me ligjin, përmes parimit të vetëkorrigjimit.

Tabela 6: …

Tatime dhe dogana	Buxheti zyrtar 11-2016	Fakt11- 2016	Diferencë	+/ - %
Tatimi mbi vlerën e shtuar	124,860	119,179	-5,681	-4.55%
Tatimi mbi fitimin	21,580	26,179	4,599	21.31%
Akciza	39,737	38,064	-1,673	-4.21%
Tatimi mbi të ardhurat personale	29,240	28,964	-276	-0.94%
Taksa Nacionale dhe të tjera	34,086	32,468	-1,618	-4.75%
Taksa Doganore	5,466	5,502	36	0.66%
Totali "Tatime dhe Dogana"	**254,969**	**250,356**	**-4,613**	**-1.81%**
Kontribute nga DPT	68,370	68,930	560	0.82%
Totali	**323,339**	**319,286**	**-4,053**	**-1.25%**

Burimi: Ministria e Financave

Niveli aktual i realizimit të të ardhurave, reflekton edhe ndikimin e një sërë faktorësh të jashtëm, si më poshtë:

- Çmimi i naftës, sipas indeksit europian Brent, shënoi një rënie në terma vjetore, çka është reflektuar edhe në uljen e çmimit të karburantit në tregun e brendshëm. Kjo rënie ka ndikuar në ulje të nivelit të të ardhurave tatimore dhe doganore, krahasuar me projeksionet e TVSH-së dhe Rentës Minerare.
- Konjuktura në rënie e çmimeve të mineraleve të tjera si kromi dhe bakri, kanë prodhuar një tjetër goditje në të ardhura, si rezultat i uljes me 10% të sasive të eksportuara krahasuar me vitin 2015, masë e cila është reflektuar në realizimin e të ardhurave nga renta.
- Stimuli monetar i aplikuar nga Banka e Shqipërisë, përmes uljes së normës bazë të interesit në kufijtë minimalë, është reflektuar në një ulje të të ardhurave nga interesat dhe tatimit të lidhur me to.

Tabela 7: Të ardhurat nga Administrata Doganore janë realizuar në masën 134.4 miliard Lek, në nivelin 96% ndaj planit

Administrata Doganore	Buxheti zyrtar 11-2016	Fakt 11-2016	Diferenca	+/ - %
Taksa doganore	5,466	5,502	36	0.66%
Tatimi mbi vlerën e shtuar	90,960	88,355	-2,605	-2.86%
Akciza	39,737	38,064	-1,673	-4.21%
Renta minerare	3,766	2,523	-1,243	-33.01%
Totali	**139,929**	**134,444**	**-5,485**	**-3.92%**

Burimi: Ministria e Financave

Performanca e të ardhurave nga TVSH në import është ndikuar në një masë të rëndësishme nga disa faktorë:

- Rënia e çmimit të karburantitit në bursat ndërkombëtare ku kuotohen këto produkte.
- Rënia e importit të energjisë elektrike si rezultat i rritjes se prodhimit vendas dhe disiplinimit të konsumit.
- Rritja e importit të makinerive dhe pajisjeve të përjashtuar nga TVSH me 165.4% krahasuar me një vit më parë, si rezultat i intensifikimit të investimeve, përfshirë projektin TAP të përjashtuara nga TVSH.

Performanca e të ardhurave nga akciza, për periudhën janar-nëntor 2016, është ndikuar nga dy faktorë kryesorë:

- Zhvendosja në kohë e punimeve të Projektit TAP dhe intensifikimi i tyre në tremujorin e fundit të vitit 2016, e kryesisht në vitin 2017, ndikoi në konsumin e planifikuar me rritje për karburantet në periudhën në fjalë.
- Deklarimi i prodhimit të duhanit të vendit, në nivele më të ulëta së planifikimi.

Performanca e të ardhurave nga renta minerare për periudhën, u ndikua nga efekti i rënies së çmimit në bursë të naftës bruto krahasuar me vitin 2015. Në kushtet që renta llogaritet si përqindje ndaj vlerës, rezultoi se megjithëse sasia e eksportit të naftës bruto u rrit, të ardhurat nga renta u ulën, krhasuar me vitit 2015.
Realizimi i të ardhurave nga renta për 11- mujorin 2016 shënon vlerën 2.5 miliard Lek, 1.2 miliard Lek më pak se plani. Ky nivel realizimi i të ardhurave nga renta minerare reflekton edhe efektin e konjukturave të çmimit ndërkombëtar të mineraleve duke sjellë uljen e sasisë dhe vlerës për njësi të mineralit të eksportuar.
Realizimi i të ardhurave nga taksa doganore për 11-mujorin 2016 shënon vlerën 5.5 miliard Lek ose 277 milionë Lek më shumë se plani. Faktor kryesor në përmirësimin e performancës është rritja e importit të taksuar me mbi 4% dhe përmirësimi i kontrollit doganor.
Të ardhurat nga Administrata Tatimore për 11 mujorin 2016 janë realizuar në masën 184.8 miliard Lek (së bashku me kontributet, duke tejkaluar nivelin e programuar me 0.78%)

Tabela 8: ...

Administrata Tatimore	Buxheti zyrtar 11-2016	Fakt 11- 2016	Diferenca	Në %
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	33,900	30,824	-3,076	-9.07%
Tatim mbi Fitimin	21,580	26,179	4,599	21.31%
Tatimi mbi të ardhurat personale	29,240	28,964	-276	-0.94%
Taksa Nacionale dhe të tjera	30,320	29,945	-375	-1.24%
Totali	**115,040**	**115,912**	**872**	**0.76%**
Kontribute nga DPT	*68,370*	*68,930*	*560*	0.82%
Totali	**183,410**	**184,842**	**1,432**	**0.78%**

Burimi: Ministria e Financave

Të ardhurat nga TVSH-ja, janë realizuar në masën 30.8 miliard Lek. Gjatë kësaj periudhe ka patur rritje të rimbursimeve të TVSH-së. Deri në fund të muajit nëntor të vitit 2016 janë rimbursuar 7.9 miliard Lek ose 21.9% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Një tjetër faktor është rënia e konsiderueshme e sasisë së karburantit të prodhuar në vend. Rënia e prodhimit vendas dhe për pasojë rritja e importit të karburantit, ka sjellë një zhvendosje të të ardhurave nga TVSH-ja, nga tatimet në dogana, me rreth 1 miliardë Lek.
Gjatë periudhës janar – nëntor 2016, tatimi mbi fitimin përbën zërin me ecurinë më të mirë të Administratës Tatimore. Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin janë realizuar në masën 26 miliard Lek, pra rreth 4.5 miliard Lek ose 21.3% më shumë sesa plani. Ndikimin kryesor në këtë rezultat, ka patur rritja e ndërgjegjësimit të taksapaguesve për deklarimin real të të ardhurave të realizuara, në kuadër të fazë së dytë të betejës kundër informalitetit në ekonomi dhe intensifikimit të komunikimit të Administratës Tatimore me tatimpaguesit.
Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale për 11 mujorin janë realizuar në masën 28.9 miliard Lek, duke shënuar një mosrealizim ndaj planit me rreth 276 milion Lek ose -1.24% të planit të periudhës.
Të ardhurat nga taksat nacionale, janë realizuar në masën 30 miliard Lek.
Të ardhurat e mbledhura (përfshirë kontributet) për 11-mujorin e vitit 2016 janë realizuar në vlerën 184.8 miliard Lek, 20.6 miliard Lek ose 11% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Grafiku 6: Të ardhurat sipas taksave (DPT) Fakt 2016/Plan 2016/Fakt 2015



Burimi: Ministria e Financave

Të ardhurat nga kontributet e DPT për 11-mujorin 2016 janë 12.5% më shumë krahasuar me vitin 2015 dhe 0.8% më shumë krahasuar me planin e vitin 2016. Grafiku i mëposhtëm paraqet performancën e kontributeve ndër vite.

Grafiku 7: Performanca e kontributeve 11-mujore ndër vite



Burimi: Ministria e Financave

Të ardhurat nga pushteti vendor për 11-mujorin e 2016 arritën vlerën e 14 miliardë Lek, duke shënuar një rritje vjetore (krahasuar me me të njejtën periudhë të 2015) prej 28.1 përqind dhe me një realizim për periudhën me 5.4 përqind më shume sesa plani. Kjo rritje në të ardhurat e pushtetit vendor ka ardhur nga rritja e nënzërave të saj ku taksa mbi pasurinë (ndërtesat) dhe taksat lokale u rritën për 11-mujorin respektivisht me 21.5 përqind dhe 69.4 përqind, ndërsa taksa mbi biznesin e vogël ndikoi negativisht në rritje.

Të ardhurat nga fondet speciale për 11-mujorin e 2016 arritën vlerën e 72.7 miliardë Lek, duke shënuar një rritje vjetore (krahasuar me me të njejtën periudhë të 2015) prej 10.9 përqind dhe me një realizim për periudhën me 0.5 përqind më shumë sesa plani. Të ardhurat nga sigurimet shoqërore dhe sigurimet shëndetësore u rritën për 11-mujorin e 2016 (krahasuar me të njejtën periudhë të 2015) respektivisht me 11.3 përqind dhe 17.7 përqind, duke tejkaluar lehtë planin me 0.1 përqind dhe 5.5 përqind. Ndërsa të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve kanë shënuar rënie me 17.7% përqind krahasuar me 11 mujorin e vitit të kaluar 2015, por duke ju përmbajtur planit dhe duke e kaluar atë me 5.5%.

Të ardhurat jotatimore për 11-mujorin e 2016 arritën vlerën e 20.7 miliardë lek, duke shënuar një rënie vjetore (krahasuar me me të njejtën periudhë të 2015) prej 14.0%, dhe me një mosrealizim për periudhën prej 10.9% më pak sesa ishte planifikuar. Transferimi i fitimit nga Banka e Shqipërisë për 11 mujorin e 2016, ka shënuar një rritje në krahasim me 11 mujorin e kaluar të 2015 prej 15.1 përqind, duke e realizuar ekzaktësisht planin e periudhës.

Shpenzimet e përgjithshme publike për 11 mujorin e vitit 2016, arritën në rreth 361 miliardë Lek me një realizim në masën 93 përqind të planit të periudhës.

Gjatë 11 mujorit është ndjekur një politikë e kujdesshme për realizimin e shpenzimeve buxhetore, duke synuar kufizimin e shpenzimeve të panevojshme, kryesisht shpenzimeve korrente, dhe rritjen e shpenzimeve që sjellin vlerë të shtuar në ekonomi.

Shpenzimet kapitale në raport me planin 11 mujor janë realizuar në masën 97 përqind, duke ruajtur nivelin e mirë të realizimit, në përputhje me objektivat e programimit.

Grafiku 8: Shpenzimet e përgjithshme dhe ritmi i rritjes së tyre (në milion Lek)



Burimi: Ministria e Finance

Në terma vjetorë, shpenzimet e përgjithshme për 11 muajt e parë të 2016 u realizuan në masën 80 përqind të planit vjetor. Shpenzimet faktike, krahasuar me planin e periudhës 11 mujore, janë realizuar në masën 93 përqind, duke ruajtur një trend të qendrueshëm. Shpenzimet korente ashtu edhe ato kapitale, kanë shënuar një realizim të mirë, në nivelin respektivisht 94.3 përqind dhe 97 përqind të planit të periudhës. Treguesit e buxhetit të konsoliduar për 11 mujorin që lamë pas, reflektojnë njëkohësisht edhe ndryshimet e muajit Korrik 2016, përmes Aktit Normativ të Buxhetit 2016.

Shpenzimet korrente paraqesin një realizim në raport me planin 11 mujor të këtij viti, prej 94.3 përqind, duke rezultuar në 316.4 miliardë Lek nga 335.6 miliardë Lek të planifikuara. Zërat kryesorë që ndikuan në nivelin e realizimit të shpenzimeve korrente kundrejt planit 11 mujor janë përkatësisht: shpenzimet e personelit me 98 përqind, shpenzimet për fondet speciale me 96 përqind, shpenzimet operative mirëmbajtje me 95 përqind, shpenzimet e tjera sociale me 98 përqind. Niveli i realizimit trealizimit të shpenzimeve publike dhe realizimi pothuajse i plotë i të ardhurave të planifikuara, në masën 99 përqind të planit të periudhës, është shoqëruar me një nivel sufiçiti prej afërsisht 7.1 miliardë Lek. Nga sa më sipër, vërehet qartë që në 11 mujorin e vitit 2016, performanca fiskale dhe buxhetore ka qënë në nivele shumë të mira duke realizuar planin e të ardhurave.

Grafiku 9: Shpenzimet Korrente dhe ritmi i rritjes së tyre (në milion Lek)



Burimi: Ministria e Financave

Shpenzimet e Personelit, gjatë periudhës Janar-Nëntor 2016, përfaqësuan rreth 19 përqind të totalit të shpenzimeve korente. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 61.3 miliard Lek, realizon nivelin e parashikuar për këtë zë në planin e periudhës 11 mujore, në masën 98 përqind.

Grafiku 10: Shpenzimet e Personelit dhe ritmi i rritjes së tyre (në milion Lek)



Burimi: Ministria e Financave

Shpenzimet për Paga, në fund të 11 mujorit 2016, u realizuan në masën 99 përqind e planit të periudhës, duke qenë rreth 6.3 përqind më të ulta se e njëjta periudhë e vitit 2015, ose rreth 3.5 miliard më pak. Për rrjedhojë, edhe shpenzimet për sigurime shoqërore ndoqën të njëjtin trend me to, duke rezultuar rreth 5.7 përqind më të ulta se një vit më parë. Ky reduktim vjen në kuadër të thellimit të procesit të decentralizimit si rezultat i zbatimit të reformës administrative-territoriale, ku në fillim të vitit 2016 një numër funksionesh kaluan në kompetencë të bashkive të reja, duke përfshirë numrin e punonjësve dhe shpenzimet e lidhura me:

- Personelin edukativ dhe mbështetës në arsimin parashkollor;
- Personelin mbështetës të arsimit parauniversitar;
- Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri;
- Shërbimi pyjor, etj.

Realizimi faktik i këtyre zërave së bashku, është në nivelin 98 përqind krahasuar me planin e periudhës, ose rreth 91 përqind e planit vjetor të tyre.

Grafiku 11: Shpenzimet e pagave dhe ritmi i rritjes së tyre (në milion Lek)



Burimi: Ministria e Financave

Shpenzimet për Interesa, gjatë periudhës 11 mujore janar-nëntor 2016, kanë përfaqësuar rreth 10.8 përqind të shpenzimeve korente. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 90 përqind të planit të periudhës. Në raport me planin vjetor prej 43 miliard Lek, në nivel 11 mujori këto shpenzime janë realizuar në masën 79 përqind të tij, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2015, ky zë ka rezultuar rreth 4.3 përqind më i ulët, me një kursim nominal në masën 1.5 miliard Lek.

Grafiku 12: Shpenzimet për interesa (në milion Lek)



Burimi: Ministria e Financave

Shpenzimet Operative & Mirëmbajtje, gjatë 11 mujorit që lamë pas, kanë rezultuar me një realizim në masën 95 përqind kundrejt planit të periudhës, ose rreth 80 përqind e planit vjetor. Grafiku i mëposhtëm tregon nivelin e tyre krahasuar me të njëjtën periudhë të viteve paraardhëse.

Grafiku 13: Shpenzimet operative dhe ritmi i rritjes së tyre (në milion Lek)



Burimi: Ministria e Financave

Shpenzimet për Subvencione, në fund të periudhës 11 mujore janar-nëntor 2016, arritën nivelin 1.4 miliard Lek, me një realizim në masën 94 përqind ose rreth 84 milion Lek më pak se plani i periudhës. Në raport me planin vjetor ky zë rezulton i realizuar në masën 83 përqind, ndërkohë që kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2015 shpenzimet për subvencione rezultojnë rreth 7.9 përqind ose rreth 123 milion Lek më të ulta.

Grafiku 14: Shpenzimet për Subvencione dhe ritmi i rritjes së tyre (në milion Lek)



Burimi: Ministria e Financave

Shpenzimet për Fondet Speciale për 11 mujorin 2016 rezultuan në nivelin 131.1 miliard Lek, me një realizim prej rreth 96 përqind kundrejt planit të periudhës 11 mujore. Përkatësisht, shpenzimet për Sigurime Shoqërore u realizuan në masën 98 përqind, shpenzimet për sigurime shëndetësore në rreth 95 përqind dhe ato për kompensimin e ish-pronarëve në masën rreth 38 përqind, të planit të periudhës. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2015, shpenzimet për sigurime shoqërore janë rreth 3.9 miliard më të larta dhe shpenzimet për sigurime shëndetësore rreth 1.5 miliard më shumë.

Grafiku 15: Shpenzimet për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore (në milion Lek)



Burimi: Ministria e Financave

Shpenzimet për Papunësinë për 11 mujorin 2016 janë realizuar në masën 83 përqind e planit të periudhës ose rreth 75 përqind e planit vjetor. Këto shpenzime ruajnë pak a shumë të njëjtin nivel në terma nominalë planifikimi dhe realizimi, si në periudhat paraardhëse.
Shpenzimet për Ndihmën Ekonomike dhe Pagesen e Paaftësisë (PAK) në 11 mujorin 2016 u realizuan në masën 99.7 përqind ose 52 milionë Lek më pak kundrejt planit të periudhës. Në raport me planin vjetor janë realizuar në masën 91 përqind të tij. Kundrejt të njëtës periudhë të vitit 2015 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 10.3 përqind, ose rreth 1.6 miliardë Lek në terma nominalë.

Grafiku 16: Shpenzimet për Ndihmën Ekonomike, PAK dhe Papunësinë (në milion Lek)



Burimi: Ministria e Financave

Kompensimi për ish-të Përndjekurit Politikë, në fund të 11 mujorit 2016 arriti nivelin 1.5 miliard Lek, me një realizim në masën 84 përqind të planit të periudhës dhe rreth 76 përqind e planit vjetor. Ecuria e shpenzimeve për këtë zë është e lidhur ngushtë me ritmin dhe korrektësinë e aplikimit dhe kompletimit të dosjeve nga ana e përfituesve, proces i cili kërkon një kohë të konsiderueshme.
Shpenzimet për Pushtetin Vendor, gjatë periudhës 11 mujore kanë përbërë rreth 10.9 përqind të shpenzimeve korente, duke dështuar angazhimin dhe përpjekjen e qeverisjes qendrore për rritjen e shpenzimeve dedikuar njësive të qeverisjes vendore. Niveli aktual i realizimit të tyre prej rreth 34.4 miliard Lek, rezulton të jetë në masën 85 përqind të planit të periudhës ose rreth 67 përqind e planit vjetor. Kundrejt të njëtës periudhë të vitit 2015 ky nivel rezulton rreth 6.8 miliard më i lartë, ose rreth 24.5 përqind më shumë. Kjo rritje vjen në kuadër të përforcimit të rolit të njësive të reja/të riorganizuara të qeverisjes vendore.

Grafiku 17: Shpenzimet e Pushtetit Vendor dhe ritmi i rritjes së tyre (në milion Lek)



Burimi: Ministria e Financave

Shpenzimet kapitale, në vijim të analizës së ecurisë së realizimit të investimeve për 11 mujorin e vitit 2016 është konstatuar një realizim në masën 97 përqind, në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë. Konstatojmë së në krahasim me një muaj më parë, është ruajtur niveli i mirë i realizimit, duke paraqitur në këtë mënyrë ecurinë e kënaqshme të procesit të disbursimit të financimeve në investime. Njëkohësisht, ecuria e punimeve dhe e shlyerjes së projekteve të investimit ka shënuar gjithashtu një performancë shumë të mirë.

Grafiku 18: Shpenzimet Kapitale dhe ritmi i rritjes së tyre (në milion Lek)



Burimi: Ministria e Financave

Grafiku 19: Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në milion Lek)



Burimi: Ministria e Financave

Grafiku i mëposhtëm paraqet ndarjen e shpenzimeve publike faktike për 11 mujorin e vitit 2016, në milionë Lek. Shpenzimet korrente për këtë periudhë përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve totale faktike me 87.6 përqind, kurse shpenzimet kapitale përbëjnë rreth 12.4 përqind të tyre.

Grafiku 20: Detajimi i Shpenzimeve Buxhetore (në milion Lek)



Burimi: Ministria e Financave

Sikurse evidentohet nga tabela e treguesve fiskalë të konsoliduar, të ardhurat totale në 11 mujorin 2016 janë realizuar në masën 368.3 miliardë Lek ose rreth 99 përqind në raport me planin e periudhës. Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme është 361 miliardë Lek ose rreth 93 përqind kundrejt planit të periudhës. Kjo situatë është shoqëruar me një suficit buxhetor prej afërsisht 7.1 miliardë Lekë. Grafiku i mëposhtëm tregon qartë tendencat pozitive të treguesve kryesorë të buxhetit.

Grafiku 21: Të ardhurat, shpenzimet dhe deficiti/suficiti - Plan vs Fakt 2016 (në milion Lek)



Burimi: Ministria e Financave

3.2. Perspektiva buxhetore afatmesme

Konsolidimi fiskal, përshpejtimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme dhe reduktimi i borxhit publik përbëjnë objektivat kryesor të politikës fiskale për periudhën 2017-2019.

Objektiva makro-ekonomikë dhe fiskal për vitin 2017 do të jenë:

- Reduktimi i borxhit publik në nivelin 68.9% nga 71.0% e PBB, i parashikuar në fund të vitit 2017.
- Rritje reale ekonomike në nivelin 3.8% nga 3.4% që ishte në vitin 2016.
- Mbajtja e shpenzimeve kapitale në nivelin 4.7% e PBB, të fokusuar në sektorët prioritarë si: furnizimi me

ujë dhe kanalizime; inovacioni, turizmi, infrastruktura qendrore dhe vendore etj.

Ligji i Buxhetit për vitin 2017 do të mbështesë reformat kryesore në ekonomi si: (i) reforma në drejtësi; (ii) reforma e administratës publike; (iii) reforma e pensioneve; (iv) reforma administrative dhe territoriale (v) reforma e ujit. Këto reforma do të përbëjnë instrumenta të rëndësishëm për zbatimin e prioriteteve të programit të qeverisë në përputhje me interesat e qytetarëve për të përmirësuar nivelin e tyre të jetesës.

Në programimin e të ardhurave tatimore për vitin 2017, janë marrë në konsideratë të gjithë faktorët relevantë me ndikim në buxhet, përfshirë efektin e rritjes ekonomike, politikat e kujdesshme fiskale si dhe efektet me fokus rritjen e nivelit të pajtimit me ligjin nga tatimpaguesit.

Metodologjia e programimit të të ardhurave është bazuar në modelet bashkëkohore të programimit, të sugjeruara dhe aplikuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe në analizën e detajuar të faktorëve që ndikojnë në secilën taksë.

Metodologjia e përdorur në planifikim, ka harmonizuar faktorët makroekonomikë, me treguesit kryesorë që ndikojnë në taksa specifike. Janë analizuar në veçanti sasitë dhe çmimet e mallrave kryesorë të importit dhe prodhimit vendas që mbulojnë mbi 90% të vlerës së të ardhurave totale duke vlerësuar:

- Kursin e pritshëm të këmbimit të dy monedhave kryesore: USD dhe EURO me Lekun.
- Çmimet në Bursë që ndikojnë në të ardhurat nga TVSH-ja dhe Renta minerare.
- Sasitë e pritshme të importit dhe prodhimit.
- Ndryshimet e raporteve midis prodhimit vendas dhe importit për energjinë elektrike, karburantet, pijet alkoolike, birra, etj.
- Ndryshimet e raporteve midis prodhimit vendas dhe eksportit të mineraleve, naftës bruto, prodhimeve bujqësore.
- Ndikimin e projekteve të mëdha në infrastrukturë siç janë Projekti TAP, hidrocentralet, infrastruktura.
- Rritja e të ardhurave nga akciza për karburantet, cigaret, pijet etj, si rezultat i rritjes së pritshme në sasi të tyre, në përputhje me konsumin. Janë programuar të zhdoganohen në sasi 200 ton ose 7% më shumë cigare krahasuar me realizimin e pritshëm 2016, që parashikohet të jetë 3000 ton ose 29% me shumë se në vitin 2015. Po kështu është parashikuar rritja e konsumit të karburanteve në përputhje me rritjen ekonomike dhe nevojat e tregut.
- Rritja e të ardhurave nga Renta minerare dhe TVSH-ja, si rezultat i zgjerimit të bazës së taksimit për shkak të rritjes së çmimeve ndërkombëtare të karburanteve. Rritja e çmimit të karburanteve me rreth 20%, krahasuar me muajin Gusht 2016 për shkak të vendimit të OPEC për të ulur prodhimin dhe përforcim të kontrollit në prodhim, përpunim dhe tregtim të naftës vendase.
- Rritja e të ardhurave nga TVSH-ja në import dhe TVSH-ja brenda vendit, e shoqëruar me programimin e fondeve të nevojshme për rimbursimin në kohë të tatimpaguesve.
- Rritja e të ardhurave nga Tatimi mbi fitimin, e cila reflekton rritjen e deklarimit dhe qarkullimit të realizuar të operatorëve ekonomikë.
- Rritja e të ardhurave nga Tatimi mbi të ardhurat personale si dhe të kontributeve të sigurimeve, e cila mbështetet si në efektet e rritjes së pagave të sektorit buxhetor ashtu edhe në efektet e fushatës anti-informalitet.
- Efektet e pritshme pozitive të ligjit për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme, të cilat për vitin 2017 llogariten të jenë rreth 1.1 miliardë Lek.

Parashikimi i të Ardhurave 2017, synon konsolidimin e mëtejshëm fiskal, forcimin institucional dhe përmirësimin e administrimit fiskal në mbështetje të rritjes ekonomike të qëndrueshme duke nxitur rritjen e prodhimit dhe eksportet.

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat duke përfshirë kontributet, për vitin 2017, vlerësohen të jenë në shumën rreth 376 miliardë Lek, rreth 23.67 miliardë Lek ose 6.9% më shumë se parashikimi i vitit 2016. Vetëm të ardhurat që administrohen nga DPT dhe DPD parashikohet të jenë 299 miliardë Lek ose 21.37 miliardë Lek më shumë se 2016

Tabela 9: …

(në milion lekë)

Tatime dhe Dogana	Fakt 2015	Plan 2016	Pritshmi 2016	Diferenca I pritshmi 2016 / Plani 2016	Buxhet 2017	Diferenca Buxhet 2017-Pritshmi 2016	Buxhet 2017/I prishmi 2016 ne %
TVSH	125,783	137,916	131,305	-6,611	141,200	9,895	7.5%
Tatim fitimi	24,968	24,314	29,142	4,828	29,200	58	0.2%
Akciza	39,027	44,653	41,896	-2,757	46,700	4,804	11.5%
Tatimi mbi të ardhurat personale	29,661	32,073	31,323	-750	36,200	4,877	15.6%
Taksa nacionale	33,647	37,219	35,553	-1,666	39,700	4,147	11.7%
Taksa doganore	5,796	6,036	6,137	101	6,400	263	4.3%
Total të Ardhurat	**258,882**	**282,211**	**275,356**	**-6,855**	**299,400**	**24,044**	**8.7%**
Kontributet nga DPT	66,844	74,454	74,949	495	78,000	3,051	4.1%
Total	**325,726**	**356,665**	**350,305**	**-6,360**	**377,400**	**27,095**	**7.7%**

Burimi: Ministra e Financave

Të ardhurat doganore janë parashikuar duke u bazuar në analizën e trendit historik të 60 grup-produkteve kryesore, për një periudhë tre-vjeçare. Ky parashikim është korrektuar me efektet e faktorëve të tjerë të jashtëm në sejcilën taksë. E njëjta procedurë është ndjekur edhe për të ardhurat nga tatimet, duke marrë për bazë modelin statistikor të projeksionit të të ardhurave të pritshme si dhe faktorët ekzogjenë me ndikim në çdo taksë.
Faktorët e jashtëm të marrë në konsideratë të cilët ndikojnë në rritjen e të ardhurave për vitin 2017 janë:

✓ *Kuadri Makroekonomik*

Rritja nominale e Prodhimit të Brendshëm Bruto është aplikuar duke analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike dhe projeksionet e çmimeve të tregjeve ndërkombëtare tek taksat ad-valorem si TVSH, Renta minerare dhe Taksa doganore.
Janë përfshirë në projeksion, faktorët e mëposhtëm:

- Rritja nominale e PBB-së 6.3%.
- Kursi mesatar i këmbimit Eur –Lek (138) dhe USD-Lek (126).
- Pritshmëria në rritjen e kërkesës agregate si rezultat i rritjes së pagave.

✓ *Efektet e politikave fiskale:*

Të ardhurat nga politika fiskale parashikohet të jenë si më poshtë:

- Aplikim akcize për gazin e lëngshëm për automjete në nivelin 13 Lek/litër, me qëllim përafrimin me standardet e BE-së dhe të vendeve të rajonit që e taksojnë këtë produkt. Duke llogaritur që importi vjetor i gazit të lëngshëm për përdorim nga automjetet, është rreth 25 mijë ton në vit, efekti në të ardhurat buxhetore pritet te jetë 0.5 miliardë Lek nga akciza dhe 0.1 miliardë Lek nga TVSH-ja. Efekti total në të ardhura vleresohet +0.6 miliardë Lek.
- Reduktimi i akcizës për duhanin prodhim vendi nga 4400 Lek/kg në 2500 Lek/ kg. Kjo masë pritet të incentivojë prodhuesit vendas. Kjo masë e përkohshme është në perputhje me politikat e BE–së që ka parshikuar nëe Direktivën për akcizën e produkteve te duhanit. Efekti total i pritshëm si rezultat i këtyre masave është rreth +0.075 miliardë Lek.
- Reduktim i Rentës minerare për mineralin e destinuar për përpunim. Për vitin 2017 të ardhurat si rezultat i ndryshimit të përqindjes së taksës së rentës nga 4% (2/3 e 6%) në 3% për mineralin krom, të destinuar për përpunim brenda vendit, pritet të jenë -0.01 milard Lek.
- Reduktimi i disa taksave doganore për industrinë fason me efekt – 0.060 miliardë Lek.
- Reduktim i taksës doganore nga 2% në 0% për qymyrin koks që përdoret nga industria.
- Korrektimi i akcizës për purot dhe cigarillos në nivelin e duhanit me efekt 0.004 miliardë Lekë.

- Rritja e kushtëzimeve për përfitimin e rimbursimeve të akcizës për përmbajtje BIO në karburante.
- Përmirësime metodike të kontrollit të bazës së taksimit të rentës minerare.
- Korigjime të tjera pa efekte të rëndësishme në të ardhura të detajuara në dokumentacionin e paketës fiskale 2017.

Parashikimi i të ardhurave sipas zërave për vitin 2017

Të ardhurat nga TVSH-ja parashikohen të jenë në masën 140.8 miliardë Lek, 8 miliardë Lek më shumë se pritshmëria për vitin 2016 ose 6 %.

Burimi kryesor i të ardhurave shtesë nga TVSH-ja për vitin 2017, pritet të jetë si më poshtë:

- Të ardhura në TVSH në import si rezultat i rritjes së çmimeve ndërkombëtare të karburanteve rreth 1.5 miliardë Lek.
- Rritje e të ardhurave nga TVSH-ja në import si rezultat i rritjes së importit të mallrave si dhe nga TVSH-ja e brendshme si rezultat i forcimit të luftës kundër informalitetit dhe forcimit të bashkëveprimit ndërmjet administratave Tatimore dhe Doganore për të kontrolluar zinxhirin e transaksioneve dhe mbledhjen e këtij tatimi në hallkën që krijohet.

Të ardhurat nga akciza vlerësohen me një rritje prej 3.6 miliardë Lek ose 8.5 % më shumë se pritshmëritë për vitin 2016, me një realizim në masën 46.7 miliardë Lek. Faktorët kryesorë që ndikojnë në rritjen e parashikuar të të ardhurave nga akciza, krahas rritjes së importeve të mallrave të akcizës, do të jetë disiplinimi i mëtejshëm i procedurave të përfitimit të përjashtimeve dhe rimbursimeve nga kjo taksë.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet sasia e planifikuar e importit/prodhimit të mallrave kryesorë të akcizës.

Tabela 10: Mallrat e akcizës

Cigare	3200	Ton
Karburant Import dhe Prodhim vendas	540,000	Ton
Birrë Import dhe Prodhim vendas	78,500	Mijë Litra
Kafe	8,600	Ton
Pije Alkolike Import dhe Prodhim vendas	2,600	Mijë Litra
Verë Import dhe Prodhim vendas	6,050	Mijë Litra
Pije Energjike Import dhe Prodhim vendas	8,325	Mijë Litra

Burimi: Ministria e Financave

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin vlerësohen me rritje 7.7% më shumë se viti 2016, duke u realizuar në masën 29.2 miliardë Lek si rezultat i rritjes së deklarimit dhe qarkullimit të realizuar të operatorëve ekonomikë.

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale vlerësohen me rritje 10.7% më shumë se viti 2016, me një realizim në masën 36.2 miliardë Lek. Në parashikimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale janë marrë në konsideratë disa faktorë si rritja e pagave të administratës publike dhe të ardhurat nga rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme.

Të ardhurat nga taksa nacionale vlerësohen 10% më shumë se pritshmëria për vitin 2016, me një realizim në masën 39.7 miliardë Lek. Rritja e taksave nacionale vjen si rezultat i rritjes së parashikuar të importit dhe konsumit të karburantit; rritjes së të ardhurave nga renta minerare për shkak të rritjes së çmimeve ndërkombëtare në Bursë; masave administruese në drejtim të kontrollit të deklarimit të bazës së taksimit të rentës minerare për naftën bruto, etj.

Të ardhurat nga taksa doganore vlerësohen me rritje prej 147 milionë Lek më shumë se viti 2016, me realizim 6.4 miliardë Lek. Ndikim në këtë zë kanë të ardhurat shtesë nga rritja e importeve.

Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore vlerësohen me një rritje 2.4 miliardë Lek ose 3.2% më shumë krahasuar me pritshmërinë për vitin 2016, me një realizim në masën rreth 76.9 miliardë Lek. Gjenerimi i të ardhurave shtesë për kontributet do të ndikohet nga rritja e pagave të administratës dhe rritja e performancës kontrolluese.

Shpenzimet e përgjithshme publike për vitin 2017 janë parashikuar në shumën 467.2 miliardë Lek ose 29.3 % e PBB.

Shpenzimet e personelit në fund të periudhës 2017-2019 janë parashikuar të zbresin në nivelin 4.4 % të PBB nga 4.7% të PBB të parashikuara në ligjin e buxhetit për vitin 2017. Gjatë kësaj periudhe, dhe veçanërisht për vitin 2017, politikat e shpenzimeve të personelit do të reflektojnë koston aktuale të administratës publike,

politikën e rritjes së pagave dhe ndryshimet e nevojshme strukturore të parashikuara për t'u ndërmarrë gjatë periudhës. Për vitin 2017, numri i punonjësve të administratës publike do të rritet në 81 617, duke reflektuar masat e ndërmarra nga qeveria për të mbështetur ndryshimet e nevojshme strukturore në funksion të zbatimit të reformës në drejtësi.

Shpenzimet për interesat – Për periudhën 2017-2019 këto shpenzime mesatarisht janë parashikuar të arrijnë në nivelin 2.8% të PBB, bazuar në politikën e qeverisë për të reduktuar në mënyrë të vazhdueshme deficitin fiskal dhe borxhin publik përgjatë periudhës afatmesme.

Shpenzimet operative dhe për mirëmbajtje – shpenzimet operative dhe për mirëmbajtje për periudhën 2017-2019 janë projektuar të reduktohen lehtësisht në nivelin e 2.7% e PBB në vitin 2019 nga 2.8% e PBB të parashikuara në vitin 2017. Gjithsesi, në terma nominale, niveli i këtyre shpenzimeve do të rritet nga 44.4 miliardë Lek në 2017 në 49.2 miliardë në vitin 2019, duke reflektuar mbështetjen në rritje të qeverisë për mirëmbajtjen e rrugëve, sektorin e ujit, shëndetësinë, arsimin dhe bujqësinë.

Shpenzimet për subvencionet – Për periudhën 2017-2019 niveli i subvencionit do të mbetet konstant në nivelin prej 0.1% e PBB. Ndërsa në terma nominal ky nivel do të rritet në shumën 2.3 miliardë Lek nga 1.75 miliardë të planifikuar në Aktin Normativ të vitit 2016. Rritja i dedikohet mbështetjes së reformës së nisur në sektorin e ujit. Pjesa tjetër e fondit shkon kryesisht për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve të veprimtarisë hekurudhore, subvencionimin e librit për një kategori të caktuar të nxënësve, veprimtarinë e shërbimeve qeveritare dhe nxitjen e punësimit.

Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar: Gjatë periudhës 2017-2019 shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar do të mbeten konstante në nivelin 20.5 miliardë Lek. Parashikimi për pagesat e tjera sociale paraqitet më poshtë:

- Pagesa e papunësisë është parashikuar të rritet nga 800 milionë Lek në vitin 2017 në 1 miliardë Lek në vitin 2019.
- Kompensimi në vlerë i ish të burgosurve politikë është parashikuar në nivelin 2 miliardë Lek, me një rritje të lehtë në vitin 2019, duke arritur në vlerën 2.2 miliardë Lek.

Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave dhe Fondi i Kontigjencës- në fund të periudhës 2017-2019 është parashikuar të rritet duke arritur nivelin 3.8 miliardë Lek, nga 1.5 miliardë të parashikuar në buxhetin e vitit 2017. Kjo rritje i dedikohet kryesisht rritjes të fondit të kontigjencës në periudhë afatmesme, për themelimin dhe funksionimin e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë.

Shpenzimet Kapitale – Gjatë periudhës 2017-2019, niveli i shpenzimeve kapitale do të rritet në terma nominale nga 74.4 miliardë Lek në vitin 2017 në 80.1 miliardë Lek në vitin 2019. Gjithsesi, në terma reale ky nivel do të reduktohet nga 4.7% e PBB në vitin 2017 në 4.4% e PBB në vitin 2019. Investimet në periudhën afatmesme janë planifikuar duke i dhënë prioritet projekteve në vazhdim nga vitet e mëparshme, si dhe atyre të përcaktuar si prioritete të programit të qeverisë në periudhën 2013-2017.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2017 janë parashikuar në masën 40.82 miliardë Lek ose 3.1% e PBB-së. Në këtë zë është përllogaritur rritja e transfertës së pakushtëzuar për njësitë vendore, së bashku me Fondin e Zhvillimit të Rajoneve dhe financimin e funksioneve të reja që transferohen në qeverisjen vendore. Shpenzimet e buxhetit vendor janë 3.8% më të larta se ato të vitit 2016. Në këtë rritje të shpenzimeve krahas rritjes së financimeve nga buxheti, ndikon edhe rritja e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në masën 898 milionë Lek, krahasuar me Aktin Normativ 2016. Në buxhetin e vitit 2017, është aplikuar një formulë e re për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore, e cila siguron më shumë barazi, drejtësi dhe parashikueshmëri për qeverisjen vendore. Disa nga elementet e formulës janë:

- Të dhënat për popullsinë janë harmonizuar midis të dhënave të Regjistrit të Gjendjes Civile dhe Censusit;
- Sipërfaqja e komunave është zëvendësuar me dendësinë e popullsisë së bashkive të reja;
- Ekualizimi është llogaritur mbi taksat e ndara duke synuar që të jetë sa më objektiv në financimin e njësive më të ardhura të ulta dhe inkurajimin e atyre, të cilat performojnë mirë në mbledhjen e të ardhurave.

Shpenzimet për fondet speciale – Në këtë zë përfshihen, shpenzimet totale për Fondet e Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, të cilat kapin një vlerë prej 162.1 miliardë Lek në buxhetin e vitit 2017 duke arritur në 180.1 miliardë Lek në vitin 2019. Në terma real niveli i tyre do të ulet lehtësisht nga 10.2% e PBB në 2017, në 9.8% e PBB në vitin 2019. Në detaje:

- Shpenzimet për sigurimet shoqërore do të rriten nga 120.2 miliardë të parashikuara në vitin 2017 në 134.6 miliardë në vitin 2019.

- Shpenzimet për sigurimet shëndetësore do të rriten nga 38.1 miliardë Lek në vitin 2017 në nivelin 40.5 miliardë Lek në vitin 2019.
- Së fundi, shpenzimet për kompensimin e ish-pronarëve do të rriten nga 3.8 miliardë Lek në vitin 2017 në 5 miliardë Lek në vitin 2019, duke reflektuar përcaktimet e ligjit për këtë qëllim.

3.3. Bilanci strukturor

Metodologjitë dhe teknikat standarte më të zakonshme janë përdorur për të vlerësuar bilancin fiskal të rregulluar ciklikisht (apo bilancin strukturor) për rastin e Shqipërisë. Megjithatë, për shkak të kufizimeve tek të dhënat, si në nivelin e tyre relativ të disagregimit dhe në periudhën e shkurtër që ato disponohen, analiza e mëposhtme ka disa kufizime. Për këtë arsye të dhënat duhet të shihen me kujdes.

Vlerësimi i PBB-së potenciale dhe hendekut të prodhimit

Teknika e filtrimit Hodrick-Prescott (HP) është përdorur për të vlerësuar serinë e PBB-së potenciale. Aplikimi i drejtpërdrejtë i filtrimit HP në nivelin aktual të PBB-së ose në nivelin logaritmik të saj në mënyrë që të ekstraktojë prej saj një seri për PBB-në potenciale, na dha disa rezultate për hendekun e prodhimit (OG) jo shumë të llogjikshme ekonomikisht. Veçanërisht vlen të përmendet marrja e një hendeku pozitiv prodhimi në vitet 2009, 2010 dhe 2011. Pavarësisht procesit të ristrukturimit në të cilin ekonomia ndodhej, që nga goditja e krizës globale (2009), e cila me shumë gjasa ka çuar në uljen e produktit potencial, pasja e hendeqeve pozitive në prodhim gjatë atyre viteve duket jo fort e besueshme.

Prandaj, filtrimi HP është aplikuar në rritjen ekonomike aktuale vjetore, duke marrë parasysh vlerat më të përshtatshme të parametrit lambda në rastin e të dhënave vjetore. Rritja e PBB-së potenciale u nxorr më pas si një mesatare e serive të filtrimit HP bazuar në këto tre parametratë ndryshëm të lambda-s. Bazuar në rritjen potenciale të përfituar, u nxorr më pas niveli i PBB-së potenciale dhe në përputhje me të u llogarit dhe niveli i outputit. Parashikimet e FMN-së ËEO (tetor 2016) për 2019 dhe 2020 janë përdorur për tu marrë me problemin e të dhënës së fundit që shfaq teknika e filtrimit HP

Hendeku i prodhimit: $Hend.\Pr odhimit_t = \dfrac{PBB_{t,aktuale} - PBB_{t,potencial}}{PBB_{t,potencial}}$ është paraqitur në anën e majtë të figurës së mëposhtme.

Grafiku 22: Hendeku prodhimit (majtas) dhe rritja aktuale dhe potenciale (djathtas)



Rezultatet na tregojnë se prodhimi aktual ka qenë nën potencialin e tij gjatë 2000 - 2004 dhe ka mbetur pothuajse në potencialin e tij gjatë 2005 - 2006. Ekonomia ka filluar të operojë mbi potencialin e saj në vitin 2007, ndërsa është tejnxehur në mënyrë të konsiderueshme në vitin 2008. Që nga goditja e krizës globale në 2009, ekonomia ka operuar nën potencialin e saj.

Vlerësimi i elasticiteteve dhe ndjeshmërisë së buxhetit ndaj hendekut të prodhimit

Pasi u hoqën faktorët që kanë pasur ndikime vetëm në një periudhë të caktuar, u vlerësuan elasticitetet e të ardhurave dhe shpenzimeve edhe me metodën e disagregimit (sipas qasjes së OECD-së 2005) dhe me metodën aggregate (sipas qasjes së FMN-së 2010). Gjithsesi, elasticitetet finale totale të marra nga secila metodë ishin pothuajse të ngjashme. Për të qënë më konkretë, elasticiteti i përgjithshëm i të ardhurave, i nxjerrë nga elasticitetet specifike të zërave kryesorë të të ardhurave me metodën e disagregimit ishte 1.13, ndërsa

elasticiteti i vlerësuar nga metoda aggregate ishte 1.45 . Të ardhurat totale u rregulluan për efektet e ciklit, duke aplikuar mbi to elasticitetin mesatar të përfituar nga të dyja qasjet, i cili është:

$$\varepsilon_{R,Y} = mesatare(1.13, 1.45) = 1.29$$

Përsa u përket elasticiteteve të shpenzimeve, ato nuk ishin të ndryshme nga niveli zero. Analiza e regresionit na prodhoi elasticitete të shpenzimeve me shenjë negative, sipas të dyja metodave, por asnjëra prej tyre nuk ishte statistikisht e rëndësishme, duke na treguar se koeficienti i elasticitetit është i barabartë me zero $\varepsilon_{G,Y} = 0$ dhe si rezulta shpenzimet totale nuk u rregulluan për efekte ciklike. Aplikimi direkt i formulës së ndjeshmërisë për bilancin e buxhetit ndaj hendekut të prodhimit (ose i ashtuquajtur elasticitet i pjesshëm) na dha vlerën e mëposhtme:

$$\sigma_B \equiv r(\varepsilon_{R,Y} - 1) - g(\varepsilon_{G,Y} - 1) = 0.252(1.29 - 1) - 0.258(0 - 1) = 0.331$$

ku: r = 0.252 është norma mesatare e të ardhurave totale ndaj PBB-së (duke përjashtuar faktorët një ndikimësh) për 5 vitet e fundit (2011 - 2015), g = 0.258 është norma mesatare e shpenzimeve primare ndaj PBB-së (duke përjashtuar faktorët një ndikimësh) për 5 vitet e fundit (2011 – 2015). Parametri i vlerësuar i ndjeshmërisë buxhetit na thotë se për çdo pikë përpqindje negative (positive) të hendekut të prodhimit, bilanci i përgjithshëm fiskal primar do të përkeqësohet (përmirësohet) me 0.33 pikë përqindje të PBB-së potenciale.

Llogaritja e bilancit fiskal të rregulluar ciklikisht dhe vlerësimi i ndikimit të pritshëm të politikës fiskale në ekonomi

Bazuar tek hendeku i prodhimit (OG) dhe parametri i ndjeshmërisë së buxhetit (σ_B), komponenti ciklik i bilancit fiskal primar (CPB) në terma të PBB-së potenciale është llogaritur si: $CBT_t = \sigma_B * OG_t$. ku stabilizatorët automatikë janë përkufizuar si ndryshimi i CPB të dy viteve rresht (AS), pra: ASt = CPBt – CPBt-1
Bilanci primar i rregulluar ciklikisht (CAPB) llogaritet si diferencë mes bilancit primar fiskal aktual (PB) dhe komponentit të tij ciklik (CPB): CAPBt = PBt - CPBt. Bilanci i përgjithshëm i rregulluar ciklikisht (CAB) del pasi bilancit primar të rregulluar ciklikisht i hiqen shpenzimet për interesat (INT): CABt = CAPBt - INTt

Impulsi fiskal (FI) në terma të PBB-së potenciale është ndryshimi i bilancit primar të rregulluar ciklikisht çdo vit, relativisht me vitin e kaluar: FIt = CAPBt-1 – CAPBt .
Bazuar në drejtimin e impulsit fiskal (ngushtues apo zgjerues) dhe hendekut të prodhimit (negative ose pozitive), ne po japim një paraqitje të thjeshtë përsa i përket natyrës së politikës fiskale, nqs ajo ka qënë pro-ciklike, kundër-ciklike apo neutrale. Rezultatet e marra janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Tabela 11: ...

Viti	Hendeku Prodhimit (OG)	Bilanci i Përgjithshëm Fiskal Aktual (B)	Bilanci Primar Aktual Fiskal (PB)	Bilanci Primar Ciklik (CPB)	Bilanci Primar i Rregulluar Ciklikisht (CAPB)	Shpenzimet e Interesave (INT)	Bilanci Pergjithshem i Rregulluar Ciklikisht (CAB)	Stabilizatorët Automatikë (AS)	Impulsi Fiskal (FI)	Gjëndja Fiskale ndaj Hendekut të prodhimit
2000	-1.6	-8.0	-2.1	-0.5	-1.6	5.9	-7.5	-	-	
2001	0.3	-7.2	-3.0	0.1	-3.1	4.2	-7.3	0.6	1.5	Pro-ciklike
2002	-2.6	-6.2	-2.2	-0.8	-1.3	4.1	-5.4	-0.9	-1.8	Pro-ciklike
2003	-0.6	-5.0	-0.6	-0.2	-0.4	4.4	-4.8	0.6	-0.9	Pro-ciklike
2004	-0.2	-5.2	-1.3	-0.1	-1.2	3.9	-5.1	0.1	0.8	Kundër-cikl
2005	0.2	-3.5	-0.3	0.1	-0.3	3.2	-3.6	0.1	-0.9	Kundër-cikl
2006	0.2	-3.4	-0.5	0.1	-0.6	2.9	-3.4	0.0	0.2	Neutrale
2007	1.0	-3.5	-0.9	0.3	-1.2	2.7	-3.9	0.3	0.6	Pro-ciklike
2008	2.2	-5.6	-2.7	0.7	-3.4	2.9	-6.3	0.4	2.2	Pro-ciklike
2009	-0.6	-7.1	-3.9	-0.2	-3.7	3.2	-6.9	-0.9	0.3	Kundër-cikl
2010	0.1	-3.1	0.3	0.0	0.3	3.4	-3.1	0.2	-3.9	Kundër-cikl
2011	-0.7	-3.5	-0.4	-0.2	-0.1	3.2	-3.3	-0.3	0.4	Kundër-cikl
2012	-1.6	-3.4	-0.3	-0.5	0.2	3.1	-2.9	-0.3	-0.3	Pro-ciklike
2013	-1.8	-5.0	-1.7	-0.6	-1.2	3.2	-4.4	-0.1	1.4	Kundër-cikl
2014	-0.8	-5.2	-2.3	-0.3	-2.0	2.9	-4.9	0.3	0.9	Kundër-cikl
2015	-0.5	-4.1	-1.4	-0.2	-1.2	2.7	-3.9	0.1	-0.8	Pro-ciklike
2016	-0.3	-2.0	0.5	-0.1	0.6	2.5	-1.9	0.1	-1.8	Pro-ciklike
2017	-0.1	-2.0	0.7	0.0	0.7	2.6	-1.9	0.1	-0.1	Neutrale
2018	0.0	-1.8	1.0	0.0	1.0	2.8	-1.8	0.0	-0.3	Kundër-cikl
2019	0.1	-1.0	1.8	0.0	1.7	2.7	-1.0	0.0	-0.8	Kundër-cikl

Grafiku 23: ...



Kjo analizë e thjeshtë empirike na tregon se gjatë vieteve 2000 – 2008, politika fiskale në Shqipëri ka qënë më së shumti pro-ciklike përkundrejt zhvillimeve dinamike të ekonomisë, duke i përforcuar lëvizjet ciklike të ekonomisë. Pro-ciklikaliteti i politikës fiskale ka qënë më së shumti i dukshëm gjatë viteve 2002 dhe 2008. Me lëvizjen e performancës së ekonomisë nga një hendek prodhimi pozitiv në 2001, drejt një hendeku të konsiderueshëm negativ në 2002, bilanci primar i rregulluar ciklikisht u ngushtua shumë në 2002 krahasuar me vitin e mëparshëm. E kunderta ndodhi në 2008, ku impulsi fiskal arriti majën prej 2.2 pikë përqindje të PBB-së ndërsa ekonomia ishte qartësisht duke u zhvilluar, duke arritur një hendek prodhimi të së njëjtës vlerë.

Që nga goditja e krizës globale në 2009, komponenti diskret i politikës fiskale duket se ka qënë më se shumti i natyrës kundër-ciklike, për këtë ka luajtur rol stabilizues në ekonomi dhe ka aneksuar lëvizjet ciklike. E njejta rrugë kundërciklike e politikës fiskale është parashikuar të shihet gjerësisht dhe për periudhën afatmesme. Nëse shohim vitet 2015-2016, konsolidimi fiskal në bilancin e strukturuar (përfshirë detyrimet e prapambetura) duket disi i natyrës pro-ciklike, mqs hendeku i prodhimit, edhe pse duke u ngushtuar ende parashikohet të mbetet negativ. Gjithësesi, konsolidimi fiskal i planifikuar të ndërmerret në vitet në vijim, është i mirë-programuar me parashikimet përshpejtuese që ekonomia do të ketë.

3.4. Niveli i borxhit dhe zhvillimet

Viti 2016 ka pasur ndryshime të rëndësishme përsa i përket kuadrit rregullativ (Ligji "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor", i ndryshuar)[9] , të cilat kanë impakt të drejtpërdrejt mbi nivelin e borxhit. Këto ndryshime kanë në fokus rritjen e qëndrueshmërisë së borxhit duke synuar uljen e nivelit të tij në periudhën afatmesme dhe atë afatgjatë. Ndër ndryshimet që mund të kenë ndikim në nivelin e borxhit, më të rëndësishmet janë:

- Ndryshimet që disiplinojnë shpenzimet publike dhe bëjnë të detyrueshëm planifikimin e nivelit të borxhit me rënie nga njëri vit buxhetor në tjetrin;
- Ndryshimet për mbajtjen e kontigjencave për të menaxhuar risqet potenciale që rrjedhin nga luhatjet e normave të interest dhe kursit të këmbimit;
- Ndryshimet në kuadër të rritjes së transparencës dhe përfshirjes së të gjitha detyrimeve të drejtpërdrejta dhe atyre kontigjente në bilancin fiskal vjetor të konsoliduar.

Ndryshimet e sipërpërmendura do të mbështesin angazhimin e qeverisë për të ulur nivelin e borxhit, duke filluar nga viti 2016 dhe në vitet në vijim.

Zhvillimet e stokut të borxhit të Qeverisjes Qendore

Borxhi i Qeverisjes Qendrore në fund të dhjetorit 2016 është 1,064.8 miliard Lek ose 70.9% e PBB-së, duke shënuar një rënie prej 1.75 pp krahasuar me vitin 2015. Për herë të parë pas shumë vitesh borxhi ka hyrë në një trajektore rënëse duke dëshmuar angazhimin e fortë të qeverisë për të ulur borxhin.

Gjatë vitit 2016, Ministria e Financave ka mbuluar nevojat e qeverisë për likuiditet, duke emetuar letra me vlerë në tregun vendas në vlerën 341.9 miliard Lek ose në terma neto + 10.7 miliard Lek. Financimi neto në tregun e brendshëm është realizuar në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, duke u

[9] Referuar ligjit Nr. 57/2016, datë 02.06.2016

realizuar nëpërmjet instrumenteve afatgjata dhe maturimit të instrumenteve afatshkurtra. Kjo strategji ka kontribuar kryesisht në përmirësimin e strukturës së borxhit të brendshëm, duke reduktuar më tej ekspozimin e risqeve. Nga ana tjetër, strategjia e financimit ka ruajtuar ekuilibrin midis kostos dhe riskut, duke përfituar nga niveli i ulët i normave të interesit që ka vazhduar edhe përgjatë vitit 2016.
Ndërkohë, financimi i huaj është realizuar kryesisht nëpërmjet disbursimit të kredive me norma interesi koncesionale, të cilat kanë mundësuar financimin e projekteve zhvillimore

Tabela 12: Borxhi i Qeverisjes Qendore (në milion Lek)

	2012	2013	2014	2015	2016
Stoku i Borxhit Gjithsej (I+II)	**827,981**	**884,692**	**977,102**	**1,042,272**	**1,064,844**
I. Borxhi i Brendshëm	**470,358**	**520,786**	**564,673**	**551,374**	**561,120**
- Shtetëror	454,695	500,868	538,641	520,936	530,838
- Garantuar	15,663	19,918	26,033	30,439	30,282
II. Borxhi i Jashtëm	**357,622**	**363,906**	**412,429**	**490,898**	**503,724**
- Shtetëror	319,833	332,500	383,922	465,306	480,679
- Garantuar	37,790	31,406	28,507	25,591	23,045
PBB	**1,332,811**	**1,350,053**	**1,394,419**	**1,434,740**	**1,501,891**
Stoku i Borxhit Gjithsej/PBB	62.12%	65.53%	70.07%	72.65%	70.90%
Stoku i Borxhit të Brendshëm/PBB	35.29%	38.58%	40.50%	38.43%	37.36%
Stoku i Borxhit të Jashtëm /PBB	26.83%	26.95%	29.58%	34.22%	33.54%

Burimi: Ministria e Financave

Kompozimi i Stokut të Borxhit të Qeverisjes Qendore
Gjatë vitit 2016 stoku i borxhit të qeverisjes qendrore ka pësuar ndryshime kryesisht në lidhje me strukturën e maturitetit, llojin e normës së interesit dhe rezidencën e investitorëve, ndërkohë ndryshimet e tjera kanë qënë relativisht të vogla.
Brenda një viti, borxhi afatgjatë është rritur me 1.9 p.p. Në këtë drejtim ka kontribuar ndjeshëm rritja e peshës së titujve afatgjatë në tregun e brendshëm, kryesisht për shkak të emetimit të shpeshtë të obligacioneve 7 dhe 10 vjeçare dhe mungesës së maturimeve për këtë kategori instrumentesh deri në vitin 2019.
Në lidhje me llojin e normës së interesit, gjatë vitit 2016 vërehet një rritje e stokut të borxhit me norma interesi koncesionale. Ky ndryshim i atribuohet kryesisht kredive të borxhit të jashtëm, të siguruara me terma koncesionale si edhe mbështetjes buxhetore të akorduar nga institucionet financiare ndërkombëtare (FMN, Banka Botërore, etj).

Tabela 13: Kompozimi i borxhit të Qeverisjes Qendrore

	2014		2015		2016	
	mln	%/total	mln	%/total	mln	%/total
I. Maturiteti	**977,103**	**100.0%**	**1,042,160**	**100.0%**	**1,064,844**	**100.0%**
i. Afatshkurtër	**286,632**	**29.3%**	**254,263**	**24.4%**	**239,695**	**22.5%**
- Tituj Shtetërorë	*260,599*	*26.7%*	*223,824*	*21.5%*	*209,409*	*19.7%*
- Kredi	*26,033*	*2.7%*	*30,439*	*2.9%*	*30,286*	*2.8%*
ii. Afatgjatë	**690,471**	**70.7%**	**787,897**	**75.6%**	**825,149**	**77.5%**
- Tituj Shtetërorë	*320,084*	*32.8%*	*358,887*	*34.4%*	*382,279*	*35.9%*
- Kredi	*370,387*	*37.9%*	*429,010*	*41.2%*	*442,870*	*41.6%*
II. Monedha	**977,103**	**100.0%**	**1,042,160**	**100.0%**	**1,064,844**	**100.0%**
- Vendase	*538,275*	*55.1%*	*526,874*	*50.6%*	*540,614*	*50.8%*
- Valutë	*438,828*	*44.9%*	*515,286*	*49.44%*	*524,230*	*49.23%*
III. Residenca	**977,103**	**100.0%**	**1,042,160**	**100.0%**	**1,064,844**	**100.0%**
- Kreditorë Vendas	*576,344*	*59.0%*	*526,875*	*50.6%*	*582,216*	*54.7%*
- Kreditorë të Huaj	*400,758*	*41.0%*	*515,285*	*49.4%*	*482,628*	*45.3%*
IV. Tipi i Interesit	**951,069**	**100.0%**	**1,011,833**	**100.0%**	**1,035,288**	**100.0%**
- Fiks	*673,663*	*70.8%*	*691,971*	*68.4%*	*704,001*	*68.0%*
- I ndryshueshëm	*277,406*	*29.2%*	*319,862*	*31.6%*	*331,287*	*32.0%*
V. Koncesionaliteti	**951,069**	**100.0%**	**1,011,833**	**100.0%**	**1,035,288**	**100.0%**
- Koncesionale	*212,902*	*22.4%*	*235,862*	*23.3%*	*251,893*	*24.3%*
- Tregëtare	*738,167*	*77.6%*	*775,971*	*76.7%*	*783,395*	*75.7%*

**Nuk përfshihen garancitë e brendshme*

Burimi: Ministria e Financave

Kostot dhe risqet

Gjatë vitit 2016, portofoli i borxhit të Qeverisë Qendrore, në përputhje me objektivat strategjike, u karakterizua nga një marrëdhënie e qëndrueshme midis kostos dhe riskut. Kostot e borxhit përgjithësisht u reduktuan falë rënies së normave të interesit në tregun vendas (kryesisht gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit) dhe në tregjet ndërkombëtare.

Struktura e borxhit shfaqi një përmirësim të dukshëm, kryesisht në aspektin e reduktimit të ekspozimit të riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit. Ndërkohë, risku i kursit të këmbimit, pothuajse ka qëndruar në të njëjtat nivele me vitin e kaluar.

Kostot

Për vitin 2016 shpenzimet e interesit të borxhit për Qeverinë Qëndrore llogariten në 2,41% të PBB, ose rreth 2.4 miliard Lek më pak se interesat e vitit të kaluar.

Grafiku 24: Shpenzimet për interesa të borxhit të qeverisjes qendore



Burimi: Ministria e Financave

Rënia në shpenzimet për interesa të borxhit i atribuohet kryesisht rritjes së PBB-së dhe rënies së normave të interesit të borxhit të brendshëm dhe atij të jashtëm.

Yield-i mesatar i ponderuar i titujve shtetërorë në tregun vendas ka pësuar rënie, ndërkohë që pesha e titujve afatgjatë në portofol është rritur. Ky fakt është tregues i një përmirësimi të dukshëm në marrëdhënien midis

kostos dhe riskut në portofolin e borxhit të brendshëm.

Grafiku 25: Borxhi brendshëm afatshkurtër/afatgjatë & Yield-i Mesatar i Ponderuar (YMP)



Burimi: Ministria e Financave

Në periudhën afatmesme pritet një rritje graduale e kostos së borxhit në terma nominale, për shkak të rritjes së stokut të borxhit dhe për shkak të pritshmërive për rritje të normave të interesit në tregun e brendshëm dhe tregjet e huaja.

Risqet

Gjatë vitit 2016, reduktimi i riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit në tregun e brendshëm kanë qenë ndër objektivat strategjike parësore në menaxhimin e portofolit të borxhit. Në këtë drejtim, borxhi i jashtëm paraqet më pak risk, pasi përbëhet nga instrumenta afatgjatë, ku një pjesë e konsiderueshme është me terma koncesionale dhe pothuajse gjysma është me norma interesi të ndryshueshme.

Në dhjetor 2016, struktura e borxhit të brendshëm paraqitet më pak e ekspozuar ndaj riskut të rifinancimit dhe kjo i atribuohet kryesisht rënies së peshës së titujve me afat të shkurtër maturimi.

Gjithashtu, ka një përmirësim në shpërndarjen e detyrimeve që lindin nga ripagimi i borxhit ekzistues. Pesha e instrumentave (në përqindje ndaj totalit), që rifinancohen në harkun kohor të një viti është 53,4% ose 2.5 pikë përqindje më e ulët se në fund të vitit 2015.

Grafiku 26: Profili i amortizimit të borxhit të brendshëm



Burimi: Ministria e Financave

Jetëgjatësia mesatare e borxhit të brendshëm është rritur me 48 ditë dhe kontribut në këtë drejtim ka emetimi i obligacioneve 7 dhe 10-vjeçare.

Gjatë vitit 2016, ekspozimi ndaj riskut të normave të interesit është reduktuar, kryesisht falë reduktimit të borxhit afatshkurtër, i cili në perspektivën e riskut konsiderohet si borxh me interesa të ndryshueshme. Nga ana tjetër,

edhe stoku i obligacioneve me norma interesi të ndryshueshme është ulur me rreth 1.1 pikë përqindje, duke qëndruar brenda kufirit strategjik prej 15% të totalit të borxhit të brendshëm.

Tabela 14: Treguesit e riskut të normave të interesit

Treguesi	2014	2015	2016
Obligacioni me norma të ndryshueshme/Total	14.6%	13.8%	12.7%
Obligacione me norma fikse/Total	37.0%	43.2%	47.7%
Borxhi i rivlerësuar/Total	72.7%	67.7%	62.6%

Burimi: Ministria e Financave

Pavarësisht përmirësimeve, përpjekjet për të reduktuar risqet e sipërpërmendura do të vazhdojnë edhe në periudhën afatmesme dhe atë afatgjatë, pasi borxhi i brendshëm ende paraqet një risk relativisht të lartë.

Zhvillimet e tregut

Gjatë 2016 menaxhimi i borxhit publik ka ndërmarrë disa aktivitete të rëndësishme në mënyrë që të përmirësojë tregun primar dhe të hedhë hapat për zhvillimin e tregut sekondar. Aktivitetet e ndërmarra janë fokusuar në reduktimin e fragmentimit të kërkesës dhe në krijimin e benchmark për titujt afatgjatë.

Analizat aktuale kanë treguar që kërkesa për letrat me vlerë është e fragmentuar për shkak të emetimit të shumë instrumenteve me karakteristika të ngjashme.

Për të përmirësuar këtë aspekt, nuk është vijuar me emetimin e obligacionit 3 vjeçar si dhe nuk janë emetuar disa prej titujve afatgjatë me interes të ndryshueshëm si obligacione 7-vjeçare dhe 10-vjeçare.

Kjo nismë është bërë për të evituar konkurrencën ndërmjet titujve afatgjatë dhe për të krijuar një kurbë yield-i të qëndrueshme. Gjithashtu, kjo praktikë lehtëson zbulimin e çmimit të tregut (price discovery) për investitorët dhe rrit qëndrueshmërinë e normave të interesit.

Nga ana tjetër, analiza ka treguar që kërkesa e brendshme nuk është e mirëdiversifikuar dhe nuk ka potencial të mjaftueshëm për krijimin e madhësive benchmark në një ankand të vetëm. Në këtë drejtim është arritur të limitohet numri i emetimeve të reja dhe është rritur numri i rihapjeve të ankandeve ekzistuese. Në periudhën afatmesme dhe afatgjatë kjo mund të kontribuojë në krijimin e madhësive të benchmark-ut, duke lehtësuar ekspozimin e çmimeve dhe të japë stimuj për zhvillimin e aktivitetit të tregut sekondar.

Gjatë vitit 2016 kërkesa për tituj shtetërorë ka qënë relativisht e lartë krahasuar me ofertën e qeverisë, duke gjeneruar një raport mbulimi pozitiv

Tabela 15: Treguesit e ecurisë së kërkesës për titujt shtetërorë

Periudha	Treguesi	B.Thesari	Obligacione	Gjithsej
2015	**Nr i ankandeve**	53	43	96
	Kërkesa *(në mld Lek)*	380.2	118.4	498.6
	Oferta *(në mld Lek)*	340.7	105.4	446.1
	Raporti i mbulimit	1.12	1.12	1.12
2016	**Nr i ankandeve**	42	32	74
	Kërkesa *(në mld Lek)*	301.5	138.8	440.3
	Oferta *(në mld Lek)*	262.2	103.5	365.7
	Raporti i mbulimit	1.15	1.34	1.20

Burimi: Ministria e Financave

Aktorët kryesorë të kërkesës për vitin 2016 kanë qenë sektori Bankar, Banka e Shqipërisë dhe Individët, ndërkohë që kontributi i pjesës së mbetur ka qenë i moderuar.

Grafiku 27: Kërkesa e titujve shtetërorë në tregun primar



Burimi: Ministria e Financave

Ecuria e normave të interesit

Normat e interesit janë shoqëruar me një trend të vazhdueshëm rënës gjatë 6-mujorit të parë 2016, ndërkohë duke filluar që prej muajit korrik deri në dhjetor është vërejtur një rritje e tyre për të gjithë llojet e titujve qeveritare. Pavarësisht kësaj rritjeje, normat e interesit të titujve qeveritare qëndrojnë në nivele relativisht më të ulëta se viti 2015.

Rënia e normave të interesit gjatë vitit 2016, i atribuohet kryesisht faktorëve të mëposhtëm:

- Likuiditeti relativisht i lartë i sektorit Bankar, shoqëruar me procedurën "buyback" në fund të vitit 2015;
- Kreditimi i kufizuar nga sektori Bankar si rezultat i nivelit realtivisht të lartë të kredive të këqija;
- Rënia e normës bazë të interesit në nivelin 1.25%;
- Rritja e kërkesës nga individët, për shkak të interesave më të favorshme të titujve shtetërorë krahasuar me depozitat bankare.

Grafiku 28: Zhvillimi i normave të interesit të titujve shtetërorë në emetim



Burimi: Ministria e Financave

Borxhi i jashtëm

Në dhjetor 2016, borxhi i jashtëm vlerësohet në nivelin 3.72 miliard EUR, nga të cilat 3.55 miliard EUR janë borxh shtetëror dhe 0.17 miliard EUR borxh i garantuar. Borxhi i jashtëm përbëhet nga 3 monedha kryesore: EUR, USD dhe YEN. Pjesa dominante e borxhit të jashtëm është në Euro (67.67% e portofolit të borxhit të jashtëm). Krahasuar me një vit më parë, pesha e stokut të borxhit në EUR është ulur me rreth 1.87pp, ndërkohë që pesha e stokut në USD dhe YEN u rrit përkatësisht me 0.52 pp dhe 0.2 pp.

Grafiku 29: Përbërja e borxhit të jashtëm sipas monedhave



Burimi: Ministria e Financave

Niveli i lartë i borxhit në EUR rrit riskun e këmbimit valuator. Megjithatë, gjatë viteve të fundit niveli i lartë i stokut të borxhit në monedhën EUR nuk ka përbërë problem kryesisht për shkak të orientimit ekonomik të vendit drejt Bashkimit Evropian. Gjatë pesë viteve të fundit zhvlerësimi maksimal i monedhës vendase ndaj monedhës EUR ka qenë në nivelin 1.4%, ndërkohë që ndaj monedhës USD është luhatur në rreth 6%. Kostot nga luhatjet e kursit të këmbimit gjatë viteve të fundit kanë qenë të moderuara kryesisht për shkak të lëvizjeve të monedhës EUR dhe USD në drejtime të kundërta duke kompensuar efektet e njëra-tjetrës.

Grafiku 30: Ndryshimi në kursin e këmbimit EUR/Lek dhe USD/Lek (2012- 2016)



Burimi: Ministria e Financave

Disbursimet

Gjatë vitit 2016 janë disbursuar 300.3 milion EUR, nga të cilat 153.17 milion EUR kanë qënë mbështetje buxhetore dhe pjesa tjetër disbursime për financim projektesh. Krahasuar me vitin e kaluar, disbursimet në total janë rreth 225.5 milion EUR më pak. Persa i perket disbursimeve për financim projektesh, sektorët me nivelin më të lartë të disbursimeve janë: Ujësjellës Kanalizime (28.5%), Transporti (27.1%), dhe Energjetika (18.1%).

Tabela 16: Disbursimet e borxhit të huaj

	2015		2016	
	Vlera *(mln EUR)*	% / Total	Vlera *(mln EUR)*	% /Total
Disbursime Gjithsej	**525.8**	**100%**	**300.3**	**100.0%**
(i) Mbështetje buxhetore	101.5	19.3%	153.17	51.0%
(ii) Financim Projektesh	174.3	33.1%	147.11	49.0%
(iii) PBG	250.0	47.5%	0	0.0%

Burimi: Ministria e Financave

Risqet e tregut

Gjatë vitit 2017 dhe në periudhën afatmesme, duke marrë në konsideratë nivelin më të ulët historik të normave të interesit aktuale, rritjen e financimit të brendshëm, si edhe direktivat e bankave mëma ndaj bankave të nivelit të dytë, për të mbajtur nivele të pranueshme ekspozimi ndaj borxhit sovran, pritet që të ketë një rritje të normave të interesit. Niveli i rritjes së normave në tregun e brendshëm pritet të jetë gradual dhe nën nivelin mesatar të 3 viteve të fundit.

Gjithashtu, edhe huazimi në tregjet e huaja pritet që të shtrenjtohet, pasi parashikimet flasin për një rritje të mundshme të Euribor dhe Libor. Pavarësisht pritshmërive për rritjen e normave, efektet priten të jenë të moderuara pasi rreth gjysma e borxhit të huaj është huazuar me norma interesi fikse dhe koncesionale.

Shërbimi i borxhit pritet të jetë në nivele më të ulta ose të krahasueshme me ato të vitit aktual, pasi efektet e rritjes së mundshme të normave gjatë vitit 2017 janë minimale dhe materializohen kryesisht në dy vitet pasardhëse (2018-2019).

Për sa më sipër, në periudhën afatmesme, menaxhimi i borxhit do të synojë ta orientojë borxhin kryesisht drejt instrumenteve me norma interesi fikse.

Përsa i përket riskut të kursit të këmbimit, portofoli i borxhit të jashtëm është i ndjeshëm ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, për shkak të nivelit të ulët të diversifikimit valutor. Zhvlerësimi i valutës kombëtare përkundrejt monedhës EUR dhe monedhave të tjera që zënë peshë të konsiderueshme në portofolin e borxhit të jashtëm mund të ndikojë në buxhet duke rritur kostot e shërbimit dhe nivelin e borxhit. Për të mbajtur nën kontroll këtë risk, menaxhimi i borxhit do të synojë të mbajë stokun e borxhit në valutë në jo më shumë se 55% të totalit të borxhit publik.

Detyrimet kontigjente

Në fund të vitit 2016 vlera e borxhit të garantuar është 53.3 miliard Lek, ose 3.6% e PBB-së. Garancitë në tregun e brendshëm përfaqësojnë 56.8% të totalit të stokut të borxhit të garantuar ose 30.3 miliard Lek, ndërsa garancitë e ofruara nga kreditorët e huaj përfaqësojnë 43.2% të stokut të borxhit të garantuar ose 23.0 miliard Lek. Shumica e garancive janë lëshuar në favor të sektorit të energjisë, i cili është një sektor me nevoja të larta për mbështetje, me qëllim që të përmirësojë performancën dhe të rrisë efikasitetin. Krahasuar me fundin e vitit 2015 niveli i detyrimeve kontingjente ka pësuar një rënie të lehtë, për shkak të ripagesave të garancive ekzistuese dhe të mosbërjes efektive të asnjë garancie të re gjatë vitit 2016.

Grafiku 31: Borxhi i garantuar sipas sektorëve ekonomikë



Burimi: Ministria e Financave

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 kostoja totale për shërbimin e borxhit të garantuar ka qenë 5.0 miliard Lek (4.4 miliard Lek principal dhe 0.6 miliard Lek interes), nga të cilat 59.7% ose 3.0 miliard Lek janë dhënë nga qeveria. Rreth 87% e pagesave kanë qenë në favor të subjekteve të sektorit të Energjisë. Gjatë vitit 2016 është vënë re një rritje në kapacitetin e pagesave të subjekteve publike, të cilat janë financuar nga burime të garantuara nga Qeveria. Pavarësisht rritjes së aftësisë paguese, është e nevojshme që këto subjekte të rrisin efikasitetin duke menaxhuar më mirë burimet dhe aktivitetet e tyre. Në këtë aspekt, qeveria i ka kushtuar vëmendje të veçantë ristrukturimit të sektorit të Energjisë duke e mbështetur atë si më poshtë:

- Gjatë vitit 2016 është nënshkruar dhe ratifikuar Marrëveshja e Garancisë me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për kredinë që do të rifinancojë overdraftet që Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) ka me disa banka vendase të nivelit të dytë. Kredia arrin në shumën 218 milion EUR dhe do të bëhet efektive gjatë vitit të ardhshëm. Ajo do të përdoret nga KESH për të shlyer të gjitha overdraftet ekzistuese, duke mundësuar uljen e ekspozimit ndaj risqeve dhe përmirësimin e bilancit të KESH në sajë të reduktimit të shpenzimeve për interesa.
- Gjatë vitit 2016, Ministria e Financave ka negociuar dhe nënshkruar Marrëveshjen e Garancisë me Kfë, e cila do të mundësojë lëvrimin e një huaje në vlerën e 50 million EUR, me qëllim financimin e projektit për "Ndërtimin e linjës së transmetimit 400 kV Shqipëri-Maqedoni".

Emetimi i garancive të reja në favor të sektorit të Energjisë, do të kontribuojë në rritjen e efikasitetit dhe njëkohësisht në uljen e riskut të kreditit që paraqesin entitet publike të cilat janë financuar me hua të garantuara nga Qeveria.

Në lidhje me detyrimet kontigjente, më poshtë janë të listuara risqet e mundshme dhe masat e parashikuara në ligjin e projekt-buxhetit 2017 për lehtësimin e tyre:

- Ngjarje të paparashikuara, si fatkeqësitë natyrore, përmbytjet masive, zjarret, tërmetet etj.

Për të përballuar raste të tilla, në ligjin e buxhetit, është planifikuar një fond prej 130 milion Lek në kuadër të programit të "Emergjencave Civile" në Ministrinë e Brendshme. Gjithashtu, përveç kësaj, një alternativë e mundshme është përdorimi i Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit në vlerën prej 1.5 miliard Lek.

- Dështimi për të siguruar në kohë dhe në përputhje me standardet, shërbimet e nevojshme publike nga ndërmarrjet shtetërore (KESH, OST, OSHEE, ndërmarrjet e Ujësjellësit).

Për të përballuar këtë risk, për sektorin e Energjisë në buxhetin e 2017 është planifikuar një garanci shtetërore në vlerën 55 miliard Lek për kreditë që ndërmarrjet publike të këtij sektori mund të marrin nga institucionet financiare.

- Vendimet gjyqësore të cilat shkaktojnë shpenzime të paparashikuara buxhetore.

Për këtë qëllim, çdo institucion buxhetor planifikon brenda buxhetit të tyre të miratuar një sasi të fondeve për vendime gjyqësore që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me aktivitetin e institucionit. Ndërsa për vendimet gjyqësore të

dhëna nga gjykatat ndërkombëtare, do të përdoret Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit.
Në krahun e shpenzimeve buxhetore, risqet konsistojnë në:

- Ngjarjet e paparashikuara si fatkeqësitë natyrore të formës përmbytje masive, zjarre, tërmete etj. Për të përballuar të tilla raste, në buxhetin e vitit 2017 është parashikuar një fond prej 130 milionë Lek në programin "Emergjencat Civile" në Ministrinë e Brendshme, si dhe Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit në shumën 1 miliardë Lek.
- Mos-ofrimi në kohë dhe konform standarteve të shërbimeve publike të domosdoshme nga ndërmarrjet me kapital shtetëror (KESH, OST, OSHEE, Ndërmarrjet e Ujësjellës Kanalizimeve). Për të përballuar këto risqe parashikohet:
- Për sektorin e energjisë është planifikuar një shumë 55 miliardë Lek në formë e garancisë shtetërore për çdo kredi të mundshme që ndërmarrjet publike të këtij sektori mund të marrin nga institucionet kredituese financiare. Kjo garanci ka formën e një detyrim kontigjent, për të parandaluar risqet eventuale të mospagesës së kredisë.
- Për sektorit e ujit është planifikuar një subvencion në shumën 1 miliardë Lek për të garantuar ofrimin e shërbimit konform standardeve.
- Vendimet gjyqësore të formës së prerë që implikojnë kosto buxhetore të paparashikuara. Për këtë qëllim, janë planifikuar në buxhetin e vitit 2017 respektivisht nga çdo institucion buxhetor fonde për vendimet gjyqësore të lidhura me to. Ndërsa për vendimet e formës së prerë të gjykatave ndërkombëtare do të përdoret Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit.
- Partneriteti Publik Privat (PPP) - Ministria e Financave vlerëson dhe miraton, paraprakisht, të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve, individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale. Ndryshimet e fundit të ligjit organik të buxhetit, me synim menaxhimin e risqeve të mundshme ekstrabuxhetore, kanë përcaktuar ndër të tjera që "Shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme për t'u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore"

Aktualisht, janë në fuqi 6 kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP) të cilat marrin mbështetje buxhetore si dhe pritet që gjatë vitit 2017 të startojnë dhe 2 kontrata të reja të lidhura nga Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Shëndetësisë. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të detajuara këto kontrata dhe pagesa vjetore përkatëse:

Tabela 17: Koncesionet/PPP aktive me mbështetje financiare nga buxheti i shtetit

Ministria e Linjës	Emërtimi i Koncesionit/PPP	Kohëzgjatja	Kosto mesatare vjetore (000/lek)
Ministria e Shëndetësisë	Ofrimi i Shërbimit të Kontrollit Bazë (Check-Up)	10 vjet (2015-2024)	787.200
	Ofrimi i shërbimeve të Integruara për ofrimin e setit të përsonalizuar të instrumenteve kirurgjikal, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, si dhe trajtimin e mbetjeve biologjike dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale	10 vjet (2015-2025)	1.230.000
	Ofrimi i Shërbimit të Dializës	10 vjet (2016-2025)	947.100
	Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore*	10 vjet (2017-2026)	886.300
Ministria e Mjedisit	Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkise së Elbasanit	7 vjet (2015-2022)	476.186
	Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier*	6 vjet (2017-2022)	676.500
Ministria e Energjisë dhe Industrisë	Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese	5 vjet (2015 – 2019)	1.291.500
Ministria e Financave	Shërbimi i Skanimit në Dogana	15 vjet (2014-2029)	897.900
TOTALI			**7.192.686**

Për sa i përket respektimit të rregullit të sipërcituar, rezulton se:

- Kufiri i lejuar prej 5% i të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës, pra i vitit 2016, është rreth 18.7 miliardë Lek.
- Referuar tabelës më sipër, pagesat vjetore neto që parashikohen të kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme për kontratat koncesionare apo PPP kapin vlerën e 7.2 miliardë Lek për vitin 2017.

Kësisoj, kufizimi ligjor i sipërcituar rezulton i respektuar, pasi rezulton se pagesat vjetore neto për kontratat koncesionare apo PPP për vitin 2017 të parashikuara në masën 7.2 miliardë Lek përbëjnë rreth 2% të totalit të të ardhurave tatimore faktike për vitin 2016. Respektimi i këtij rregulli si dhe, planifikimi i pagesave vjetore në buxhetin e vitit 2017 për kontratat koncensionare të miratuar, ndikon në shmangien e risqeve të mundshme të lidhura me to.

3.5. Analizë e ndjeshmërisë dhe krahasimi me programin e mëparshëm

Ky seksion paraqet ndikimet e pritshme në kuadrin fiskal, si dhe rregullimet e mundshme të politikave fiskale. Kjo është në përputhje me të dy skenarët alternativë makroekonomike të paraqitura në nenin 2.3.

Në rastin e skenarit "pesimist", i cili supozon një rritje të konsiderueshme më të ulët se parashikimi i skenarit bazë gjatë çdo viti, kuadri fiskal përkatës do të bazohet në elasticitetin e ulët të taksave se në skenarin bazë. Ky supozim reflekton arsyetimin se në përgjithësi një nivel dukshëm më i ulët i rritjes ekonomike pritet të çojë në arkëtim më të ulët të taksave për një numër komponentesh kryesorë të taksave. Ndërsa në rastin e skenarit "optimist" makroekonomik, të ardhurat ndaj PBB-së është supozuar në të njëjtin nivel si në skenarin bazë.

Politika e konsoliduar fiskale është planifikuar të ruhet në çdo skenar makroekonomik. Megjithatë, objektivi sasior i deficitit fiskal vjetor ndryshon pak në çdo skenar duke pasqyruar një rregullim kundërciklike ndaj dinamikave të ndryshme të supozuara të ciklit ekonomik. Më konkretisht, është parashikuar një relaksim të objektivit të deficitit fiskal në rastin e skenarit "pesimist" dhe një konsolidim i fortë fiskale në rastin e skenarit "optimist". Pjesa e humbur (shtrëngim) e objektivit nominal të deficitit në skenarin "pesimist" ("optimist") është sa gjysma e devijimit të të ardhurave totale në secilin prej skenarëve alternativë kundrejt skenarit bazë. Borxhi publik pritet të reduktohet në çdo skenar. Megjithatë, në kundërshtim me skenarin bazë makroekonomik, trajektorja e reduktimit të borxhit publik është më i zbutur në rastin e skenarit "pesimist". Nga ana tjetër, në rastin e skenarit "optimist" ajo formon një kurbë që shkon poshtë më shpejt se në skenarin bazë.

Grafiku 32: Dinamika e treguesve kryesorë sipas skenarëve



Burimi: Ministria e Financave

Tabela 18: Indikatorët kryesorë fiskalë për çdo skenar

	2010	2011	2012	2013	2014	2015 vler	2016 par	2017 par	2018 par	2019 par
Të ardhurat totale (në miliard Lek)										
Bazë	324.7	330.5	330.4	327.2	366.7	379.2	414.5	436.4	466.0	499.6
Pesimist								422.2	444.4	469.6
Optimist								440.6	475.0	514.2
Shpenzimet totale (në miliard Lek)										
Baza nga e cila :	362.8	376.3	376.2	394.1	438.8	437.4	450.2	467.6	496.9	517.2
(% PBB)	*29.3%*	*28.9%*	*28.2%*	*29.2%*	*31.5%*	*30.5%*	*30.0%*	*29.3%*	*29.1%*	*28.2%*
Shpenzimet korrente	300.9	305.6	312.6	328.6	341.0	350.8	374.7	390.2	412.7	429.7
(% PBB)	*24.3%*	*23.5%*	*23.5%*	*24.3%*	*24.5%*	*24.4%*	*25.0%*	*24.4%*	*24.2%*	*23.4%*
Shpenzimet kapitale nga të cilat:	67.5	69.1	61.7	65.5	60.7	63.1	68.7	74.4	77.7	80.1
(% PBB)	*5.4%*	*5.3%*	*4.6%*	*4.8%*	*4.4%*	*4.4%*	*4.6%*	*4.7%*	*4.5%*	*4.4%*
Financim i brëndshëm	46.6	41.1	27.4	36.7	34.0	38.1	36.8	47.7	44.0	45.0
financim i jashtëm	20.9	28.0	34.3	28.8	26.8	24.9	21.9	26.8	33.7	35.1
Kontigjenca								4.0	5.2	7.7
Pesimist nga e cila :								460.5	486.1	502.1
(% PBB)								*29.3%*	*29.3%*	*28.6%*
Shpenzimet korrente								386.2	407.5	422.0
(% PBB)								*24.5%*	*24.6%*	*24.1%*
Shpenzimet kapitale nga të cilat:								71.8	73.0	74.6
(% PBB)								*4.6%*	*4.4%*	*4.3%*
Financim i brëndshëm								45.1	39.4	39.4
financim i jashtëm								26.8	33.7	35.1
Kontigjenca për mbrojtjen e deficitit								0.0	0.0	0.0
Optimist nga e cila :								469.7	501.4	524.4
(% PBB)								*29.1%*	*28.8%*	*27.8%*
Shpenzimet korrente								386.2	407.5	422.0
(% PBB)								*24.0%*	*23.4%*	*22.4%*
Shpenzimet kapitale nga të cilat:								77.0	83.2	89.2
(% PBB)										
Financim i brëndshëm								50.3	49.5	54.1
financim i jashtëm								26.8	33.7	35.1
Kontigjenca për mbrojtjen e deficitit								4.0	5.2	7.7
Deficit i Përgjithshëm (% PBB)										
Bazë	-3.1	-3.5	-3.4	-5.0	-5.2	-4.1	-2.4	-2.0	-1.8	-1.0
Pesimist								-2.4	-2.5	-1.9
Optimist								-1.8	-1.5	-0.5
Financimi i deficitit të përgjithshëm (në miliard Lek)										
Bazë nga e cila :	38.0	45.8	45.9	66.9	72.1	58.2	35.7	31.2	30.9	17.5
Huamarrja e brëndshme neto	11.3	28.2	24.8	46.3	38.2	-17.3	17.3	20.2	30.5	21.4
Huamarrja neto e jashtme nga e cila:	24.9	19.8	19.4	10.8	29.9	64.6	15.8	11.0	0.4	-3.9
Mbështetje buxhetore nga IFIs	0.0	0.0	0.0	0.0	30.5	111.5	21.1	21.0	10.0	10.0
Tjetër, huamarrja e jashtme	26.6	17.6	21.6	9.6	1.3	-43.9	-5.3	-10.0	-9.6	-13.9
Pesimist nga e cila :								38.3	41.7	32.6
Huamarrja neto e brëndshme								27.3	51.3	46.4
Huamarrja neto e jashtme nga e cila:								11.0	-9.6	-13.9
Mbështetje buxhetore nga IFIs								21.0	10.0	10.0
Tjetër, huamarrja e jashtme								-10.0	-9.6	-13.9
Optimist nga e cila :								29.1	26.4	10.3
Huamarrja neto e brëndshme								18.1	36.0	24.1
Huamarrja neto e jashtme nga e cila:								11.0	-9.6	-13.9
Mbështetje buxhetore nga IFIs								21.0	10.0	10.0
Tjetër, huamarrja e jashtme								-10.0	-9.6	-13.9
Borxhi publik total (% PBB)										
Bazë	57.7	59.4	62.1	70.4	72.1	72.7	71.0	68.9	66.3	62.8
Pesimist								70.4	70.0	68.6
Optimist								67.8	65.0	61.1

Burimi: Ministria e Financave

Risqet Fiskale

- Rritja me rreth 20% i çmimit të karburanteve. Treguesit e muajve Tetor-Nëntor 2016 dhe parashikimet e agjensive të specializuara ndërkombetare minimizojnë mundësitë që kjo rritje të mos ndodhë në këtë nivel. Në planifikimin e të ardhurave, është vlerësuar kompensimi i ndonjë oshilacioni të mundshëm të çmimeve, nëpërmjet disiplinimit maksimal të rasteve të përjashtimeve dhe rimbursimeve përtej normave ligjore dhe parashikimeve.
- Eshtë parashikuar një rritje me 200 ton e importit të cigareve me një efekt 1.4 miliardë Lek bazuar në performancën e vitit 2016. Vlerësohet se ndryshimet ligjore për kontrollin e zinxhirit të mbjelljes së duhanit, përpunimit dhe importit të letrës dhe filtrit do të rrisë deklarimet e prodhimit vendas duke kompensuar të ardhurat nga importi.
- Të ardhurat e planifikuara nga TVSH-ja janë bazuar në treguesit e importit. Nëse do të kemi një raport të ndryshëm mes importit dhe prodhimit vendas për karburantet, si rezultat edhe i fillimit të operacioneve të rafinerisë së naftës, mund të ketë rialokim të të ardhurave mes dy Administratave (Tatimore dhe Doganore) dhe ulje të të ardhurave nga TVSH-ja për shkak të bazës më të ulët të taksimit të naftës brenda vendit, me një efekt rreth 10%. Ky risk mund të neutralizohet me rritjen e të ardhurave në tatim fitim, tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontribute në këtë industri.
- Ka një ndryshim në tre vitet e fundit të raportit mes importit dhe prodhimit vendas të energjisë elektrike si rezultat i efekteve pozitive të reformës për shlyerjen e detyrimeve nga subjekte private apo biznese dhe rritje në mënyrë progresive të prodhimit vendas. Ndryshimi i raportit mes importit dhe prodhimit vendas, do të vazhdojë të sjellë rialokim të TVSH-së për vlera më të ulëta në tatime.

3.6. Qeverisja fiskale dhe kornizat buxhetore

Forcimi i programimit buxhetor afatmesëm

Miratimi i amendimeve të ligjit organik të buxhetit në Qershor të vitit 2016, shënoi një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të mëtejshëm të procesit të buxhetimit afatmesëm, disiplinimit dhe mirë-menaxhimit të angazhimeve buxhetore shumëvjeçare, si dhe forcimit të procedurave të programimit dhe menaxhimit të projekteve të investimeve publike.

Miratimi në buxhetin e vitit 2017 i projeksioneve buxhetore mbi bazë programesh buxhetore për periudhën 2018-2019, përmirëson procesin e buxhetimit afatmesëm, si dhe kontribuon në disiplinimin e parashikimeve të detyrimeve kontraktuale që i zgjasin efektet e tyre financiare përtej një viti buxhetor. Në këtë mënyrë, çdo njësi shpenzuese është e detyruar të planifikojë kontrata shumëvjeçare në atë nivel që i lejon tavani buxhetor i përcaktuar për tre vitet e ardhshme në ligjin vjetor të buxhetit. Për të garantuar respektimin dhe kontrollin automatik të këtyre limiteve, Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) është modifikuar dhe vënë në funksionim të plotë gjatë vitit 2016. Synimi final është që të eliminohet çdo mundësi për krijim detyrimesh kontraktuale të reja, të cilat nuk janë të mbuluara me fondet përkatëse buxhetore.

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore kanë përgatitur kërkesat e tyre buxhetore afatmesme konform rregullave dhe procedurave të rishikuara, bazuar në praktikat më të mira në fushën e buxhetimit mbi bazë performance. Përgjatë vitit 2017 synohet që të përmirësohet më tej cilësia e kërkesave buxhetore të institucioneve buxhetore, përmes përzgjedhjes së treguesve të duhur të performancës së objektivave dhe qëllimeve të politikave të tyre, në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2018 – 2020, si dhe monitorimit dhe vlerësimit të rezultateve të arritura bazuar në këtë tregues.

Kështu, gjatë vitit financiar 2017, në vijim të zbatimit të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020:

- Me mbështetjen e donatorëve të huaj, në vitin 2017 do të vijojë puna për vënien në funksionim të sistemit të ri informatik të Menaxhimit të Financave Publike (AFMIS), i cili do të integrojë të gjitha sistemet aktuale që shërbejnë për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit. Zbatimi i plotë i këtij sistemi të integruar do të mundësojë një hap cilësor në planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit mbi baza programore dhe performance.

4. REFORMAT STRUKTURORE PRIORITARE NË 2017-2019

4.1. Identifikimi i pengesave kyçe për rritjen dhe konkurrueshmërinë

Mirëmbajtja e rimëkëmbjes ekonomike Shqipërisë në frymën e balancimit makro-fiskal në afatmesëm, është kritike për rritjen e ardhshme të vendit. Konsolidimi fiskal dhe ulja e borxhit publik është thelbësore për uljen e cënueshmërive të që vijnë nga borxhi të cilat pengojnë rritjen dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike. Konsolidimi fiskal ka nevoje të vazhdojë por duhet të mbështetet nga reforma të thella strukturore siç janë në sektorin e energjisë, sistemin e pensioneve, kthimin dhe kompensimin e pronave etj. Për më tepër, zbatimi i duhur i reformave për menaxhimin publik është kritike për rritjen e eficencës së shpenzimeve buxhetore si dhe për krijimin e hapësirës për më shume shpenzime në produktivitet në periudhën afatmesme.

Mungesa e një transporti hekurudhor efikas; kapaciteti dhe struktura operacionale e infrastrukturës detare ineficente dhe / apo e papërshtatshme; cilësia e ulet e infrastrukturës së transportit rrugor janë pengesa dhe vonesa për integrimin në zinxhirët rajonalë dhe globalë të furnizimit, duke ndikuar negativisht rritjen ekonomike dhe konkurrueshmërinë e vendit. Nevoja për të kombinuar investimet në infrastrukturën e transportit dhe shërbimet me reformën e konektivitetit është jetësore për Shqipërinë. Në sektorin e energjisë, duhet konsoliduar progresi i bërë për uljen e humbjeve nga shpërndarja dhe duke përmirësuar nivelin e mbledhjes se faturave. Megjithatë, pavarësisht potencialit të sektorit dhe performancës së përmirësuar gjatë dy viteve të fundit, importi i energjisë mbetet ende i lartë. Rritja dhe diversifikimi i prodhimit vendas është kyç. Në të njëjtën kohë, reformat ne sistemin e pensioneve dhe sektorin e energjisë janë shumë të rëndësishme për të patur financa publike të qëndrueshme dhe që promovojnë rritje. Rëndesa faktike dhe kontingjente e sistemit të pensioneve dhe sektorit të energjisë në financat publike, dhe rrjedhimisht në të gjithë ekonominë, është shumë e madhe dhe duhet adresuar.

Pengesat rregullatore ndaj biznesit mbeten pengesa për zhvillimin e NVM-ve. Për më tepër, megjithëse janë ndërmarrë masa konkrete për të adresuar nivelin e lartë të kredive të këqija, aksesi në financë mbetet ende një pengese për zhvillimin e bizneseve. Nevoja për të adresuar barrierat institucionale dhe rregullatore me të cilat përballen biznesi; ulja e kompleksitetit të rregullave, procedurave dhe kerkesave te tjerat proceduriale ne vecanti permiresimi i parashikueshmërisë dhe transparencës së rregullave në biznes janë kyçe për zhvillimin e biznesit. Të gjitha masat e ndërmarra mund të stimulojnë vendime të mira për investime dhe për rrjedhoje të kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe rritjen e konkurrueshmërisë. Nevoja për të patur trajtim të barabarte dhe të unifikuar për investitorët, dhe një kuadër të politikave për investime të fortë dhe transparent, kapacitete institucionale të fuqizuara të afta për të lehtësuar mjedisin rregullator për sipërmarrësit etj. do të ndihmojë bizneset lokale të shtrijnë aktivitetin e tyre, të thithin investitorë të huaj dhe të stimulojë potencialet e vendit për të përmirësuar konkurrueshmërinë dhe produktivitetin.

Integrimi në tregtinë rajonale dhe procesi i integrimit evropian kërkojnë një qasje sistematike në drejtim të lehtësimit tregtar dhe të investimeve. Angazhimi në lehtësimin e tregtisë – në kufi dhe përtej – vë më shume theks tek koordinimi dhe harmonizimi politikave, forcon dialogun me sektorin privat dhe forcon kapacitetet me të gjitha agjencitë kufitare. Thjeshtëzimet procedurale dhe ulja e kohës dhe kostos së tregtisë dhe transportit do të kontribuojnë në uljen e distancës ekonomike drejt tregjeve potenciale për eksport.

Niveli i ulët i inovacionit në ekonomi në radhët e NVM-ve kufizon potencialin e vendit për të rritur produktivitetin dhe të përfshihet në produkte me vlerë të shtuar të mesme dhe të lartë. Aftësitë në treg janë ende të limituara dhe nevoja për të investuar më shumë në aftësi dhe kualifikime profesionale mund të kontribuojë në rritjen e potencialeve të punësimit. Kjo kërkon, ndër të tjera, që politikat e tregut të punës të inkorporojnë përfshirjen eficente të grupeve sociale dhe gjinore, zhvillimin e programeve në mbështetje të arsimit dhe formimit profesional, krijimit të mundësive të reja për punësim. Kjo qasje mund të ulë ndasinë midis kërkesës për aftësi dhe ofertës në treg, do të lehtësojë integrimin e grupeve sociale të marxhinalizuara, dhe të ndihmojë në rritjen ekonomike dhe të konkurrueshmërisë së vendit.

4.2. Përmbledhje e reformave prioritare

Qeveria e Shqipërisë, në përputhje me dokumente të rëndësishme strategjike si, SEE 2020, SKZHI 2015-2020 dhe strategjitë e tjera sektoriale, si dhe bazuar në rekomandimet e raportit të vlerësimit të përgjithshëm 2016 të BE-së ka në prioritet për këtë ERP një total prej 19 reformash që mbulojnë një spektër të gjerë të fushave tematike: financa, energji, transport, telekomunikacion, bujqësi, turizëm, industri, klima e biznesit, integrimi tregtar, inovacioni teknologjik, arsim, AFP, punësim, përfshirje sociale.

Në vijim, një listë e 19 reformave prioritare të shtjelluara në këtë dokument:

- Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike dhe Reformat e Kontrollit të Brendshëm
- Liberalizimi i mëtejshëm i tregut të energjisë
- Diversifikimi i burimeve të energjisë (gazifikimi)
- Studim fizibilitetit për ndërtimin dhe përmirësimin e Korridorit Adriatik-Jonian
- Rehabilitimi dhe ndërtimi i segmentit hekurudhor Durrës-TIA-Tiranë
- Miratimi i kuadrit ligjor e rregullator për zhvillimin e infrastrukturës të bandës së gjerë (broadband)
- Konsolidimi dhe defragmentimi i tokës bujqësore
- Standardizimi i industrisë së turizmit
- Prezantimi i politikave strategjike për industrinë jo-ushqimore
- Reduktimi i barrierave për biznesin
- Implementimi efektiv i planit kombëtar për reduktimin e nivelit të kredive të këqija në sistemin bankar
- Mbështetje për zhvillimin e politikave të inovacionit
- Përmirësimi i kapaciteteve institucionale për kërkim shkencor dhe inovacion
- Lehtësimi i tregtisë nëpërmjet zbatimit efektiv të Planit Kombëtar 2017-2020
- Sigurimi i një regjimi të vetëm dhe transparent ligjor të investimeve në vend
- Hartimi i kurikulave të bazuara në kompetenca
- Përmirësimi i cilësisë dhe përfshirjes së AFP duke synuar lidhje me tregun e punës
- Modernizimi i shërbimeve publike te punësimit, rritja e punësimit të grave, të rinjve dhe grupeve vulnerabël
- Forcimi i mbrojtjes sociale dhe masat e përfshirjes sociale

4.3. Analizë sipas fushave dhe reformat strukturore prioritare

4.3.1. Menaxhimi i financave publike

1. *Gjendja aktuale dhe pengesat kryesore në konkurrueshmëri*

Ministria e Financave e Shqipërisë ka miratuar një strategji gjithëpërfshirëse për Menaxhimin e Financave Publike (MFP) për periudhën 2014-2020, si edhe planin e veprimit. Ky sistem i ri u krijua për të reduktuar ose/dhe për të eliminuar disa lloje të kufizimeve ekonomike si: raporti i lartë i borxhit (i cili kishte tejkaluar nivelin 70% të PBB-së), borxhi i qeverisë (72,75 miliardë Lek në vitin 2013), Harmonizimi i Legjislacionit të Prokurimit Publik (LPP) në përputhje me direktivat e BE-së, përmirësimi i transparencës së buxhetit si edhe realizimi i një formulimi real të PBA-së nëpërmjet një MFP-je transparente dhe efiçiente. Kufizime të tilla si borxhi publik dhe detyrimet e prapambetura mobilizojnë kursimet kombëtare dhe zvogëlojnë mundësinë e kreditimit të biznesit dhe të ekonomisë duke penguar në këtë mënyrë rritjen ekonomike; Harmonizimi i LPP-së me direktivat e BE-së siguron prokurime publike transparente, të drejta dhe konkurruese duke krijuar kështu mundësi për biznesin, nxit rritjen ekonomike dhe krijon vende të reja pune. Për monitorimin e reformës së MFP-së është krijuar një drejtori e re pranë MF-së. Progresi i kësaj reforme raportohet mbi bazë 6-mujore dhe vjetore. Arritjet më të fundit të raportuara janë si më poshtë:

Ndryshimet legjislative si: ndryshimet në Ligjin Organik të Buxhetit (miratuar në Qershor 2016), progresi në hartimin e Ligjit për Financat Lokale; ndryshimet në proçeset dhe kulturën e menaxhimit për shkak të përshtatjes së mjedisit të MFK-së në të gjitha entet publike (po asistohen 7 njësi pilote për të zbatuar kërkesat e MFK-së); rishikim i angazhimeve aktuale institucionale, organizimit të brendshëm, si dhe burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik; aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve njerëzore (staf i trajnuar, vizita studimore dhe trajnime në vendin e punës të ofruara në bazë të Marrëveshjes së Binjakëzimit në Ministrinë e Financave); zhvillimi i një SIIMF-je të plotë (do të shtohen edhe 8 institucione të tjera buxhetore në SIMFQ duke arritur në 15 njësi të tilla; përmirësimi i Modulit të Riskut në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve; versioni i ri i Menaxhimit të Borxhit dhe Sistemit të Analizës Financiare ka zëvendësuar versionin e vjetër të saj (SAFMB 6 ka zëvendësuar SAFMB 5.3) në përdorim nga Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik; INTRANET-i është vendosur në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave ku janë publikuar të gjitha politikat, proçedurat, manualet dhe udhëzimet e Doganave; Finalizimi i Protokollit të Komunikimit midis MF-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve)

2. *Raportim mbi zbatimin e politikave udhëzuese nga Maj 2016*

Në lidhje me rekomandimin e parë: "Ndjekja e ndryshimeve fiskale duke siguruar arritjen e objektivave të vendosura si për të ardhurat, ashtu dhe për shpenzimet. Vlerësimi dhe matja e risqeve fiskale që rrjedhin nga kontratat e koçesioneve, nga PPP-ja dhe nga detyrimet e prapambetura të qeverisjes vendore", ndryshimet fiskale janë pjesërisht të përmbushura duke qenë se janë përfshirë në ligjin organik të buxhetit (të miratuar në Qershor 2016). Gjithashtu është krijuar një njësi e re risku në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe është plotësuar me staf në Gusht 2016, funksioni i të cilës është vlerësimi dhe identifikimi i risqeve nga PPP.
Në lidhje me rekomandimin e dytë: 'Mbështetja e konsolidimit fiskal duke përmirësuar kuadrin fiskal; në mënyrë të veçantë, (i) forcimin e planeve buxhetore afatmesme duke fuqizuar Kuvendin për të miratuar tavanet e detyrueshme tre-vjeçare në nivel programi dhe duke treguar në mënyrë të qartë në PBA se cilat fonde janë efektivisht të angazhuara dhe cilat janë shpenzimet e reja nën tavanin e vendosur; (ii) Lëvizja përfundimtare drejt adoptimit të një rregulli fiskal që siguron qëndrueshmërinë, transparencën dhe levizjen kundër-ciklike të borxhit", është përfshirë në LOB, ku janë përmbushur aktivitetet si: 'Përditësimi i listës së Investimeve Publike në linjë me PBA-në për periudhën 2017-2019 dhe merr në konsideratë:
-Projektet kapitale në vazhdim
-Prioritizimin dhe vlerësimin e projekteve kapitale të planifikuara (duke përfshirë edhe analizat e kostos dhe përfitimit)
Rekomandimi i tretë lidhur me strategjinë e MFP-së është "Forcimi i kapaciteteve administrative për të siguruar regjistrimin ligjor të pronës, funksionimi i plotë i kadastrës në përgjithësi dhe sidomos të e-cadastre deri në vitin 2019. Implementimi i e-procedure për lejet e ndërtimit, në mënyrë për të shkurtuar burokracinë dhe nxitjen e investimeve", tashmë ky rekomandim ka filluar të ndiqet që nga viti 2015 dhe ka përparuar, duke përmbushur pjesërisht nën-aktivitetin" Kryerja e studimit të fizibilitetit, përgatitja e Termave të Referencës dhe përzgjedhja e kompanisë për të përgatitur sistemin, por gjatë vitit 2016 nuk është arritur ndonjë progres.

3. *Reformat dhe masat e propozuara*

Reforma #01: Menaxhimi i financave publike

Strategjia e reformës MFP është e organizuar në gjashtë shtylla:
1. Kuadri i qëndrueshëm dhe i matur fiskal
2. Planifikim dhe buxhetim i mirë-integruar dhe efikas i shpenzimeve publike
3. Ekzekutimi efikas i buxhetit.
4. Raportim transparent financiar qeveritar.
5. Kontrollet e brendshme efektive.
6. Mbikëqyrja e jashtme efektive e financave publike.

Secila shtyllë ndahet në disa komponentë. Për përmbushjen e ëdo komponenti kemi aktivitete dhe nënaktivitetet, treguesit për matjen e rezultatit dhe masat e ndryshme që do të merren për të arritur objektivat e synuara.
Strategjia e reformës MFP për shumicën e fushave të menaxhimit financiar publik përforcohet nga strategjitë dhe plane veprimi më të detajuara të përgatitura nga institucionet përkatëse, të tilla si Strategjia për Parandalimin dhe Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura, Strategjia Antikorrupsion dhe Strategjia e reformës PAR. Përveç këtyre, reforma e qeverisë plotësohet edhe nga strategjia e pavarur nga pikëpamja kushtetuese e Kontrollit të Lartë të Shtetit për përmirësimin e punës së institucionit dhe harmonizimin me standartet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Lartë të Auditit.

Kohëzgjatja

2017
- Vlerësimi i Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjshmëria Financiare në nivel vendor
- Miratimi i Ligjit për Financat e Vetëqeverisjes Vendore
- Krijimi i një Instrumenti për Planifikimin Financiar për Qeverisjen Vendore

2018
- Klasifikimi i qartë i projekteve për të shmangur shumëfishimin e panevojshëm të tyre
- Zhvillimi i proçeseve për mbështetjen e IT-së për ndjekjen dhe monitorimin e projekteve të mëdha të investimeve (pjesë e projektit AFMIS)

2019
- Forcimi i kuadrit ligjor dhe institucional për prokurimin publik
- Eliminimi dhe parandalimi i detyrimeve te prapambetura ne nivel vendor

Kosto për aktivitet
Asistenca Teknike e Marrëveshjes financiare 2015 - 2.000.000 EUR.
Shuma e përgjithshme nga komponenti "Për Menaxhimin e Financave Publike", nga projekti SPI 2 - 150,000 EUR.

Impakti në buxhet[10]

Impakti i pritshëm në konkurrueshmëri dhe rezultatet sociale
Strategjia e Reformës në Menaxhimin e Financave Publike 2014 - 2020 do të jetë e orientuar për të siguruar një ndikim të drejtpërdrejtë në institucionet publike dhe për qytetarët që të kenë rezultate të prekshme dhe tregues të matshëm. Ajo ka për qëllim të jetë e fokusuar jo vetëm në planifikim por edhe në zbatimin praktik. Por gjithashtu e një rëndësie të madhe është fakti se shpenzimet publike janë strukturuar në një mënyrë të tillë që maksimizojnë ndikimin pozitiv në ekonominë kombëtare. Prioritet do t'u jepet projekteve dhe programeve me një ndikim të fuqishëm në rritjen ekonomike dhe punësimin.

Risqet e mundshme
Pengesat për zbatimin e reformave të përmendura më lart mund të përmblidhen në:
Vonesat në krijimin e kuadrit institucional / operacional; kufizime teknike dhe financiare të INSTAT-it; Presionet për mos kufizimin e shpenzimeve; Kapacitetet / burimet e nevojshme për menaxhimin në kohë të proçesit; vështirësitë organizative për realizimin e ndryshimeve kryesore proçedurale; Rezistenca ndaj riorganizimit; Disponibiliteti i donatorëve për të përdorur proçedurat kombëtare; Kapaciteti absorbues për fondet e BE-së nga ana e institucioneve shqiptare; Përditësimi i hardëare-it ekzistues të SIFQ-s. Vonesa në fillimin e projekteve të dhëna nga donatorët për të mbështetur aktivitetet e ardhshme.

4.3.2. Energjia, transporti dhe tregjet e telekomit

1. *Gjendja aktuale dhe pengesat kryesore në konkurrueshmëri*

Sektori i energjisë është një nga sektorët strategjikë dhe prioritet i qeverisë shqiptare duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e burimeve të energjisë (uji, era, dielli, nafta, gazi, etj.) që vendi ynë posedon, të cilat deri më tani nuk janë shfrytëzuar plotësisht.
Energjia ka potencial për të qenë një burim i qëndrueshëm i rritjes për vendin nga periudha afatshkurtër dhe deri tek ajo afatmesme dhe afatgjatë. Ajo gjithashtu ka potencialin e rritjes së vlerës së energjisë së prodhuar në vendin tonë dhe uljen e importeve të energjisë. 100% e energjisë elektrike në vend prodhohet nga burimet hidrike, ndërsa vetëm 35% e potencialit hidroenergjitik të Shqipërisë përdoret. Prodhimi i energjisë elektrike është shumë i varur nga paqëndrueshmëria e rrjedhës së ujit në kaskadën e lumit Drin. Aktualisht po vazhdon puna për të rritur kapacitetin e prodhimit përmes koncesioneve për ndërtimin e hidrocentraleve dhe masave për të mbështetur rritjen e kapaciteteve të energjisë së rinovueshme dhe për të shfrytëzuar potencialin e konsiderueshëm të burimeve të rinovueshme të energjisë, kryesisht ujë, biomasa, erë dhe energji diellore.
Në furnizimin me produkte energjetike sipas Bilancit Energjetik të vendit (referuar vitit 2014), energjia elektrike zë rreth 34%, ndërkohë që 53% e përbëjnë produktet hidrokarbure, kryesisht nafta dhe nënproduktet e saj, gjë për të cilën konsiderohet si domosdoshmëri strategjike diversifikimi i burimeve të furnizimit me energji nëpërmjet lidhjes së Shqipërisë me rrjetet rajonale të gazit dhe gazifikimin e vendit.
Reforma në sektorin e energjisë është në progres të shpejtë duke përfshirë edhe liberaliizmin e tregtut të energjisë në përputhje me kërkesat dhe objektivat në kuadër të Paketës së Tretë të Energjisë së BE.
Një progress konkret dhe shumë të rëndësishëm Shqipëria ka bërë edhe në përshtatjen në legjislacionin shqiptar të *acquis communaitaire* në fushën e energjisë, referuar Paketës së Tretë të Energjisë të BE, nëpërmjet miratimit të ligjit nr. 43/2015, datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe ligjit nr. 102/2015, datë 23 09.2015 "Për sektorin e gazit natyror", si dhe përgatitjes dhe miartimit të akteve nënligjore në zbatim të këtyre ligjeve, process i cili është në vazhdim.
Me gjithë potencialet e mëdha të vendit tonë dhe përmirësimin e performancës të sektorit të energjisë gjatë dy viteve të fundit, importet e energjisë mbeten ende të larta. Ajo që synohet është rritja e prodhimit vendas dhe ulja e nivelit të humbjeve teknike dhe jo-teknike të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, çfarë ka ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e sasisë së energjisë së importuar për përmbushjen e kërkesës për energji elektrike në

[10] Nuk është zhvilluar asnjë analizë mbi impaktin në buxhet.

vend.
Shqipëria ka bërë progres në drejtim të eliminimit të rreziqeve të larta fiskale të paraqitura në sektorin e energjisë elektrike, duke ulur humbjet në shpërndarje dhe duke përmirësuar nivelin e arkëtimit të faturave.

Grafiku 33: Niveli i humbjeve në Sistemin e Shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën Janar – Nëntor 2016



Burimi: Të dhëna operative nga OSHEE sh.a.

Grafiku 34: Niveli i arkëtimeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën Janar-Nëntor 2016



Burimi: Të dhëna operative nga OSHEE sh.a.

Ligji Nr. 43/2015 datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", ofron akses në tregun e liberalizuar për klientë të ndryshëm, sipas nivelit të tensionit dhe konsumit të energjisë elektrike[11].

[11] Në paragrafin 1 të këtij neni thuhet: Klientët e tensionit të energjisë elektrike 110 kV dhe më lart, si dhe çdo klient tjetër që pavarësisht rrjetit të energjisë elektrike të tensionit të nivelit, e cila është e lidhur, ka një konsum vjetor të energjisë elektrike më të madh se 50 milionë kWh në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, konsiderohet se ka dalë në tregun e liberalizuar. Konsumatorët e lidhur me nivelin e tensionit 35 kV janë të detyruar të dalin në tregun e liberalizuar jo më vonë se 30.06 2016, konsumatorët e lidhur në 20 kV jo më vonë se 31.12.2016 dhe klientët e lidhur me nivelet 10 kV dhe 6 kV, jo më vonë

Zhvillimi i sektorit të energjisë në Shqipëri deri në vitin 2030, rritja e kërkesave për përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, eficencën e energjisë, futja e gazit natyror pas vitit 2020 si dhe bashkëpunimi rajonal përmes krijimit të një tregu rajonal të energjisë, janë disa nga çështjet kyçe që po trajtohen në draftin final të Strategjisë Kombëtare të Energjisë parashikuar për tu miratuar brenda gjashtëmujorit të parë 2017.
Në sektorin e gazit, përgatitja e MasterPlanit të Gazit për gazifikimin e Shqipërisë, së bashku me Planin e Identifikimit të Projekteve, do të përbëjnë një kontribut konkret në diversifikimin e burimeve të furnizimit me energji, duke përfshirë edhe gazin natyror.
Strategjia Kombëtare e Transportit dhe Plani i Veprimit 2016-2020, janë miratuar së fundmi (me VKM Nr. 811, datë 16/11/2016). Strategjia dhe Plani i Veprimit janë në përputhje të plotë me vizionin strategjik të QSH, me konceptet kryesore të Politikës Evropiane të Transportit (PET) dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI). Veprimet prioritare të identifikuara për periudhën 5-vjeçare janë të ndërlidhura dhe paraqesin një balancë mes masave të buta dhe investimeve, duke marrë në konsideratë Paketën Unike të Projekteve për Transportin (SSPP).
Në sektorin e transportit, Shqipëria ka deficite të mëdha në infrastrukturë, me akses të dobët, sidomos në krahasim me vendet e hershme anëtare të BE-së dhe vendet e tjera. Rrugët dhe autostradat përbëjnë mënyrën mbizotëruese të transportit në Shqipëri, dhe sigurojnë lidhjet thelbësore për transportin e mallrave dhe lëvizshmërinë e personave në vend. Cilësia e infrastrukturës së transportit rrugor mbetet e ulët. Siguria rrugore ende është një çështje e madhe e shëndetit social dhe publik në Shqipëri, edhe pse shkalla e vdekjeve është në rënie gjatë viteve të fundit. Mirëmbajtja e rrugëve përbën rreth 25%-30% të buxhetit të përgjithshëm të nevojshëm për mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore. Rrjeti rrugor ka nevojë për rehabilitim, heqjen e pengesave, mundësimin e ndërlidhjeve, lidhjet intermodale, sistemet e menaxhimit të trafikut dhe përmirësimin e kapaciteteve.
Në transportin hekurudhor, për sa kohë që Shqipëria nuk ka zbatuar plotësisht Direktivën e BE-së 2012/34/BE, sektori hekurudhor nuk do të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme nga pikëpamja ligjore dhe institucionale, duke qenë se institucionet financiare evropiane dhe të tjera do të jenë në mëdyshje për të investuar në infrastrukturën hekurudhore. Ligji i ri Hekurudhor (Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë) i cili përafron legjislacionin kombëtar aktual hekurudhor me legjislacionin e BE-së, është finalizuar në dhjetor 2016 dhe është paraqitur në Kuvend për miratim.
Duke pasur parasysh vijën bregdetare prej 440 km dhe pozicionin strategjik në detet Adriatik dhe Jon, efikasiteti logjistik tregtar i vendit duhet të ishte i mirë integruar në zinxhirët rajonalë, evropianë dhe globalë të furnizimit. Për fat të keq, të dhënat sugjerojnë se kapaciteti dhe strukturat operative të infrastrukturës detare dhe të shërbimeve të ofruara në Shqipëri, është i paefektshëm dhe/ose i pamjaftueshëm, ndërkohë që sektori në tërësi duket se është i integruar në mënyrë të dobët me sektorë të tjerë të ekonomisë dhe me zinxhirët rajonalë dhe globalë të furnizimit. Përmirësimi dhe ndërtimi i infrastrukturës së portit kryesor (Durrës) është në fazën përfundimtare: rehabilitimi i kalatave 7 dhe 8 ka përfunduar dhe dy kalatat janë plotësisht operacionale, ndërkohë që thellimi i basenit të portit dhe ndërtimi i rrjetit hekurudhor të brendshëm, janë në punim e sipër.
Tregu i telekomit është një nga sektorët e rëndësishëm të ekonomisë në vend. Shqipëria, në këtë fazë, ka nevojë për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për të nxitur infrastrukturën e bandës së gjerë. Agjenda dixhitale 2020, në prioritetin strategjik të dytë, "Politika për zhvillimin e komunikimeve elektronike në të gjithë sektorët (shëndetësi, arsim, mjedis, bujqësi, turizëm, kulturë, energji, transport, etj.)", thekson se një nga drejtimet kryesore është zhvillimi i infrastrukturës së përparuar të komunikimeve elektronike së bashku me bandën e gjerë të shpejtë dhe super-të shpejtë. Kjo do të lehtësojë plotësimin e kërkesave për akses në rrjete të shpejta dhe shumë të shpejta për të gjithë sektorët e ekonomisë, për qytetarët, bizneset dhe vetë qeverinë, si një konsumator i gjerë i TIK.
Depërtimit i bandës së gjerë fikse është shumë i ulët, me pak se 10%. Reformat për lidhjet e bandës së gjerë identifikohen si nevoja imediate për të siguruar rritjen ekonomike dhe konkurrueshmërinë dhe për të krijuar një mjedis miqësor investimesh për sektorin privat. Sipas të dhënave, ka katër operatorë celularë në treg, rreth 80 operatorë të telefonisë fikse, rreth 130 ofrues të shërbimit të internetit etj. Depërtimi i celularëve është 117%, me mbi 3.1 milion përdorues në bazë të numrit të kartave SIM aktive; abonimet e bandës së gjerë fikse janë 261 747, përdoruesit e internetit celular të bandës së gjerë janë mbi 1.8 milion. Shifrat për përdoruesit e internetit dhe bandës së gjerë janë rritur nga viti në vit, por penetrimi i bandës së gjerë fikse mbetet në nivele shumë të ulëta në krahasim me vendet e tjera të rajonit dhe me BE-në. Sidomos depërtimi i bandës së gjerë fikse, rreth 9.2%, është ndër më të ulëtat në rajon dhe BE. Raporti i Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit në matjen e

se 31.12.2017 . Konsumatorët e lidhur në tension 0.4 kV kanë të drejtë të zgjedhin lirisht furnizuesin e tyre.

Shoqërisë së Informacionit rendit Shqipërinë në nivelin e ulët të Indeksit të Zhvillimit TIK (IZHT). Telefonia fikse dhe banda e gjerë fikse janë treguesit më të ulët në indeksin e IZHT.
Ligji i ri "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit", (Ligji nr 120/2016), u miratua në Kuvend më 24 nëntor 2016

2. *Raportim mbi zbatimin e politikave udhëzuese nga Maj 2016*

Raporti i KE-së për vitin 2016 për Shqipërinë përcakton se vendi ka miratuar legjislacionin kuadër për gazin dhe energjinë elektrike në përputhje me Paketën e Tretë të Energjisë së BE-së. Megjithatë, legjislacioni dytësor[12] nuk është adoptuar dhe shpërbërja e kompanive shtetërore të transmetimit nuk është finalizuar ende.
Ministria e Energjisë dhe Industrisë është duke punuar në reformën e sektorit të energjisë në kontekstin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, siç është përcaktuar me Ligjin Nr 43/2015, datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike".
Deri më tani, hapat të rendesishme janë ndermarrë për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike si më poshtë:

- Miratimi i Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike me VKM Nr 519, datë 13.07.2016 "Për miratimi i Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike" është një hap shumë i rëndësishëm drejt zhvillimit të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri, si një treg plotësisht konkurrues në përputhje me obligimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.
- Në sektorin e energjisë elektrike ka përfunduar plotesisht procesi i ndarjes së pronesise së kompanisë shtetërore të transmetimit të energjise elektrike OST sh.a, nga pronësia e KESH sh.a dhe OSHEE sh.a. VKM-ja Nr 317, datë 27.04.2016 "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar i aksioneve në kompanitë në sektorin e energjisë elektrike", përcakton MZHETTS si autoritetin publik pronar të aksioneve të OST sh.a dhe MEI si autoritetin publik pronar te aksioneve të OSHEE sh.a dhe KESH sh.a.
- Detyrimi i Furnizimit Publik me Shumice ka kaluar nga KESH sh.a në OSHEE sh.a. KESH sh.a nuk ka me detyrimin të blejë energjinë elektrike të prodhuar nga prodhuesit e vegjel të energjisë elektrike. KESH sh.a vepron aktualisht vetëm si një operator publik i prodhimit të energjisë elektrike. Ky ndryshim është miratuar me VKM Nr. 244, dt. 30.03.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimeve të shërbimit publik për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, të cilat veprojnë në prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike", dhe Vendimin e ERE nr 80, dt. 23.10.2009.
- Pra aktualisht procesi i ndarjes së KESH s.a është finalizuar. Procesi i plotë i ndarjes së OSHEE sh.a do të bëhet vetëm nga 31 dhjetor 2017. Ndarja e OST-së është në proces.

Deri më tani, janë ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm për liberalizimin e tregut të energjisë[13], ndjekur nga procesi i vazhdueshëm për përgatitjen dhe miratimin e legjislacionit dytësor të gazit, së bashku me përgatitjen dhe miratimin e mëtejshëm të Master Planit të gazit dhe Planit të Identifikimit të Projekteve, një aktivitet i zhvilluar në bashkëpunim me konsulentin COWI-IPF. Një proces i vazhdueshëm është përfundimi i detyrimit për krijimin e kompanisë së re të gazit, Albgas s.a., përmes ndarjes së veprimtarive të transmetimit të gazit dhe shpërndarjes nga Albpetrol.
Është miratuar VKM nr. 848, datë 7.12.2016, "Për krijimin e shoqërisë "ALBGAZ" sha dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive "ALBPETROL" sha dhe "ALBGAZ" sha.", i cili ka hyrë në fuqi më 13.12.2016. Aktualisht është bërë regjistrimi në QKB i shoqërisë "ALBGAZ" sh.a., si dhe janë zgjedhur organet drejtuese të shoqërisë.
Strategjia Kombëtare e Transportit dhe Plani i Veprimit 2016-2020, janë miratuar së fundmi (VKM Nr 811, datë 2016/11/16), ndërsa Paketa Unike e Projekteve për sektorin e transportit është përgatitur dhe miratuar.
Në lidhje me bandën e gjerë, Ligji 120/2016 "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë

[12] Përgatitur projekt VKM "Për miratimin e afateve dhe procedurave për krijimin e detyrimit të shërbimit publik për të licencuarit në industrinë e gazit natyror"; "Për miratimin e planit të emergjencës për gazin natyror", "Për miratimin e kushteve dhe procedurës për përcaktimin e furnizuesve të gazit natyror të instancës së fundit", etj.
[13] Miratimi i VKM Nr 519, datë 2016/07/13 "Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike; VKM nr. 317, datë 2016/04/27 "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve në kompanitë në industrinë e energjisë elektrike"; VKM nr. 244 i 03.30.2016 "Për miratimin e kushteve për Krijimin e detyrimeve të sektorit publik për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike të cilat operojnë në prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike"; Procesi i shpërbërjes së KESH S.A. është finalizuar. Procesi i plotë i ndarjes së OSSH-së do të bëhet vetëm nga 31 dhjetor 2017. Ndarja e OST-së është në proces

së lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit", është miratuar nga Kuvendi më 24 nëntor 2016.

3. Reformat dhe masat e propozuara

Reforma #02: Liberalizimi i mëtejshëm i tregut të energjisë

Liberalizimi i tregut të energjisë konsiston në një sërë masash me qëllim realizimin e konkurrencës më të madhe në tregjet e energjisë elektrike dhe gazit, në interes të krijimit të tregjeve më konkurruese dhe uljen e çmimit si rezultat i privatizimit.

Reforma e sektorit të energjisë është në progres, duke përfshirë liberalizimin e tregut të energjisë, në përputhje me angazhimet e MSA-së dhe Traktatin e Komunitetit të Energjisë, në kuadër të Paketës së tretë të Energjisë.

Në përputhje me masat e parashikuara në Programin e mëparshëm dhe në funksion të arritjeve aktuale, ERP 2017-2019 do të fokusohet në masat e mëposhtme:

- Miratimin e akteve ligjore për themelimin e "Bursës Shqiptare të Energjisë" dhe ndarjen e OSHEE sh.a.; Procesin e plotë të ndarjes së aktivitetit të shpërndarjes nga furnizimi. OSHEE sh.a. ka përgatitur planin e ndarjes dhe ka përzgjedhur një kompani konsulente për këtë çështje; Përfundimin e projektit në sistemin e transmetimit nëpërmjet ndërtimit të linjës 400 kV të Interkoneksionit Elbasan (Shqipëri) - Manastir (Maqedoni).

Kohëzgjatja

2017

- Miratimi i akteve ligjore për themelimin e "Bursës Shqiptare të Energjisë" dhe ndarjen e OSHEE-së;
- Prokurimi i shërbimeve të konsulencës teknike dhe nënshkrimit të kontratës për linjën 400 kV të Interkonjeksionit Elbasan (Shqipëri) - Manastir (Maqedoni);
- Zhvillimi i projektimit të detajuar (faza 1) për linjën e interkonjeksionit Elbasan (Shqipëri) - Manastir (Maqedoni).

2018

- Zhvillimi i projektimit të detajuar (faza 1) për linjën 400 kV të Interkonjeksionit Elbasan (Shqipëri) - Manastir (Maqedoni);
- Zbatimi i projektit për linjën 400 kV të Interkonjeksionit Elbasan (Shqipëri) - Manastir (Maqedoni): Zbatimi i Lotit 1;
- Zbatimi i projektit për linjën 400 kV të Interkonjeksionit Elbasan (Shqipëri) - Manastir (Maqedoni): Zbatimi i Lotit 2.

2019

- Zbatimi i projektit për linjën 400 kV të Interkonjeksionit Elbasan (Shqipëri) - Manastir (Maqedoni): Zbatimi i Lotit 1;
- Zbatimi i projektit për linjën 400 kV të Interkonjeksionit Elbasan (Shqipëri) - Manastir (Maqedoni): Zbatimi i Lotit 2.

Kosto për aktivitet

Procesi i ndarjes së shoqërisë OSHEE sh.a nuk ka ndikim në buxhetin e shtetit. Kostoja e këtij procesi deri tani për kompaninë OSHEE sh.a, është vlera e kontratës së konsulencës me kompaninë "Com Metodi" SPA, 134.320.560 Lek (pa TVSH).

Kostoja totale e projektit "Linja interkoneksionit 400 kV Elbasan (Shqipëri) - Manastir (Maqedoni), është 70 milion Euro, i financuar 50 milion Euro nga KfW (kredi), 15 milion Euro nga WBIF (grant) dhe 5 milion Euro nga OST sh.a

Impakti në buxhet

Nuk ka impakt në buxhet.

Impakti i pritshëm në konkurrueshmëri dhe rezultatet sociale

Liberalizimi i mëtejshëm i tregut të energjisë që do të çojë në decentralizimin e sistemit të energjisë do të ketë ndikime të drejtpërdrejta pozitive në konkurrueshmëri duke mundësuar pjesëmarrjen e operatorëve privatë në tregun e energjisë elektrike dhe do të rrisë cilësinë e furnizimit. Kjo reformë do të rrisë në mënyrë të konsiderueshme investimet dhe do të kontribuojë në punësim si dhe do të lejojë uljen e kostos së energjisë për konsumatorët.

Risqet e mundshme
Procesi i liberalizimit të tregut të energjisë elektrike mund të ndeshet me pengesa teknike, në fazën e zbatimit të tij. Ndërtimi i linjës së interkoneksionit 400 kV Shqipëri- Maqedoni mund të hasë në pengesa në procedurat e shpronësimit, prokurimit dhe licensimit të nevojshme për implementimin e këtij projekti. Nisur nga natyra komplekse e projektit, gjatë fazë së implementimit të tij, mund të hasen vështirësi teknike.

Reforma #03: Diversifikimi i burimeve të energjisë (gazifikimi)
Diversifikimi i burimeve të energjisë në sektorin e gazit konsiston në një sërë nismash rregulluese dhe projekte investuese me qëllim arritjen e sigurisë të konsiderueshme të energjisë dhe përfitimeve ekonomike në vend.

Kohëzgjatja
2017
- Përgatitja dhe miratimi i Studimit të Fizibilitetit për gazsjellësin, që lidh termocentralin e Vlorës me projektin e gazsjellësit TAP në stacionin e kompresorit në rajonin e Fierit;
- Përgatitja dhe miratimi i Master Planit të gazit për Shqipërinë dhe Planit të Identifikimit të Projektit;
- Plotësimi i legjislacionit dytësor të gazit në bazë të ligjit të ri të gazit;
- Përgatitja dhe miratimi i projektimit paraprak teknik për pjesën shqiptare dhe malazeze të projektit të gazsjellësit IAP;
- Përgatitja dhe miratimi i Studimit të Parafizibilitetit për Projektin e gazsjellësit ALKOGAP (Ndërlidhësi i Gazit Shqipëri-Kosovë).

2018
- Përgatitja dhe miratimi i projektimit paraprak teknik për pjesën shqiptare dhe malazeze të projektit të gazsjellësit IAP.

Kosto për aktivitet
- Përgatitja dhe miratimi i Studimi të Fizibilitetit për gazsjellësin që do të lidhë projektin TAP me TEC-i Vlorë- kosto është 300.000 EUR Grant, financuar nga Konfederata e Zvicrës (SECO) në kuadër të Marrëveshjes për ngritjen e kapaciteteve në sektorin e gazit në Shqipëri;
- Përgatitja dhe miratimi i Master Planit të gazit për Shqipërinë dhe Planit të identifikimit të projektit - 1,1 milion Euro, Grant, financuar nga WBIF;
- Plotësimii legjislacionit dytësor të gazit në bazë të ligjit të ri të gazit - shpenzimet administrative;
- Përgatitja dhe miratimi i projektimit paraprak teknik për pjesën shqiptare dhe malazeze të projektit të gazsjellësit IAP - 2,5 milion Euro Grant, (në total, për pjesën shqiptare dhe malazeze të projektit IAP), financuar nga WBIF;
- Përgatitja dhe miratimi i Studimit të Parafizibilitetit për Projektin e gazsjellësit ALKOGAP - 0.3 milionë Euro, Grant, financuar nga WBIF.

Impakti në buxhet
Projektet që financohen nga ËBIF janë të përjashtuara nga rimbursimi i TVSH, pasi janë projekte që menaxhohen direkt nga BE dhe zyrat përkatëse në rajon.
Ndërkohë për projektin e Studimit të Fizibilitetit për gazsjellësin që do të lidhë projektin TAP me TEC-i Vlorë – për financimin prej 300.000 EUR do të rimbursohet TVSH në vlerën 60000 Euro si kosto lokale, tashmë të përfshira në buxhetin e shtetit.

Impakti i pritshëm në konkurrueshmëri dhe rezultatet sociale
Diversifikimi i burimeve të energjisë (gazifikimi) do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv në rritjen e konkurrueshmërisë duke bërë të mundur hyrjen e një burimi të ri të energjisë në tregun e energjisë së vendit, si dhe do të kontribuojë në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji. Kjo reformë do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë social, duke përmirësuar mundësitë e punësimit.

Risqet e mundshme
Realizimi i projekteve dhe studimeve në funksion të diversifikimit të burimeve të furnizimit me energji dhe konkretisht për gazifikimin e vendit dhe që lidhen me zhvillimin e rrjetit të gazit në Shqipëri dhe të linjave të

interkoneksionit me rajonin dhe më gjerë, nuk parashikohet që të ketë risk pasi aktualisht financimet janë të miratuara dhe janë donacione nga struktura të ngritura në kaudër të BE.

Reforma #04: Studimi i fizibilitetit për ndërtimin dhe përmirësimin e Korridorit Adriatik-Jonian
Korridori Adriatik-Jonian është një projekt strategjik i destinuar për rajonin e Evropës Juglindore dhe në Ballkan. Përfundimi i tij do të japë një korridor me kapacitetit të lartë dhe cilësi i cili do të lidhë Evropën Qendrore dhe Veriore në Itali me gadishullin Jon nëpërmjet Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Malit të Zi, Shqipërisë dhe Greqisë.
Autostrada Adriatiko–Joniane është e përfshirë në zgjerimin e Rrjetit Kryesor TEN-T, bazuar në rrjetin gjithëpërfshirës SEETO, i cili përfshin Korridorin Rrugor shqiptar Veri-Jug që lidh kufirin me Malin e Zi dhe me kufirin grek, nëpërmjet territorit shqiptar (Route 2).

Kohëzgjatja
Zbatimi i masës së reformës do të përfshijë veprimet e mëposhtme:
2017
- Tenderimi i shërbimeve për përgatitjen e projektit për studimin e fizibilitetit; Përgatitja e ToR (Termat e Referencës) për studimin e fizibilitetit; Faza fillestare e studimit të fizibilitetit dhe studimin e fizibilitetit .

2018
- Faza fillestare e studimit të fizibilitetit dhe studimi i fizibilitetit (gjysma e parë e 2018). Kërkesa e grantit të dytë të financimit për fazën e ardhshme (e projektimit të detajuar).

2019
- Përgatitja e procedurave të tenderit për përzgjedhjen e kompanisë përgjegjëse për projektimin e detajuar.

Kosto për aktivitet
2.5 milion EUR grant, kontribut i WBIF, me përjashtim të TVSH-së.

Impakti në buxhet
20% TVSH e shumës së grantit (500,000 EUR) si kosto lokale, tashmë të përfshira në buxhetin e shtetit.

Impakti i pritshëm në konkurrueshmëri dhe rezultatet sociale
Autostrada Adriatiko-Joniane do të lejojë krijimin e një sistemi konkurrues, të besueshëm dhe të sigurt të transportit në vend, do të pakësojë pengesat e trafikut, aksidentet rrugore dhe nivelet e zhurmës e emisionet. Këto pritet të arrihen pas përfundimit të projektit. Nga ana tjetër, do të krijojë një lidhje më të mirë rrugore me vendet fqinje, do të rrisë në mënyrë të konsiderueshme shkëmbimet tregtare, ndjekur nga ulja e shpenzimeve operative të automjeteve dhe konsumit të energjisë.

Risqet e mundshme
Të gjitha procedurat janë të menaxhuara nga WBIF. Kjo mund të shkaktojë vështirësi në përcaktimin e afateve për zbatimin e masave, në veçanti për të siguruar fondet për fazën vijuese, projektimin e detajuar.

Reforma #05: Rehabilitimi dhe ndërtimi i segmentit hekurudhor Durrës-Aeroporti i Rinasit-Tiranë
Projekti konsiston në rehabilitimin e Terminalit të Transportit Publik (TTP) Tiranë – Durrës të linjës hekurudhore (34.7 km) dhe në ndërtimin e një linje të re hekurudhore TTP Tiranë- Aeroporti i Rinasit (7.4 km). Qëllimi është përmirësimi i ndërlidhjes hekurudhore, rrugore, detare dhe ajrore si modalitete transporti; lidhjes ndërmjet portit detar të Durrësit me TTP Tiranë dhe lidhjes hekurudhore me Aeroportin e Rinasit (TIA).
Ky projekt investimi është pjesë e Rrjetit Qendror të Korridoreve, pjesë e zgjerimit në Ballkanin Perëndimor të Rrjetit Trans-Evropian të Transportit (TEN-T), si dhe Observatorit të Transportit të Evropës Juglindore (SEETO). Projekti është gjithashtu në përputhje me politikat kombëtare për sektorin e hekurudhave dhe në veçanti: Programin e Qeverisë Shqiptare, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim SKZHI II 2015-2020, Planin Vjetor Kombëtar të Transportit, si dhe Planin e Qëndrueshëm të Transportit, Strategjinë Sektoriale të Transportit 2016-2020 dhe Strategjinë Kombëtare për zhvillimin e hekurudhave 2014-2016. Më 21 mars 2016 është miratuar nga KKI (Komiteti Kombëtar për Investime), si një prioritet i lartë strategjik i rëndësisë për vendin, i paraqitur në paketën WBIF.
Në periudhën e ardhshme, aktivitetet pjesë e projektit do të konsistojnë në:

- Rehabilitimin e segmentit ekzistues Durrës-Tiranë; Ndërtimin e segmentit të ri të Aeroportit të Rinasit-Tiranë; Ekzekutimin dhe përfundimin e procedurave të tenderimit.

Kohëzgjatja
2017
- Nënshkrimi i marrëveshjes së projektit ndërmjet Hekurudhës Shqiptare dhe BERZH-it, për të dy masat;
- Nënshkrimi i marrëveshjes së kredisë ndërmjet Ministrisë së Financave dhe BERZH-it për të dy masat;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve suplementare ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Hekurudhës Shqiptare;
- Zhvillimi i procedurave të tenderimit për dhënien e kontratës.

2018
- Rehabilitimi i segmentit ekzistues Durrës-Tiranë.

2019
- Rehabilitimi i segmentit ekzistues Durrës-Tiranë;
- Ndërtimi i segmentit të ri të aeroportit Rinas-Tiranë.

Kosto për aktivitet
Kostoja e vlerësuar për të gjithë projektin është 90.45 milion Euro:
* 36,65 milionë EUR, Grant, kontribut nga BE / WBIF
** 36,87 milionë EUR, Kredi, kontributi i BERZH (periudha e shlyerjes 15 vjet)
*** 0.87 milionë EUR, Grant kontribut nga BERZH
**** 16,06 milionë EUR, kontribut nga Përfituesi

Impakti në buxhet
16,06 milionë EUR, kontribut i përfituesit (15.06 milionë EUR TVSH dhe 1 milion EUR kosto të shpronësimit).

Impakti i pritshëm në konkurrueshmëri dhe rezultatet sociale
Rehabilitimi dhe ndërtimi i segmentit hekurudhor Durrës - Aeroport i Rinasit-Tiranë do të lehtësojë transportin e mallrave dhe personave në arteriet kryesore të vendit. Kjo do të bëjë të mundur rritjen e shpejtësisë së udhëtimit për pasagjerët dhe mallrat nga 60 km/h në 120 km/h, si dhe ngarkesën e mallrave në 22.9 ton, gjatë gjithë aksit Tiranë - Durrës. Projekti pritet t'u shërbejë pothuajse 1,4 milionë pasagjerëve në vit dhe mbi 220.000 ton mallrave, që nga viti i parë i funksionimit.
Krijimi i punësimit do të jetë një nga rezultatet e para të projektit (priten më shumë se 1375 vende të reja pune të krijuara) pasuar nga reduktimi i kohës së udhëtimit (vlerësuar në 55 mil. EUR) dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit.

Risqet e mundshme
Pengesa të veçanta mund të lindin gjatë zhvillimit të procedurës së shpronësimit, e nevojshme për zbatimin e projektit, dhe disa pengesa teknike, duke konsideruar vetë natyrën e projektit.

Reforma #06: Miratimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për zhvillimin e infrastrukturës të bandës së gjerë
Miratimi i ligjit të ri dhe akteve rregullatore përkatëse, lejon krijimin e kuadrit të duhur për zhvillimin e rrjeteve me shpejtësi të lartë të komunikimeve elektronike, duke promovuar përdorimin e përbashkët të infrastrukturës ekzistuese dhe zhvillimin e infrastrukturës së re fizike, me qëllim zvogëlimin e shpenzimeve përmes bashkëpunimit, shkëmbimit të infrastrukturës dhe sinergjive me shërbimet e tjera, koordinimin e punimeve civile dhe krijimin e një pike të vetme informacioni. Gjithashtu, ligji i ri adreson çështjet lidhur me të drejtën e kalimit.

Pjesë e planit për zbatimin e kësaj mase të reformës gjatë viteve të ardhshme do të jetë:
- Përgatitja dhe miratimi i akteve nënligjore, në bazë të Ligjit Nr. 120/2016, duke përfshirë konsultime me sektorin privat dhe aktorë të tjerë; Hartimi i politikave spektrale për nxitjen dhe zhvillimin e investimeve në lidhjet kabllore dhe mbulimin nëpërmjet rrjeteve LTE; Rishikimi i planit të veprimit të Planit Kombëtar të Broadband (NBP).

Kohëzgjatja
2017

- Hartimi i spectrum policy paper;
- Përgatitja dhe miratimi i akteve nënligjore në bazë të ligjit të miratuar mbi rrjetet me shpejtësi të lartë të komunikimit elektronik dhe konsultime me sektorin privat dhe grupet e tjera të interesit.

2018

- Rishikimi i planit të veprimit si pjesë e Planit Kombëtar të Broadbandit të miratuar në vitin 2013

Kosto për aktivitet

- 1.764 EUR nga buxheti i shtetit për hartimin e politikave spektrale;
- 3500 EUR nga buxheti i shtetit për përgatitjen dhe miratimin e akteve nënligjore në bazë të ligjit të miratuar mbi rrjetet me shpejtësi të lartë të komunikimit elektronik dhe sigurimin e të drejtës së kalimit;
- 2000 EUR nga buxheti i shtetit për konsultim me sektorin privat dhe grupet e interesit;
- 5292 EUR nga buxheti i shtetit për rishikimin e planit të veprimit, pjesë e Planit Kombëtar të Broadband.

Impakti në buxhet

Nuk ka asnjë ndikim shtesë në buxhet lidhur me këtë reformë, përveç kostos së aktiviteteve si pjesë e kostos administrative të personelit publik të përfshirë (parashikuar në buxhetin e shtetit).

Impakti i pritshëm në konkurrueshmëri dhe rezultatet sociale

Shoqëria Dixhitale është një nga dimensionet nën kolonën "Rritje e zgjuar" të Strategjisë së Evropës Juglindore (EJL)-2020. Zhvillimi i infrastrukturës kabllore është një nga qëllimet e rëndësishme të kësaj strategjie rajonale. Janë parashikuar një sërë masash, në përputhje me objektivat e EJL-2020, me procesin e integrimit në BE dhe programin kombëtar. Masa e propozuar e reformës do të parashikohet për të rritur investimet në vend, për të përmirësuar depërtimin kabllor, për të rritur efikasitetin e infrastrukturës ekzistuese, nëpërmjet ndarjes së infrastrukturës, si dhe rritjes së konkurrencës.

Disa nga përfitimet në kuadrin social dhe të mjedisit janë si: mbulim më i mirë me internet me brez të gjerë, që do të thotë kohezioni social dhe territorial, rritja e sinergjive në të gjithë sektorët p.sh. rrjetet e zgjuar dhe sisteme inteligjente transporti, më pak dyfishim të punimeve civile, më pak gërmime apo zhurmë, përmirësim i klimës së biznesit përmes procedurave transparente dhe të thjeshta për leje ndërtimi, etj.

Risqet e mundshme

Infrastruktura dixhitale dhe infrastruktura të tjera të tilla si projekti i transportit dhe energjisë duhet të koordinohen në mënyrë që të përfitojnë nga sinergjitë dhe investimet e përbashkëta. Mungesa e bashkëpunimit mes aktorëve të ndryshëm të përfshirë në këtë proces është një nga vështirësitë e identifikuara në këtë sektor.

4.3.3. Zhvillime sektoriale

1. *Gjendja aktuale dhe pengesat kryesore në konkurrueshmëri*

Konkurrueshmëria e sektorit bujqësor vuan nga sipërfaqet e vogla të fermave bujqësore. Megjithatë, vërehet një trend pozitiv i konsolidimit të fermave. Sipërfaqja mesatare e fermave u rrit nga 1.14 ha (2007) në 1.20 ha (2012). Segmenti i fermave të orientuara drejt tregtisë ka ardhur në rritje. Megjithatë, fermat vazhdojnë të jenë kryesisht të subvencionuara dhe pjesa më e madhe e produkteve bujqësore është e destinuar për konsum shtëpiak. Mungon një traditë dhe vullnet për bashkëpunim midis fermerëve. Numri i grupeve të fermerëve dhe kooperativave vazhdon të jetë i vogël, pavarësisht përpjekjeve të shumë organizatave donatore për të nxitur bashkëpunim të fermerëve në aktivitete të ndryshme.

Rendimenti i punës është në nivele të ulëta krahasuar me mesataren e përgjithshme të BE-së dhe krahasuar me 10 vendet anëtare të BE-së (EU-10). Në 2007, niveli i rendimentit të punës në bujqësinë shqiptare ishte 2,183 EUR për AWU, ndërsa në BE 10 ishte 4000 EUR. Në 2012 u rrit në 3,537 për AWU krahasuar me 6,914 EUR për AWU të BE-10. Niveli i ulët i rendimentit të punës krahasuar me vendet e BE-së (me gjithë rritjen prej 65% në 2012 ndaj 2017 si pasojë e fragmentimit të tokës), vjen nga teknologjia e prapambetur, infrastruktura rurale e dobët, rrugët, furnizimi me ujë, kanalizimi i ujërave të zeza, sistemi i drenazhimit, mungesa e tregut.

Niveli i investimeve në bujqësi vazhdon të jetë i ulët. Në 2011, sektori bujqësor investoi të paktën 20 milion EUR (duke përfshirë investime private dhe mbështetje shtetërore), që është ende në nivele të ulëta.

Aktualisht, potenciali bujqësor nuk shfrytëzohet plotësisht dhe niveli i investimeve vazhdon të jetë i ulët. Regjistri i tokës, dixhitalizimi i kadastrës së tokës i organizuar në një sistem, janë pengesa në zbatimin e menaxhimit të qëndrueshëm të përdorimit të tokës bujqësore, mbrojtjen, konsolidimin si dhe zhvillimin e tregut të pronave. Në

2016, në kuadër të programit për menaxhimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore, e cila ka për synim vendosjen e informacionit mbi tokat bujqësore, u realizua dixhitalizimi i regjistrit të tokës bujqësore në 20 njësi administrative në qarqet Berat, Dibër, Fier, Gjirokastër, Tiranë dhe Vlorë.
Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave e konsideron konsolidimin e tokës si prioritet për rritjen e konkurrueshmërisë në sektor. Strategjia për Konsolidimin e Tokës është miratuar me VKM nr. 700, datë 12.10.2016 dhe trajton problemin në një periudhë 14 vjeçare në 3 faza. Faza e parë mbulon periudhën 2017-2020 gjatë së cilës MBZHRAU planifikon të organizojë aktivitete të ndryshme të lidhura me konsolidimin e tokës, siç është përshkruar në këtë dokument.
Bujqësia kontribuoi gati 20% të PBB-së në 2014 dhe është punë-krijuesi më i madh në vend me pothuajse 48% të të punësuarve totalë. Migracioni nga zonat rurale në ato urbane ka ndikuar në rënien e të punësuarve në këtë sektor.
Afërsisht 81% e tokës së lërueshme është private.
Sipas të dhënave të Censusit Bujqësor 2011, në Shqipëri ka 324 prona bujqësore, 71% e të cilave kanë bagëti.
Konsolidimi i tokës bujqësore është ndër prioritetet e programit të Qeverisë, SKZHI, Strategjisë Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, programi IPARD 2, strategjia për konsolidimin e tokës, etj. kjo reformë i shërben krijimit të fermave familjare që janë ekonomikisht të suksesshme, konkurruese dhe të qëndrueshme. Sistemi i informacionit të tokës është një instrument efektiv për implementimin e menaxhimit të qëndrueshëm të tokës bujqësore, përdorimit, mbrojtjes dhe konsolidimit të tokës.

Në 2016 u hartuan dhe miratuan një numër aktesh nënligjore në zbatim të dhe në përputhje me Ligjin për turizmin. Këto akte nënligjore përcaktojnë rregullat për vendosjen e kushteve, kritereve dhe procedurave për ushtrimin e veprimtarisë së agjencive turistike dhe operatorëve turistik, klasifikimin e strukturave akomoduese dhe certifikimin e udhërrëfyesve turistikë. Gjithashtu, vlen për t'u përmendur se është rishikuar Strategjia për Zhvillimin e Turizmit 2017-2022 dhe drafti përfundimtar do të dërgohet për shqyrtim në Këshillin e Ministrave brenda 3-mujorit të parë të vitit 2017.
Në kuadër të procesit të klasifikimit të strukturave akomoduese, po hartohet një manual për "Klasifikimin e strukturave akomoduese" dhe pritet të përfundohet brenda Dhjetor 2016. Gjatë vitit 2016 u punua për krijimin e një Sistemi Online për Aplikimin, Klasifikimin dhe Raportimin e të dhënave të Strukturave Akomoduese, i cili parashikohet të testohet në fillim të vitit 2017 dhe përbëhet nga 3 module: (i) Moduli i aplikimit online (vetëdeklarim); (ii) Moduli i verifikimit; (iii) Moduli i raportimit të të dhënave turistike .
Për më tepër, krijimi i grupeve të vlerësuesve për klasifikimin e subjekteve akomodueese parashikohet të përfundojë brenda Dhjetor 2016. Lidhur me përgatitjen e kurrikulave për udhërrëfyesit turistik , në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës dhe Shoqatën Kombëtare të Udhërrëfyesve Turistikë Shqiptar (NATGA) e me mbështetjen e Federatës Botërore të Shoqatave të Udhërrëfyesve Turistik (WFTGA), janë njehsuar me standardet ndërkombëtare kurrikulat për kategori. Si hap në vijim pritet një urdhër i përbashkët nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, që do të formalizojë këto kurrikula dhe mënyrën e akreditimit të institucioneve që do të ofrojnë këto kurrikula.
Ndryshe nga se ishte parashikuar, në 2016 u vendos që Inspektorati për Turizmin nuk do të jetë institucion më vete por do të jetë pjesë e Inspektoratit Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut. Janë miratuar akti nënligjor (VKM nr. 36/2016) për krijimin e tij, struktura organizative dhe buxheti për funksionimin e institucionit, për të vijuar më tej me rekrutimin e stafit.

Industria përpunuese në Shqipëri në vitet e fundit të tranzicionit është fokusuar në sektorë tradicionalë siç janë kromi dhe bakri, megjithatë si rrjedhojë e kërkesës në rritje për ndërtime, ka njohur zhvillim edhe sektori i përpunimit të mineraleve jo-metalike si çimento, tulla, gurë dekorativ, etj. Pavarësisht vështirësive, ky sektor ka mundur të konkurrojë në tregjet vendase, rajonale e më tej.
Sektori tradicional i kromit, duke hasur rënie të rezervave të pasura minerale në 2-3 vitet e fundit, është më mirë i orientuar drejt rritjes së interesit për përpunim në shkallë kombëtare në vend të mineraleve të varfëruar përmes pasurimit dhe shkrirjes, duke rritur vlerën e tyre në rajon e më gjerë.
Tradicionalisht sektori i bakrit ka operuar me cikël të plotë për shumë vite. Ndërkohë nga 1999 e deri tani është fokusuar në shfrytëzimin e disa skemave të pasurimit të burimeve të përzgjedhura të bakrit. Fragmentimi i saj nëpërmjet heqjes së ciklit të shkrirjes, rafinimit dhe të prodhimit të telave e kabllove është kthyer pengesë në performancën e saj në tregjet rajonale e më tej, pasi kromi, i cili varet nga lidhjet e Bursës (Stock Exchange LME), ka fleksibilitet për të operuar falë skemave të ngritura, ndërkohë bakri nuk e ka këtë mundësi.
Burime të tjera minerare si nikel-silikate apo kuarcit, të cilat nuk përpunohen përtej produktit apo gjysmë

produktit, gjenden në të njëjtën situatë dhe janë në nivele të ulëta shfrytëzimi dhe tregtimi.
Bazuar në të dhënat, industria e lëkurë-këpucës, e cila ka kontribut të konsiderueshëm në punësim dhe eksporte, importon pothuajse 80% të lëndës së parë të lëkurës nga jashtë. Ndërkohë që Shqipëria eksporton lëndë të parë lëkure të papërpunuar, duke ulur vlerën e saj.
Sa më sipër, me qëllim promovimin e përpunimit të këtyre burimeve, parashikojmë vlerësime parafizibiliteti, studime teknike-ekonomike nga institucione të specializuara në fushën e kërkimit shkencor për sektorin publik ose privat të kuarcitit, nikel-silikateve dhe lëkurë-këpucëve.
Një sektor tjetër me interes për zhvillim është rritja e nivelit të riciklimit të mbetjeve (skrap) të metaleve, bakrit dhe aliazheve të tij, pasi në 20-25 vitet e fundit janë eksportuar të papërpunuara.
Në 2014 dhe 2015, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe AKBN kryen një studim teknik e ekonomik për industrinë e bakrit për të krahasuar procesin e punës me rritjen e nivelit të përpunimit deri në produktin final përfshirë tela bakri dhe kabllo. Aktualisht po punohet për përgatitjen e një oferte teknike e tregtare në këtë industri me qëllim promovimin e objekteve të lira.
Në koordinim me MZHETTS dhe AIDA, po punohet për realizimin e një studimi për industrinë e lëkurë-këpucëve, i cili pritet të përfundohet dhe të promovohet përgjatë 2017.
Në 2017 është parashikuar të ofrohet mbështetje financiare për realizimin e dy studimeve të tjera, përkatësisht për nikel-silikate dhe kuarcit, mundësisht me bashkëpunimin e institucioneve kërkimore shkencore. Në varësi të rezultateve që do të dalin nga studimet, do të koordinohet puna me AIDA për promovimin e sektorëve, me qëllim rritjen e mundësive për investim (2017 e më vonë).

2. *Raportim mbi zbatimin e politikave udhëzuese nga Maj 2016*

Reforma e tokës ka patur impakte pozitive pasi ka transferuar asete kritike tek familjet rurale. Në kuadër të prioriteteve të programit të qeverisë për finalizimin e reformës për privatizimin e tokës bujqësore, disa përmirësime dhe ndryshime ligjore janë ndërmarrë për të finalizuar procesin brenda Dhjetor 2017. Në funksion të saj, gjatë 2016 janë miratuar akte ligjore përkatëse dhe ka vijuar procesi për lëshimin e certifikatave të pronësisë në njësitë vendore.
Me mbështetjen e programit "Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore", po vazhdon puna për ngritjen e Sistemit të Informatizimit të Tokës, integrimi i GIS dhe ngritja e regjistrit dixhital të tokës për të gjitha njësitë administrative të vendit. Deri tani, janë dixhitalizuar 140,970 Ha tokë bujqësore në 128 njësi administrative. Programi financohet nga buxheti i shtetit në bazë vjetore dhe është pjesë e PBA-së. Implementimi ndiqet nga Qendra për Transferimin e Teknologjive në Fushë-Krujë.
Kredia italiane prej 5 milion EUR është dedikuar për Sistemin e Identifikimit të Parcelave të Tokës dhe ngritjen e Sistemit të Administrimit dhe Kontrollit të Integruar.

3. *Reformat dhe masat e propozuara*

Reforma #07: Konsolidimi dhe defragmentimi i tokës bujqësore

i. Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Konsolidimin e Tokës (2016).

Objektivi kryesor i strategjisë është krijimi i fermave familjare ekonomikisht të suksesshme, konkurruese, të qëndrueshme që do të arrihet përmes zhvillimit të kushteve për konsolidimin e tokës nëpërmjet një kuadri ligjor të përshtatshëm dhe implementimi i projekteve për konsolidimin e tokës, të cilët do të jenë pjesë e Programit Kombëtar për Konsolidimin e Tokës.

ii. Kuadri institucional për konsolidimin e tokës dhe gjetja e fondeve (2017-2018)
   - Përgatitja e planit vjetor të punës dhe sigurimi i stafit dhe financimit
   - Ngritja e sektorit për konsolidimin e tokës në MBZHRAU
   - Krijimi i kuadrit ligjor

Me qëllim arritjen e objektivave të kësaj strategjie, është parashikuar ngritja e sektorit për konsolidimin e tokës në MBZHRAU; krijimi i kuadrit ligjor, trajnimi dhe rritja e kapaciteteve, te cilat do të financohen nga MBZHRAU dhe Ministria e Financave. Fondet janë parashikuar në buxhetin e ministrisë.

iii. Zhvillimi i kapaciteteve (2018)

Elaborimi i programeve dhe materialeve të trajnimit bazuar në përvojat e mbledhura gjatë zbatimit të projekteve pilot për konsolidimin e tokës si parakusht për zbatimin e suksesshëm të një programi kombëtar për konsolidimin e tokës. Do të organizohen trajnime për stafin e njësive zbatuese në mënyrë që të jenë të aftë të trajtojnë çështje të konsolidimit të tokës. Programe trajnimi do të ketë gjithashtu për strukturat shtetërore të përfshira në zbatimin e strategjisë.

iv. Rritja e ndërgjegjësimit publik (2019)

MBZHRAU do të hartojë një program komunikimi me kanalet e medias për të informuar komunitetet rurale mbi Programet e Konsolidimit të Tokës. MBZHRAU do të përfshijë aktivitete komunikimi në planet e saj të punës.

v. Fillimi i planit të zbatimit të programit të Konsolidimit të Tokës (2019)

Dy projekte pilotë shtesë do të finalizohen pas miratimit të ligjit (hapat fillestare të projekteve do të ecin paralelisht më përgatitjen e ligjit). Objektivat e projekteve pilot do të jenë zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe procedurave për konsolidimin e tokës.

Kohëzgjatja

2017

- Ngritja e kuadrit institucional e ligjor të Konsolidimit të Tokës, paralel me aktivitete për sigurimin e fondeve të nevojshme.

2018

- Zhvillimi i kapaciteteve.

2019

- Rritja e ndërgjegjësimit publik;
- Fillimi i zbatimit të Programit të Konsolidimit të Tokës.

Regjistrimi dhe dixhitalizimi i tokës bujqësore do të zbatohet përgjatë periudhës afatmesme.

Kosto për aktivitet

85 milionë Lek për "Regjistrimin dhe digjitalizimin e tokës bujqësore" (2017, 2018, 2019)

Impakti në buxhet

Impakti në buxhet është 85,000,000 Lek për "Regjistrimin dhe dixhitalizimin e tokës bujqësore" (2017, 2018, 2019)

Impakti i pritshëm në konkurrueshmëri dhe rezultatet sociale

Nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm për arritjen e objektivave organizative dhe alokimin e sasisë së duhur të burimeve financiare që në fillim të zbatimit të këtij programi, synohet të arrihen:

- Ulja e nivelit të fragmentimit të parcelave bujqësore;
- Përmirësimi i kapaciteteve për menaxhimin dhe administrimin e tokës bujqësore;
- Rritja e përdorimit të tokës;
- Rritja e investimeve në bujqësi dhe zhvillimi i tregut formal të tokës;
- Rritja e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor;
- Rritja e PBB-së bujqësore për frymë;
- Përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale; Rritja e ndërgjegjësimit të pronarëve të tokave mbi të drejtat e tokës dhe pronës dhe ngritja e kapaciteteve për gjininë dhe çështje të gjinisë; Rritja e ndërgjegjësimit dhe ngritja e kapaciteteve të të gjithë aktorëve të përfshirë në çështje gjinore të lidhura me konsolidimin e tokës

Risqet e mundshme

Njësia e Konsolidimit të Tokës në MBZHRAU.
Mungesa e fondeve për ngritjen e kapaciteteve.
Mungesa e fondeve për rritjen e ndërgjegjësimit publik.
Mungesa e fondeve për implementimin e projekteve të konsolidimit të tokës.

Reforma #08: Standardizimi i industrisë së turizmit

Përmirësimi i cilësisë së produkteve dhe shërbimeve brenda industrisë së turizmit (strukturat akomoduese, guidat turistike, tur operatorët dhe agjencitë turistike); rritja e nivelit të kërkesës në rang kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar; promovimi i konkurrueshmërisë brenda industrisë; dhe ofrimi i informacionit të vlefshëm e të besueshëm mbi cilësinë e standardeve për turistët dhe industrinë e udhëtimeve.

Kohëzgjatja

2017

- Zbatimi i hapave për procesin e licencimit të agjencive turistike, klasifikimin e subjekteve akomoduese

dhe certifikimin e guidave turistike;
- Monitorim i përhershëm i zbatimit të standardeve dhe ndjekja e ankesave të konsumatorëve.

2018
- Zbatimi i hapave për procesin e licencimit të agjencive turistike, klasifikimin e subjekteve akomoduese dhe certifikimin e guidave turistike;
- Monitorim i përhershëm i zbatimit të standardeve dhe ndjekja e ankesave të konsumatorëve.

2019
- Zbatimi i hapave për procesin e licencimit të agjencive turistike, klasifikimin e subjekteve akomoduese dhe certifikimin e guidave turistike;
- Monitorim i përhershëm i zbatimit të standardeve dhe ndjekja e ankesave të konsumatorëve.

Kosto për aktivitet

Zbatimi i hapave për procesin e licencimit të agjencive turistike, klasifikimi
- 36,550,000 Lek (përfshirë kostot administrative) për 2017 - Zbatimi i hapave për procesin e licencimit të agjencive turistike, klasifikimin e strukturave akomoduese dhe certifikimin e guidave turistike; Monitorim i përhershëm i zbatimit të standardeve dhe ndjekja e ankesave të konsumatorëve.
- 26,550,000 Lek (përfshirë kostot administrative) për 2018 - Zbatimi i hapave për procesin e licencimit të agjencive turistike, klasifikimin e strukturave akomoduese dhe certifikimin e guidave turistike; Monitorim i përhershëm i zbatimit të standardeve dhe ndjekja e ankesave të konsumatorëve.
- 26,550,000 Lek (përfshirë kostot administrative) për 2019 - Zbatimi i hapave për procesin e licencimit të agjencive turistike, klasifikimin e strukturave akomoduese dhe certifikimin e guidave turistike; Monitorim i përhershëm i zbatimit të standardeve dhe ndjekja e ankesave të konsumatorëve.

Krijimi i Inspektoratit të Turizmit:
- 26,140,000 Lek – monitorimi i zbatimit të standardeve dhe gjurmimi/ndjekja e ankesave të konsumatorëve (2017);
- 27,300,000 Lek – monitorimi i zbatimit të standardeve dhe gjurmimi/ndjekja e ankesave të konsumatorëve (2018);
- 27,300,000 Lek – monitorimi i zbatimit të standardeve dhe gjurmimi/ndjekja e ankesave të konsumatorëve (2019).

Impakti në buxhet

Impakti total në buxhet për reformën është: 458,000 EUR (2017); 393,000 EUR (2018); 393,000 EUR (2019).

Impakti i pritshëm në konkurrueshmëri dhe rezultatet sociale

Reforma do të mundësojë ofrimin e rregullave të barabarta dhe të mirë përcaktuara për funksionimin e bizneseve në sektorin e turizmit. Do të kontribuojë në uljen e informalitetit, mundësimin e produkteve dhe shërbimeve me cilësi më të lartë në sektorin e turizmit; do të inkurajojë dhe promovojë konkurrueshmërinë në sektor, forcimin e kapaciteteve njerëzore si dhe forcimin e kapaciteteve për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave. Do të ketë impakt indirekt në ekonomi në periudhën afatgjatë pasi cilësia e aksesibilitetit, akomodimit, vendndodhja etj. idhen ngushtë me nivelin e kënaqësisë së turistëve, dëshirës së tyre për t'u rikthyer dhe vetvetiu zhvillimit të industrisë së turizmit në rajon.

Procesi i standardizimit pritet të ketë impakt direkt në rritjen e punësimit nëpërmjet krijimit të vendeve të reja të punës për realizimin e këtij procesi dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore në sektor.

Risqet e mundshme
- Mungesa e ndërgjegjësimit të bizneseve që operojnë në sektorin e turizmit mbi rëndësinë e procesit të standardizimit;
- Pamundësia financiare e bizneseve (kryesisht në zonat rurale) që operojnë në sektorin e akomodimit për të përmbushur kriteret minimale;
- Pamundësia financiare e bizneseve për të trajnuar stafin (kryesisht bizneset në zonat rurale);
- Pengesa administrative, etj.

Veprime për të lehtësuar/zbutur risqet e sipërpërmendura:
- Organizimi i takimeve konsultative për rritjen e ndërgjegjësimit të bizneseve mbi rëndësinë e procesit të

standardizimit;
- Mundësia e bashkëpunimit me institucionet financiare për ofrimin e huave me kushte preferenciale për bizneset që operojnë në sektorin e akomodimit;
- Organizimi i trajnimeve nga institucionet shtetërore;
- Hartimi dhe aplikimi i politikave fiskale lehtësuese në kuadër të trajnimit të stafit.

Reforma #09: Prezantimi i politikave strategjike në industrinë jo-ushqimore
Rritja e nivelit të dhe ofrimi i mbështetjes për përpunimin e disa burimeve natyrore si p.sh. krom, bakër, nikel-silikat dhe asete të tjera si lëkurë (për përpunim), si dhe riciklimi i mbetjeve, kryesisht mbetjet metalike (skrap), me qëllim përpunimin e plotë deri në produktin final.
- Përgatitja e një oferte teknike-tregtare për industrinë e bakrit dhe promovimi i saj në koordinim me AIDA dhe MZHETTS;
- Kryerja e studimeve për 3 industri të ndryshme: lëkurë-këpucë, nikel-silikat dhe kuarcit. Promovimi në koordinim mes AIDA dhe MZHETTS.

Kohëzgjatja
2017
- Përgatitja e një oferte teknike-tregtare për industrinë e bakrit dhe promovimi i saj në koordinim me AIDA dhe MZHETTS;
- Kryerja e studimeve për 3 industri, përkatësisht për industritë e lëkurë-këpucë, nikel-silikat dhe kuarcitit. Promovimi në koordinim mes AIDA dhe MZHETTS i studimit për industrinë e lëkurë-këpucëve.

2018
- Vazhdimi i promovimit të ofertave teknike-tregtare për industrinë e bakrit dhe lëkurë-këpucës, në koordinim me AIDA dhe MZHETTS;
- Përgatitja e plan – veprimit për promovimin e studimeve për industrinë e nikel-silikat dhe kuarciteve dhe ndjekja e procesit në koordinim me AIDA dhe MZHETTS

2019
- Në vartësi të pritshmërisë për shkallë interesimi të investitorëve, për fushat respektive të promovuara për industrinë e bakrit, industritë e lëkurë-këpucë, nikel-silikat dhe kuarcitit, të ndiqen procedurat e duhura ligjore deri në formalizimin e kontratave apo marrëveshjeve, sipas kritereve dhe lehtësirave që lejon legjislacioni vendas për investime të tilla.

Kosto për aktivitet
4 milionë Lek – Realizimi i 3 studimeve teknike-ekonomike dhe promovimi i tyre.

Impakti në buxhet
Impakti në buxhet është 15,000 EUR per vitin 2017; 7,500 EUR për vitin 2018, dhe 7,500 EUR për vitin 2019.

Impakti i pritshëm në konkurrueshmëri dhe rezultatet sociale
Procesi i nxitjes së interesit për rritjen e shkallës së përpunimit në vend të disa burimeve natyrore dhe aseteve të tjera nëpërmjet analizave tekniko-ekonomike dhe promovimit tek investitorët vendas e të huaj do të mundësojë maksimizimin e vlerës së impaktit në mënyrë të konsiderueshme për ekonominë e vendit.

4.3.4. Klima e biznesit dhe ulja e ekonomisë informale

1. *Gjendja aktuale dhe pengesat kryesore në konkurrueshmëri*

Në mbështetje të anëtarësimit në tregun e përbashkët të BE-së, Qeveria shqiptare duhet të përmirësojnë cilësinë e rregullave që ndikojnë në operacionet e përditshme të biznesit. Shqipëria ka treguar një përmirësim në raportin "Doing Business 2017" të Bankës Botërore, duke u renditur në vendin e 58-të nga 190 ekonomi, e cila tregon se reformat e fundit të ndërmarra nga Qeveria janë në rrugën e drejtë, veçanërisht sa i përket reduktimit të barrierave administrative për biznesin. Gjatë vitit 2015-2016, Shqipëria ka përmirësuar mjedisin e biznesit kryesisht në çështjet që kanë të bëjnë me lejet e ndërtimit, marrjen e energjisë elektrike dhe pagesën e taksave. Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të këtyre indikatorëve, fokusi në periudhën e ardhshme do të udhëhiqet në përmirësimin e regjistrimit të pronës dhe zbatimin e kontratave.
Aksesi i NVM-ve në kreditë bankare, pengohet nga asimetritë e mëdha të informacionit të dhënë mbështetur në

nivelin aktual të informalitetit, mungesën e kolateralit të NVM-ve dhe mungesa e strategjive dhe instrumenteve financiare nga ana e sistemit bankar. Sistemi përballet me fonde të kufizuara për institucionet e nënshkruara, çmimet e larta të kredisë, mbulimin e kufizuar rajonal në zonat rurale, etj. Aksesi i kufizuar në financa për NVM-të është domosdoshmërisht pengesë për rritjen dhe dëmton konkurrueshmërinë e NVM-ve për t'u integruar në tregjet rajonale dhe evropiane. Bankat në Shqipëri ndajnë rreth 59.9% të portofolit të tyre në biznese të mëdha, 18.3% për bizneset e mesme dhe vetëm 21.8% për bizneset e vogla, ndërsa bizneset e vogla përbëjnë 94.5% të të gjitha kompanive të themeluara. Sektori bankar përbën 90.8% të sektorit financiar dhe niveli i kredive të këqija në gusht 2016 ishte në nivelin 21.4%.

Teprica e kredive gjatë muajit gusht 2016 është rritur lehtë me 0.1% në terma vjetorë (ose 0.7 miliardë Lek), duke reflektuar zgjerimin e tepricës së kredisë në monedhën vendase, për individët dhe maturim afatshkurtër. Gjatë 12 muajve të fundit, sektori bankar ka shlyer rreth 17.9 miliardë Lek kredi të humbura, kryesisht për sektorin e biznesit dhe kredi në valutë. Duke korrigjuar normën e rritjes të kredisë me procesin e shpenzimeve, norma vjetore e rritjes do të qëndrojnë në 3.1%. Në drejtim të monedhës, teprica e kredisë në monedhën vendase u zgjerua nga 1.5 miliardë Lek (ose 0.6%) në 240.3 miliardë Lek për familjet rezidente. Ndërsa teprica e kredisë në valutë, e cila përbën rreth 60% të totalit të portofolit të kredisë, u rrit pak, me 0.2% ose rreth 0,7 miliardë Lek në 356,6 miliardë Lek. Kredia në valutë ka rënë në mënyrë të konsiderueshme nga një nivel prej 73% në fund të vitit 2008, në 60%, me pjesën e kredive të pashlyera pakësuar në një raport prej 26.4% të totalit të kredive. Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë është duke punuar në zhvillimin e një strategjie afatmesme për të mbështetur më tej tendencën në rënie të kredive në valutë. Kreditë ndaj jorezidentëve ishin kontribuesi kryesor në zgjerimin e tepricës së kredisë, duke u rritur me rreth 1.2 miliardë Lek ose 2.1%.

Informaliteti, pavarësisht nga veprimet e mëparshme, është ende një shqetësim i madh për rritjen ekonomike, konkurrencën dhe financat publike dhe ndikon negativisht në investime të reja në vend. Formalizimi i mëtejshëm i ekonomisë do të lejojë të ardhurat tatimore të rriten, duke stimuluar një rritje të shpenzimeve publike, sidomos në infrastrukturën dhe shërbimet që mbështesin zgjerimin e prodhimit, duke çuar në një rritje në normën e përgjithshme të rritjes ekonomike.

Një plan i veprimit për të luftuar informalitetin është miratuar nga Ministri i Financave me dokumentin Nr 10572 datë 8.04.2016. Ky plan përbëhet nga aktivitete që synojnë: i) konsolidimin e numrit të tatimpaguesve të regjistruar për të paguar TVSH, si dhe administrimin e TVSH-së; ii) Kontroll i vazhdueshëm i regjistrimeve / çregjistrimeve për të shmangur abuzimet; iii) Zbatimi i kontrollit zinxhir mbi transaksionet ndërmjet tatimpaguesve të mëdhenj dhe të vegjël, për rikategorizimin e subjekteve dhe mbledhjen e TVSH-së në linkun ku është krijuar; iv) Përmirësimi i administrimit të TVSH-së dhe zvogëlimi i numrit të bizneseve që nuk deklarojnë TVSH, me qëllim për të reduktuar numrin e tyre nën 5% të numrit të përgjithshëm të tatimpaguesve të detyruar të deklarojnë TVSH-në; v) Monitorimi i inventarëve; vi) Kontrolluar i vazhduar i përdorimit të pajisjeve fiskale; vii) Ulja e stokut të borxhit me 15 - 20% deri në fund të vitit 2016.

Zhvillimi i politikave për gratë sipërmarrëse mbetet një sfidë e vërtetë për qeverinë. Ato përfaqësojnë 27% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve aktive që operojnë në Shqipëri. Duke marrë parasysh pronësinë dhe llojin e aktiviteteve të këtyre bizneseve, përfaqësimi i tyre është ende i kufizuar dhe për këtë arsye kërkon vëmendje të veçantë nga qeveria. Përfshirja në aktivitetet e ndërmarrjes do të thotë më shumë liri ekonomike, pronësi, vendim-marrje dhe fuqizim të mëtejshëm të grave në Shqipëri. Përfshirja e grave në ekonomi është një element themelor i rritjes gjithëpërfshirëse. QSH miratoi në vitin 2014, me Urdhrin e Ministrit të Ekonomisë (Urdhër nr. 339, datë 19.6.2014) planin e veprimit për gratë sipërmarrëse 2014-2020. Ky plan veprimi, i hartuar në bashkëpunim me UN Women është i përbërë nga pesë shtylla: i) mbështetje e politikave, ii) arsimim dhe aftësim, iii) akses në financë dhe konkurrueshmëri, iv) akses në rrjete, v) pjesëmarrje e grave në ekonominë rurale.

2. Raportim mbi zbatimin e politikave udhëzuese nga Maj 2016

Barrierat rregullatore ndaj biznesit dhe aksesi në financë janë fushat me interes të madh në mënyrë që të ndikojnë në rritjen e qëndrueshme dhe konkurueshmëri. Si pasojë, ERP 2017 do të vazhdojë të adresojë aktivitetet pjesë e këtyre reformave, të cilat janë të lidhura me masat e tjera të reformës në këtë program.

Në raportin vlerësues të ERP 2016, mes konkluzioneve të tjera, theksohet rëndësia e thjeshtimit dhe eliminimit të barrierave të panevojshme rregullatore për biznesin si një përgjigje ndaj nevojës për rritjen dhe konkurueshmërisë si dhe vazhdimin e zbatimit efektiv të Planit Kombëtar për të reduktuar nivelin e kredive të këqija.

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), krijuar me ligjin nr. 131, datë 11/26/2015, është plotësisht funksionale duke filluar nga 1 prill 2016. Pas konsultimeve të njëpasnjëshme me grupin Ndërinstitucional të punës, procesi i reformës së autorizimeve, për shkak të disa ndryshimeve të legjislacionit sektorial, është parashikuar të zbatohet

në 2017. Këshilli i Investime gjatë periudhës raportuese ka mbajtur 5 mbledhje të fokusuara në përmirësimin e klimës së biznesit dhe nxitjen e qeverisjes së mirë, duke përfshirë analizat që lidhen me shqetësimet e biznesit në mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve alternative brenda Administratës Publike .
Masa shtesë për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe për të zvogëluar koston rregullatore dhe administrative për biznesin janë zbatuar gjatë vitit 2016. Në këtë mënyrë, plani i veprimit "Doing Business" (PL DB) 2016-2018 është miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM Nr 445, datë 15.06. 2016. Masat e reja të përcaktuara në PV kanë për qëllim të përmirësojnë treguesit e raportit "Doing Business" duke thjeshtuar procedurat, kohën dhe koston për operacionet e biznesit.
Sistemi e-ndërtimet dhe ndryshimet në regjimin e përpunimit për lejet e ndërtimit kanë ulur kohën e përpunimit në jo më shumë se 45 ditë. Përveç kësaj, numri i procedurave administrative është reduktuar me gjashtë procedura. Për këtë, koordinimi efikas dhe transparenca janë të garantuara në çdo fazë të përpunimit dhe për çdo aplikim. Sistemi lejon qasje automatike në të dhënat e gjendjes civile dhe regjistrat e QKB. Në të ardhmen, ky sistem do të jetë i lidhur për të marrë të dhëna nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP).
Gjatë vitit 2016 disa nga masat, pjesë e Planit të Veprimit për kreditë e këqija janë zbatuar. Këto masa përfshijnë: ndryshimet në "Kodin Civil", "Kodin e Procedurës Civile", amendimet në ligjin "Për falimentimin" dhe ndryshime në ligjin "Për barrët Siguruese".

3. *Reformat dhe masat e propozuara*

Reforma #10: Reduktimi i barrierave për biznesin

Pavarësisht progresit të kohëve të fundit dhe shumë reformave të vazhdueshme në këtë fushë, ulja e kostos rregullatore të biznesit, heqja e kërkesave të panevojshme procedurale, janë ende të nevojshme për të mundësuar investimin afatgjatë dhe për të përmirësuar zhvillimin e biznesit. Mjedis administrativ, transparenca e procedurave, si dhe korniza ligjore mbeten çështje të rëndësishme për të ulur barrierat rregullatore ndaj bizneset. Mbështetur në SZHBI 2014-2020, SKZHI dhe DB AP 2016-2018, kjo masë e parashikuar në ERP 2017 do të fokusohet në:

- Përmirësimin e procedurave të regjistrimit të biznesit dhe rishikimi i kornizës legjislative të licencimit / lejeve / autorizimeve.

Masat e propozuara do të implementohen paralelisht me reformat e tjera që ndikojnë në mjedisin e biznesit si: zhvillimi i politikave industriale, mbështetja e kërkimit dhe inovacionit, ulja e nivelit të NPL-ve dhe ngritja e kapaciteteve administrative. Prandaj, krijimi i instrumenteve të monitorimit do të lejojë kontrollin e ndryshimeve të reja legjislative.

Kohëzgjatja

2017

- Përmirësimi i procedurave të regjistrimit dhe licencimit/lejimit nëpërmjet QKB:
- Konsultimi me aktorët në lidhje me rekomandimet e raportit të autorizimeve;
- Rishikimi i kornizës ligjore për licencat dhe lejet e lëshuara nga QKB me qasjen për heqjen e kërkesave të panevojshme;
- Prezantimi i platformës elektronike për licencat e grupit të III, lejet dhe autorizimet, ku është e mundur;
- Trajnime për stafin e njësive vendore mbi sistemin e e-leje-ve;
- Prezantimi i një platforme për licencat e grupit III[14], lejet dhe autorizimet, ku është e mundur.

2018

- Miratimi i ndryshimeve ligjore për licencat dhe autorizimet e lëshuara nga QKB;
- Prezantimi i një platforme për licencat e grupit III, lejet dhe autorizimet, ku është e mundur.

2019

- Nuk janë parashikuar aktivitete për vitin 2019

Kosto për aktivitet

- Përmirësimi i procedurave të regjistrimit dhe licencimit/lejimit nëpërmjet QKB - EUR 50.000;
- Prezantimi i platformës elektronike për licencat e grupit të III, lejet dhe autorizimet, ku është e mundur - EUR 55,000;

[14] Licensat lëshohen nga ministritë e tjera të linjës

- Rishikimi i kornizës ligjore për licencat dhe lejet e lëshuara nga QKB me qasjen për heqjen e kërkesave të panevojshme - EUR 196,024.

Aktivitete e tjera në këtë masë janë kosto administrative të stafit.

Impakti në buxhet
Impakti total në buxhet është EUR 127,000 për 2017, EUR 77,000 për 2018.

Impakti i pritshëm në konkurrueshmëri dhe rezultatet sociale
Kjo reformë do të ketë ndikime pozitive në konkurrueshmëri duke ulur barrierat administrative të biznesit dhe duke u fokusuar në kufizimet detyruese për rritjen dhe konkurrueshmërisë. Kjo reformë do të përmirësojë renditjen e Shqipërisë në raportin "Doing Business", duke lehtësuar procedurat për operacionet e biznesit dhe duke zvogëluar kohën dhe koston e procedurave administrative. Përveç kësaj, reforma e-Leje do të thjeshtojë marrjen e lejes së ndërtimit, duke bërë që të rriten investimet në infrastrukturë. Kjo masë do të lejojë rritjen e konsiderueshme të investimeve, duke kontribuar në krijimin e vendeve të punës dhe konkurrencës.

Risqet e mundshme
Duke pasur parasysh se kjo është një reformë gjithëpërfshirëse e cila angazhon institucione të ndryshme politikëbërëse dhe palë të ndryshme të interesuara, nevoja e një bashkëpunimi më të ngushtë midis të gjitha palëve të përfshira, mund të konsiderohet si një proces i rëndësishëm dhe kompleks.

Reforma #11: Implementimi efektiv i planit kombëtar për reduktimin e nivelit të kredive të këqija në sistemin bankar
Plani i Veprimit për reduktimin e kredive të këqija në sistemin bankar është një grup masash (ndryshime legjislative dhe aktivitete të tjera zbatuese) të përbërë nga 12 masa, me qëllim për të ulur nivelin e kredive të këqija. Kjo reformë është pjesë e prioriteteve kombëtare për të përmirësuar qasjen në kredi për NVM-të.
Një hap i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të këtij plani veprimi konsiderohet krijimi i zyrës së kreditit, përgjegjës për të gjeneruar kreditë për konsumatorët që synojnë përmirësimin e normës së këtyre kredive në vend. Rezultatet paraprake sugjerojnë krijimin e një Byroje private nga bankat komerciale në bashkëpunim me kompani të tjera utilitare të interesuara. Aktualisht, këto rezultate janë duke u diskutuar me Bankën e Shqipërisë dhe bankat tregtare, si institucione të prekura nga ky projekt, si dhe mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të saj.
Gjatë vitit 2016, tetë nga këto masa janë zbatuar tashmë. ERP 2017-2019 do të fokusohet në veprimet që kanë të bëjnë kryesisht me: përmirësimin e Regjistrit të Kredive; kontrata mbi ristrukturimin e borxhit jashtë gjykatës; trajtimi i 35 grupeve/kompanive me borxh më të lartë; kreditimi në bazë të deklaratave tatimore.

Kohëzgjatja
2017
- Përmirësimi i Regjistrit të Kredive;
- kontrata mbi ristrukturimin e borxhit jashtë gjykatës;
- trajtimi i 35 grupeve/kompanive me borxh më të lartë.

2018
- kreditimi në bazë të deklaratave tatimore.

Kosto për aktivitet
Kredi për 2017

Impakti në buxhet
Nuk ka impakt në buxhet në lidhje me zbatimin e planit të veprimit për reduktimin e kredive të këqija në sistemin bankar.

Impakti i pritshëm në konkurrueshmëri dhe rezultatet sociale
Përmirësimi i regjistrit të kredive do të ndikojë në mënyrën se si bankat mund të vlerësojnë dhënien e kredive për të rritur cilësinë e informacionit, duke përmirësuar financimin bankar. Marrëveshja kuadër mbi ristrukturimin e borxhit jashtë gjykatës do të zvogëlojë barrierën administrative për huamarrësit dhe bankat, dhe përsëri do të ndikojë pozitivisht në konkurrueshmëri për financimin e NVM-ve. Trajtimi i 35 grupe / kompanive me nivel më të

lartë të borxhit, ka për qëllim zgjidhjen efektive të borxhit të kompanive me të gjitha mënyrat e parashikuara në ligj. Pritet që këto kompani të ristrukturojnë borxhin në përputhje me rrethanat, duke pasur një ndikim pozitiv në çlirimin e burimeve bankare dhe në kthimin e aktivitetit normal të tregut. Në të dy aspektet, konkurrenca në treg pritet të përfitojë nga prania e lojtarëve të tregut. Dhënia e kredive në bazë të deklaratave tatimore ka një ndikim të drejtpërdrejtë mbi konkurrueshmërinë, duke përmirësuar transparencën dhe cilësinë e informacionit. Në lidhje me impaktin social, prania e aktorëve më efikas në treg, përmirësimet në konkurrencë dhe qasja më e mirë në financat bankare, pritet të ketë implikime pozitive për investimet private dhe punësimin. Më shumë konkurrencë në treg pritet të rritsë diversitetin e investimeve dhe nevojën për një fuqi punëtore më të larmishme. Pritet që kjo të adresojë në mënyrë pozitive sigurimin në shkallë më të lartë të punësimit për të rinjtë dhe për gratë, me nivel të ndryshëm në arsim.

Risqet e mundshme
Nuk parashikohen pengesa në implementim.

4.3.5. Kërkim dhe inovacion

1. *Gjendja aktuale dhe pengesat kryesore në konkurrueshmëri*

Në kuadër të kërkimit shkencor në Shqipëri, ka dy institucione kryesore të parashikuara nga ligji për arsimin e lartë, të cilat janë Agjencia Kombëtare për Financim e Arsimit të Lartë dhe Agjencia Kombëtare për Kërkimet Shkencore dhe Inovacionin.
Agjencia Kombëtare për Kërkimet Shkencore dhe Inovacionin (AKKSHI) është e ngarkuar nga ligji i ri për arsimin e lartë me shpërndarjen e fondeve për programet e kërkimit shkencor në bazë të projekteve të paraqitura nga institucionet e arsimit të lartë. Ajo identifikon fushat kryesore të kërkimit shkencor, zhvillimit e inovacionit dhe vlerësimeve në nivel kombëtar të programeve kombëtare në fushat e lartpërmendura. Për më tepër, AKKSHI është përgjegjëse për shpërndarjen e informacionit dhe për koordinimin teknik të aplikimeve në programet evropiane dhe ndërkombëtare, duke përfshirë edhe programin e BE-së, Horizon 2020. Në këtë kuadër, forcimi i kapaciteteve të Agjencisë është i një rëndësie vendimtare për një zhvillim të fortë të kërkimit shkencor në vend.
Bazuar në ligjin e ri për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, Agjencia Kombëtare për Financimin e Arsimit të Lartë është përgjegjëse për shpërndarjen e fondeve publike që lidhen me mbështetjen e aktiviteteve të zhvilluara nga institucionet e arsimit të lartë, duke përfshirë edhe aktivitetet kërkimore shkencore.
Shpenzimet dhe investimet për kërkime në Shqipëri kanë qenë shumë të ulëta. Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin (SKSHTI) 2009-2015, parashikoi trefishimin e investimeve për kërkime shkencore ndaj PBB nga 0.2% në 0.6% gjatë periudhës 2009 - 2015. (Strategjia Kombëtare për Shkencën dhe Kërkimin Shkencor 2009-2015.[15]
Përqindja e PBB-së shpenzuar për kërkime shkencore arriti në 0.4% në vitin 2015 dhe 0.35% në vitin 2016. (Ministria e Arsimit dhe Sportit, Raport Monitorimi Janar-Dhjetor 2016)[16]
Ky prioritet është në përputhje me sfidat e parashikuara nga ligji aktual për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, Strategjinë aktuale për Kërkime Shkencore dhe Inovacionin 2009-2015.

2. *Raportim mbi zbatimin e politikave udhëzuese nga Maj 2016*

Ligji Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë", është miratuar në Shtator 2015. Urdhri Nr. 403, datë 2015/10/26 "Për ngritjen e grupit të punës për koordinimin e procesit të hartimit dhe përgatitjes së akteve nënligjore që zbatojnë ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë", është miratuar me qëllim që të koordinojë punën për mundësimin e hartimit të akteve nënligjore që do të bëjnë të mundur zbatimin e ligjit të arsimit të lartë. Ky proces pritet të përfundojë në Qershor të vitit 2016.
Në ERP 2017-2019, në fushën V. Përthithja e teknologjive dhe inovacion/kërkimi dhe inovacioni, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka propozuar reformën strukturore në vijim, përbërë nga masat si më poshtë:
Reforma strukturore: Rritja e kapaciteteve institucionale për kërkim dhe inovacion
Masa: Hartimi dhe miratimi i akteve të nevojshme zbatuese ligjore për ngritjen e Agjencisë Kombëtare për Financimin e Arsimit të Lartë.
Masa: Forcimi i kapaciteteve për Agjencinë për Kërkime Shkencore
Masa: Forcimi i kapaciteteve për Agjencinë Kombëtare për Financimin e Arsimit të Lartë

[15] http://www.akti.gov.al/dokumenta/strategjia_2009_2015.pdf
[16] http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/buxheti/2016/perditesime/Raporti_i_Monitorimit_12-mujori_Janar-

Aktualisht Agjencia Kombëtare për Kërkimet Shkencore dhe Inovacionin është krijuar me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.607, datë 31.08.2016 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare për Kërkimet Shkencore dhe Inovacionin (AKKSHI). Bazuar në ligjin e ri për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, Agjencia Kombëtare për Financimin e Arsimit të Lartë është përgjegjës për shpërndarjen e fondeve publike që lidhen me mbështetjen e aktiviteteve të zhvilluara nga institucionet e arsimit të lartë, duke përfshirë edhe aktivitetet kërkimore shkencore.
Për këtë janë përcaktuar masat e mëposhtme.

- Krijimi i Agjencisë Kombëtare për Financim në Arsimin e Lartë;
- Forcimi i kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare për Kërkimet Shkencore dhe Inovacionin;
- Forcimi i kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare për Financimin nArsimin e Lartë

Pas themelimit të institucioneve të parashikuara në ligjin e ri për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në arsimin e lartë krijimi i institucioneve të mbetura, duke përfshirë Agjencinë për Financimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, mes të tjerash do të adresojë këtë rekomandim.

3. *Reformat dhe masat e propozuara*

Reforma #12: Mbështetje për zhvillimin e politikave te inovacionit

Qeveria e Shqipërisë ka hartuar Planin e Veprimimit "Mbështetje për Zhvillimin e Politikave Inovative bazuar në modelin "Triple Helix, në zbatim të rekomandimeve te programit të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) për Europën Jug-Lindore, i cili synon të mbështesë në mënyrë progresive inovacionin dhe hulumtimin, duke çuar në krijimin e një sistemi efektiv kombëtar të inovacionit në Shqipëri. Për zbatimin e kësaj reforme është i nevojshëm miratimi i të dyjave, ndërhyrjet rregullatore/ ligjore dhe veprime të tjera mbështetëse.
Veç kësaj, një fokus i rëndësishëm i është vënë mbështetjes së një qasje të integruar si një temë ndër-sektoriale: Kjo fillon në nivel qeverisje dhe nivel politik duke adresuar çështjet si strukturat e integruara të koordinimit dhe udhërrëfyesit gjithëpërfshirës. Ajo lidhet edhe me strukturat dhe shërbimet e mbështetjes së inovacionit duke parë mundësinë për integrimin e llojeve të ndryshme të ofertave (p.sh. pajisjet, financimi, shërbimet teknike dhe këshillimore) dhe përmirësimin e bashkëpunimit midis ofruesve të shërbimeve. Qasja e integruar i referohet gjithashtu kombinimit të marketingu-t dhe zhvillimit të produktit në nivelin e sistemit të mbështetjes së inovacionit. Meqenëse sipërmarrësit duhet të balancojnë marketing-un dhe zhvillimin e produktit, e njëjta gjë vlen edhe për sistemin e mbështetjes së inovacionit. Masat që përmirësojnë infrastrukturën mbështetëse dhe portofolin e shërbimeve kombinohen me veprimtaritë që promovojnë përfitimet që rrjedhin nga inovacioni dhe nga mbështetja në dispozicion.
Veprimet e mëposhtme brenda kësaj mase të reformës do të kenë në fokus:

- Miratimin dhe zbatimin e disa aktiviteteve pjesë e planit të veprimit "Kuadri ligjor per Inovacionin 2017-2021", në përputhje me rekomandimet e OECD-së në Maj 2015, në kuadër të "Triple Helix";
- Rritja e aftësive inovative për NVM-të, duke përdorur ICT, zbatimin e projektit "Inovacioni HUB", duke krijuar një inkubator për iniciativat e Start-up-ve ne ICT, duke ofruar një sërë shërbimesh biznesi nga këshillimi te rrjetet dhe mundësitë e partneritetit;
- Monitorimi i përhershëm i ndikimit të Strategjisë të Agjendës digjitale.

Kohëzgjatja

2017

- Miratimin dhe zbatimin e disa aktiviteteve pjesë e planit të veprimit "Kuadri ligjor per Inovacionin 2017-2021", në përputhje me rekomandimet e OECD-së në Maj 2015, në kuadër të "Triple Helix";
- Institucionalizimi i strukturave monitoruese dhe instrumentet, per të rritur aftësitë inovative për NVM-të, duke përdorur ICT, Implementimi i projektit "Inovacioni HUB", duke krijuar një inkubator për iniciativat e Start-up-ve ne ICT, duke ofruar një sërë shërbimesh biznesi nga këshillimi te rrjetet dhe mundësitë e partneritetit, monitorim i përhershem i ndikimit të strategjisë.

2018

- Krijimi i nje portali online per infrastrukturen mbeshtetese te inovacionit dhe sherbimeve ne Shqiperi-bazuar ne nje harte te plote-qe ndihmon sipermarresit dhe NVM-te ne identifikimin dhe aksesin ne mundesite perkatese (pjesë e Planit të Veprimimit "Mbështetje për Zhvillimin e Politikave Inovative bazuar në modelin "Triple Helix");
- Rritja e aftësive inovative për NVM-të, duke përdorur ICT, zbatimin e projektit "Inovacioni HUB", duke krijuar një inkubator për iniciativat e Start-up-ve ne ICT, duke ofruar një sërë shërbimesh biznesi nga këshillimi te rrjetet dhe mundësitë e partneritetit. Krijimi i Partneritetit me investitoret potenciale, sidomos

agjencitë ndërkombëtare ne mbështetjen e zhvillimit të vendit, me kompanitë multinacionale, fondet e kapitaleve, investimeve dhe zhvillimit të bankave, monitorimin e përhershëm të ndikimit të Strategjisë së Agjenda digjitale.

2019

- Hartimi dhe zbatimi i një programi që specifikon llojin e kapaciteteve të nevojshme (duke u fokusuar tek AIDA, AKKSHI, etj.) dhe mënyrën sesi ato mund të zhvillohen për të zbatuar një qasje të integruar (pjesë e Planit të Veprimimit "Mbështetje për Zhvillimin e Politikave Inovative bazuar në modelin "Triple Helix").

Kosto për aktivitet

- Ne periudhen 2017-2021 nje volum financimi afersisht prej rreth 2.8–3.4 milion EUR (afërsisht 1.2 – 1.5 milion EUR për periudhën 2017–2019 dhe 1.6–1.9 milion EUR për periudhën (2020 – 2021) per te zbatuar Planin e Veprimimit "Mbështetje për Zhvillimin e Politikave Inovative bazuar në modelin "Triple Helix).
- 5,000 EUR ndërmarrja e nje konsultimi efektiv paraprak me sektorin privat dhe akademine në kuadrin e politikave ligjore,
- 170,000 EUR për të rritur aftësitë inovative të NVM-ve, duke përdorur ICT
- Aktivitetet e tjera të propozuara në këtë masë janë kosto administrative e personelit.

Impakti në buxhet

Nuk ka impakt ne buxhet per kete reforme.

Impakti i pritshëm në konkurrueshmëri dhe rezultatet sociale

Masa e propozuar e Reformës do të përhapë zbatimin e ideve të reja, duke nxitur projekte më konkurruese çdo vit. Kjo do të kontribuojë në rritjen e konkurrueshmërisë së NVM-ve dhe gatishmërinë e tyre për të përdorur TIK-un. Pritet një rritje e numrit të bizneseve që përdorin TIK-un dhe 10% e bizneseve në TIK për shkak të agjendës digjitale.

Ndikimi i pritur nga Agjenda Digjitale do të rezultojë me rritjen e nivelit të aftësive dhe ekspertizës për sipërmarrësit /ekipet me forcë lëvizëse që përfaqësojnë një grup të gjerë të ndërmarrjeve, programet e investimeve në inovacion dhe TIK do të kontribuojnë në rritjen e konkurrencës dhe në vijim të punësimit dhe rritjes ekonomike.

Risqet e mundshme

Duke pasur parasysh se kjo është një reformë gjithëpërfshirëse e cila angazhon institucione të ndryshme politikëbërëse dhe palët e ndryshme të interesuara, nevoja e një bashkëpunimi më të ngushtë midis të gjitha palëve të përfshira, mund të konsiderohet si një proces i rëndësishëm dhe kompleks.

Reforma #13: Përmirësimi i kapaciteteve institucionale për kërkim shkencor dhe inovacion

Masë: Krijimi i Agjencisë Kombëtare për Financimin e Arsimit të Lartë.
Masë: Fuqizimi i kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare për Kërkim Shkencor dhe Inovacion.
Masë: Fuqizimi i kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare për Financimin e Arsimit të Lartë.

Kohëzgjatja

2017

- Krijimi i Agjencisë Kombëtare për Financimin e Arsimit të Lartë;
- Fuqizimi i kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor;
- Fuqizimi i kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare për Financimin e Arsimit të Lartë.

2018

- Fuqizimi i kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor;
- Fuqizimi i kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare për Financimin e Arsimit të Lartë.

2019

- Fuqizimi i kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor;
- Fuqizimi i kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare për Financimin e Arsimit të Lartë.

Impakti në buxhet
Impakti total në buxhet është 2500 EUR për vitin 2017, 2500 EUR për vitin 2018 dhe 2000 EUR për vitin 2019.

Impakti i pritshëm në konkurrueshmëri dhe rezultatet sociale
Në Shqipëri, rritja e financimeve për kërkime dhe garantimi i vazhdueshmërisë së tyre në kohë mbetet një sfidë e madhe. Paralelisht, qeverisja e institucioneve kërkimore duhet të përmirësohet në përputhje me qëllimin e përsosmërisë së kërkimit. Qeverisja e mirë në financimin e kërkimit nënkupton meritokracinë dhe transparencën në financimin e granteve, si dhe praktikat e llogaridhënies, vlerësimit dhe monitorimit, transparencës, dhe vlerësimit të performancës që mund të matin kontributin në njohuri, nevoja ekonomike lokale dhe sociale, dhe në rritjen ekonomike. Qeverisja e mirë gjithashtu përfshin të paturit e një arsyetimi të qartë pas financimeve institucionale, që sigurojnë stabilitet dhe financim të bazuar në projekte. Përpjekje të mëtejshme të qëndrueshme janë të nevojshme në nivel kombëtar për të forcuar kapacitetet kërkimore dhe të inovacionit dhe për të rritur aftësinë konkurruese të Shqipërisë. Në këtë kuadër, Agjencia Kombëtare për Financimin e Arsimit të Lartë dhe Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin përfaqësojnë dy institucione të rëndësishme në sistemin qeverisës të kërkimit shkencor në Shqipëri. Fuqizimi i kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare për Kërkim Shkencor dhe Inovacion do t'i mundësonte Shqipërisë të përfitonte më shumë nga projektet e BE-së dhe do të rriste fondet për kërkimin shkencor. Nga ana tjetër, krijimi dhe mirëfunksionimi i Agjencisë Kombëtare për Financimin e Arsimit të Lartë do të mundësonte shpërndarjen e granteve kërkimore në institucionet e arsimit të lartë. Kjo nga ana tjetër do të ndikojë pozitivisht në aftësitë e tyre për të kryer kërkime shkencore dhe për të marrë pjesë në iniciativa që kanë lidhje me kërkimin. Krijimi i këtyre dy agjencive do të ndikojë, në terma afatmesëm dhe afatgjatë, pozitivisht në kërkimin shkencor dhe zhvillimin e inovacionit në vend. Duke bërë kështu, kjo do të ndikojë pozitivisht në konkurrueshmëri dhe në rritje.

Risqet e mundshme
Pengesat në zbatimin e masave të mësipërme në fushën e kërkimit dhe zhvillimit përfshijnë: vështirësi në koordinimin ndër-institucional. Megjithatë, krijimi i të gjitha institucioneve të lidhura me ligjin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor me anë të akteve nënligjore brenda tre mujorit të parë 2017.
Ngritja e institucioneve, nga njëra anë, në përputhje me ligjin e ri për arsimin e lartë dhe krijimi i një strategjie të re, nga ana tjetër, do të kontribuojnë në kapërcimin e disa pengesave në këtë fushë.

4.3.6. Tregtia e jashtme dhe lehtësimi i investimeve

1. *Gjendja aktuale dhe pengesat kryesore në konkurrueshmëri*

Gjatë vitit të kaluar, regjimi tregtar shqiptar e ruajti nivelin e tij të hapjes dhe transparencës. Hapja tregtare për vitin 2015, si pjesë e PBB-së, arriti në 58%, ndërsa koeficienti i mbulimit eksport / import tregoi një rënie të lehtë. Këmbimi tregtar shqiptar tregoi dobësi të lehtë gjatë vitit 2015 duke pësuar një ulje të eksportit në (4.9%) dhe pothuajse asnjë ndryshim në import. Kjo ndodhi kryesisht për shkak të zvogëlimit të eksportit të Shqipërisë në BE, një partner tregtar që përfaqëson 75% të eksportit të përgjithshëm dhe 61% të importit të përgjithshëm, në vlerën 7.5%. Vlen për t'u theksuar se tregtia me vendet e CEFTA-s u rrit në vitin 2015, me 3.1%. Eksporti tregoi një rritje të qëndrueshme me 16.5%, ndërsa importi pësoi një ulje me 5.6%. Këto shifra konfirmuan rëndësinë që vendet anëtare të CEFTA-s kanë për tregtinë shqiptare dhe potencialet për ndryshim në tregun e eksportit.
Ekzistenca e barrierave jotarifore mbetet një shqetësim që i është adresuar qeverisë shqiptare dhe shumë instrumente për lehtësimin e tregtisë janë vënë tashmë në vendin e duhur. Kështu vihet re një përmirësim i ndjeshëm i Shqipërisë në Doing Business 2017 (d.m.th. 32 vende përmirësuar), në Raportin Botëror Ekonomik (dmth 13 vende përmirësuar) dhe në raportet e tjera ndërkombëtare duke cilësuar përpjekjet në këtë drejtim. Megjithatë, Shqipëria mbetet pjesërisht e integruar në zinxhirin e vlerave rajonale, vuan nga lidhja e kufizuar me rajonin dhe më gjerë, dhe nevoja për të përmirësuar cilësinë e infrastrukturës, mbetet e lartë. Bashkëpunimi ndërinstitucional është i dobët, shkëmbimi elektronik i të dhënave në nivel kombëtar ende nuk ka përfunduar dhe duhet të përfshihen procedurat automatike të verifikimit. Veçanërisht Operatorët e Autorizuar Ekonomik (OAE) dhe verifikimi lokal, mbeten problemet që ndikojnë në thjeshtimin e procedurave, megjithëse niveli i njohurive dhe vetëdijes nga sektori privat është disi i ulët. Përfitimet nga këto procedura duhet të vijojnë më tej, në takimet Biznes-me-biznes (B2B). Kapacitetet e kufizuara administrative për të trajtuar me efikasitet të gjitha aspektet e politikave tregtare, pengojnë zgjidhjen e pengesave, në rritjen e forcimin e konkurrencës dhe në rritjen e produktivitetit të prodhimit vendas. Mungesa e zbatimit efektiv në menaxhimin e riskut në të gjitha agjencitë kufitare, me përjashtim të doganave, përbën një pengesë për lehtësimin e tregtisë.
Një nevojë e fortë për të tërhequr IHD është e domosdoshme për të fuqizuar rritjen ekonomike dhe përmirësuar

konkurrueshmërinë. Mungesa e një fuqie punëtore të kualifikuar, informaliteti i lartë i ekonomisë, monitorimi i dobët i mbrojtjes së të drejtës intelektuale etj. E shoqëruar me domosdoshmërinë për të patur një administratë publike të aftë dhe të përgjegjshme mbetet një nga shqetësimet kryesore të lidhura me investime e huaja. Vlera e IHD-ve në 2015 ishte 890 milion EUR ose 2.4% më shumë se në 2014 (869 milion EUR). Për 6-mujorin e parë të 2016 kjo shifër arriti në 418 milion EUR me një rënie prej 11.6 % krahasuar me të njëjtën periudhë të 2015 (473 milion EUR).
Prapëseprapë, parashikueshmëria e regjimit të investimeve ka nevojë të përmirësohet. Regjimi aktual i investimeve është i rregulluar prej mjaft ligjesh, kuadro ligjore dhe ligjesh sektoriale, të cilët nevojitet të krijojnë një unifikim të regjimit aktual rregullator për të tërhequr më tepër investime. Ofrimi i një kuadri të përshtatshëm ligjor dhe rregullator për sektorin përmes përmirësimit dhe modernizimit të kuadrit ligjor për investimet në linjë me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe nxitjen dhe promovimin e zhvillimit dhe aplikimin e standardeve e praktikave të mira ndërkombëtare.

2. Raportim mbi zbatimin e politikave udhëzuese nga Maj 2016

Vlerësimi i KE mbi ERP 2016-2018 tregoi nevojën për një qasje ndër-horizontale në bashkëpunim me agjencitë kufitare për të siguruar kështu një bashkëpunim më të mirë. Përveç kësaj, në përgjigje të nevojës për të patur një qasje gjithëpërfshirëse për lehtësimin e tregtisë në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në përputhje me vizionin politik të përcaktuar në Procesin e Berlinit, gjatë vitit 2016, janë ndërmarrë shumë aktivitete. Këto aktivitete janë pjesë e përgatitjes për zbatimin e plotë të detyrimeve nga OBT / TFA, Protokollit 5shtesë (AP 5) të CEFTA-s dhe nevojave kombëtare nga sektori privat. Tabela 12 jep detaje të aktiviteteve të ndërmarra gjatë vitit 2016, siç parashikohet në ERP 2016-2018 në masën e reformave për lehtësimin e tregtisë.
Rishikimi i dytë i politikave shqiptare tregtare në OBT, mbajtur në maj 2016, rikonfirmon trendin pozitiv shqiptar të ndërmarr në kuadër të këtyre politikave. Pranimi i OBT-TFA, Marrëveshjes së re të Lehtësimit të Tregtisë, është finalizuar dhe instrumenti i pranimit është depozituar tek Drejtori i Përgjithshëm OBT, më 10 maj 2016. Në përgjigje të angazhimit të OBT-TFA dhe pas paraqitjes së pranimit të mësipërm, vihet në funksion Komiteti Kombëtar për Koordinimin dhe Lehtësimin e Politikave Tregtare (NCTPF). Tashmë janë miratuar, rregullat e procedurës dhe Plani Kombëtar i Veprimit (NAP) 2017-2020. Plani i veprimit përfshin rekomandimet nga raportet e përgatitura gjatë vitit 2016 me mbështetjen e GIZ, UNCTAD dhe UNECE dhe diskutimeve të hapura të ngritura në kuadër të strukturave të CEFTA-s që merren me masat jotarifore dhe lehtësimin e tregtisë. Për t'i ardhur në ndihmë akoma më mirë nevojave të eksportuesit, është themeluar një qasje e re konsultimi. Janë zhvilluar një sërë takimesh të dedikuara me eksportues dhe do të vijohet me hapa të tjerë si takime sektoriale të përkushtuara. Rekomandimet të cilat kërkojnë ndryshim në legjislacion apo politikë, duhet të dakordësohen me Komitetin Kombëtar për Lehtësimin e Tregtisë (NCTPF).
Në lidhje me zbatimin e ligjit për investimeve strategjike, ligjit për zonave e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik dhe ligjit për PPP-të, gjatë 2016 janë ndërmarrë një sërë masash brenda kësaj reforme, të tilla si: miratimi i një udhërrëfyesi specifik dhe manuali të thjeshtëzuar mbi zbatimin e paketës ligjore për investimet strategjike, adoptimi i rregullave të procedurave të Komitetit të Investimeve Strategjike, etj. Tabela 12 jep hollësi rreth aktiviteteve të ndërmarra përgjatë 2016, sikurse ishte paraqitur në ERP 2016-2018 në masat e reformës së lehtësimit të investimeve.

3. Reformat dhe masat e propozuara

Shqipëria vazhdon të ketë një fokus të balancuar në lehtësimin e tregtisë dhe përmirësimin e kushteve për investime të huaja, si fusha me interes të madh për rritjen dhe konkurrueshmërinë. Kështu, ERP 2017-2019 do të fokusohet në agjendën kombëtare dhe rajonale për lehtësimin e tregtisë dhe tërheqjen e rritjen e nivelit të investimeve në vend. Masat e reformave të propozuara në këtë fushë do të plotësohen me masa të tjera prioritare në klimën e biznesit, arsimit, Kërkimit & zhvillimit dhe inovacionit, masat sektoriale të reformave, në veçanti transportit dhe energjisë, etj.

Reforma #14: Lehtësimi i tregtisë nëpërmjet zbatimit efektiv të Planit Kombëtar 2017-2020

Lehtësimi i tregtisë është përgjigjja për të adresuar më mirë pengesat në tregti dhe për të reduktuar kohën dhe kostot e importit dhe eksportit. Bashkëpunimi i agjencive të kufirit është parakusht për zbatimin e suksesshëm të agjendës për lehtësimin e tregtisë dhe nevoja për të qenë të lidhur në mënyrë elektronike në nivel kombëtar dhe rajonal është e lartë.
Reforma e propozuar është pjesë e agjendës kombëtare të lehtësimit të tregtisë, prezantimin e aktiviteteve në nivel kombëtar, rajonal dhe shumëpalësh. Ajo ka për qëllim ndër të tjera për të arritur përmirësime legjislative,

forcimin e kapaciteteve institucionale dhe rregullatore, me qëllim për të lehtësuar tregtinë përtej kufijve dhe distancën ekonomike për tregjet. Këto përpjekje do t'i kushtohen forcimit të kapaciteteve administrative të NCTPC, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Agjencisë për Barnat dhe Pajisje Mjekësore, Inspektoratit Teknik Shtetëror, etj.

Inspektorati e Mbikëqyrjes së Tregut është në fazën finale për të funksionuar dhe lidhja me këto institucione, pasi të jetë plotësisht funksional, do të konsiderohet edhe në kuadër të aktiviteteve për përmbushjen e kësaj reforme.

Protokolli i 5 shtesë i CEFTA-s do të miratohet nga të gjitha vendet e rajonit në shkurt të vitit 2017 duke vendosur bazën e duhur për axhendën rajonale të lehtësimit të tregtisë. Përveç kësaj, zbatimi i Marrëveshjes së OBT-TFA ka vëmendjen e duhur përmes masave konkrete të paraqitura në Planin Kombëtar të Veprimit 2017-2020.

Reforma e propozuar është pjesë e prioriteteve të programit të Qeverisë, pjesë integrale e aktiviteteve nën Procesin e Berlinit, një vazhdim i reformave të Programit të Reformave Ekonomike 2016-2018 me bazë tregtinë e jashtme dhe lehtësimin e investimeve, si dhe pjesë e shumë dokumenteve strategjike, në nivel kombëtar dhe rajonal. ERP 2017-2019 do të fokusohet në:

- Forcimin e kapaciteteve të Komitetit Kombëtar për Koordinimin dhe Lehtësimin e Politikave Tregtare (NTPCF) për implemenimin e agjendës të lehtësimit të tregtisë. Mbështetur nga donatorët dhe në bashkëpunim me anëtar nga sektori privat i NTPCF, disa ekspert do t'i bashkohen Sekretariatit teknik të Komitetit për të kryer aktivitete specifike për zbatimin e PKV. Do të prezantohen mjetet e monitorimit për implementimin e Planit Kombëtar të Veprimit, duke përfshirë ku është e mundur treguesit kyç të performancës (treguesit e rezultateve), si pjesë e Programit Kombëtar të Veprimit 2017-2020. Treguesit kryesorë të performancës do të lejojnë kështu Sekretariatin Teknik të vlerësojë efektivitetin e agjendës së reformave dhe të propozojë masa korrigjuese nëse e sheh të përshtatshme.
- Zbatimi efektiv i Memorandumit të Mirëkuptimit (MoU) midis agjencive kufitare të përfshira në procedurat e importit dhe eksportit nëpërmjet institucionalizimit të rrjetit të personave të kontaktit në çdo agjenci, sikurse parashikohet nga MoU. Ky rrjet do të vlerësojë nevojat e bashkëpunimit dhe do të raportoj tek Komiteti. Përveç kësaj, kapacitetet për të shkëmbyer të dhëna elektronike ndërmjet agjencive të kufirit dhe thjeshtimi i procedurave të pastrimit të kufirit do të vlerësohen gjithashtu nga rrjeti.
- Lehtësimi i dokumentacionit sanitar dhe kërkesat fitosanitare, në veçanti përmes standardizimit të formateve të përdorura në Shqipëri me formatin përkatës që përdoret në BE. Në këtë drejtim, është dedikuar një grup teknik pune me pjesëmarrës nga sektori privat, që do të vlerësojë thjeshtimin e dokumentacionit të mundshëm dhe standardizimin.
- Ndryshimin e VKM në zbatim të dispozitave të Kodit Doganor, me qëllim që të jetë në përputhje të plotë me *Acquis* të BE-së për OEA[17]; rregullorja aktuale e BE-së për Operatorët Ekonomik të Autorizuar do të transpozohet në legjislacionin kombëtar me qëllim për të arritur pajtueshmëri të plotë në këtë drejtim. Ky aktivitet do të lejojë zbatimin efektiv të dispozitave përkatëse të AP 5.
- Nxjerrja e udhëzimit të Ministrit të Financave mbi zbatimin e programit për OEA. Udhëzimi ka për qëllim të japë instruksione të plota në doganë për të siguruar zbatim të njëtrajtshëm dhe efektiv të dispozitave.
- Promovimi i konceptit të Operatorëve Ekonomik të Autorizuar koncept me sektorin privat nëpërmjet një seri e takimeve B2B. Një seri e takimeve dhe punëtorive është planifikuar nga administrata doganore gjatë 2017.

Ashtu sikurse u prezantua edhe në ERP 2015, agjenda për lehtësimin e tregtisë është shumë e varur nga proceset rajonale dhe suksesi mund të arrihet vetëm nëse ka një konvergjencë midis prioriteteve kombëtare dhe veprimeve rajonale.

Për këtë arsye, nevojitet një konsultim i përhershëm dhe bashkëpunim në kuadër të strukturave të CEFTA-s dhe nismave të tjera rajonale. Agjenda rajonale për lehtësimin e tregtisë do të plotësojë kështu agjendën kombëtare. Do të jepet asistencë teknike dhe financiare për të mbështetur agjendën rajonale të lehtësimit të tregtisë në fushën e shkëmbimit të të dhënave rajonale përmes Mirëmbajtja e SEED gjatë vitit 2017 dhe gjatë vitit 2018.

Lehtësimi i tregtisë është i lidhur me masat e tjera të reformave të propozuara për vitin 2017, në mënyrë të veçantë me masa që kanë të bëjnë me reformën e konektivitetit duke përfshirë fushën sektoriale (p.sh. të transportit dhe të energjisë). Sfida është që reformat e konektivitetit, infrastrukturës e transportit dhe progresit të

[17] Rregullorja (BE) Nr. 952/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 tetor 2013 që përcakton Kodin e Bashkimit Doganor dhe akteve zbatuese, Rregullorja e deleguar nga Komision i (BE) 2015/2446 e datës 28 korrik 2015, Plotësimi i rregullores (BE) Nr 952/2013 dhe Rregullorja Implementuese e Komisionit (BE) 2015/2447 të 24 nëntorit 2015 që përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e disa dispozitave të Rregullores (BE) Nr 952/2013

bërë në këtë kuadër, të ecin me të njëjtën shpejtësi dhe qasje. Ndër të tjera, kjo reformë është shumë e lidhur me reformat e tjera të ndërmarra për të lehtësuar kërkesat kufitare, kryesisht harmonizimin e legjislacionit me *Acquis* të BE-së në fushën e rregulloreve teknike dhe masat sanitare e fitosanitare, veprimet në dogana lidhur me këtë reformë etj.

Kohëzgjatja

2017

- Forcimi i kapaciteteve të NTPCF, zbatimi efektiv i Memorandumit të Mirëkuptimit; ndryshimi i VKM me qëllim për ta bërë atë në përputhje të plotë me *Acquis* të BE-së për OEA, Promovimi i konceptit të OEA në sektorin privat nëpërmjet një sërë takimesh Biznes-me biznes, B2B

2018

- Zbatimi efektiv i Memorandumit të Mirëkuptimit, thjeshtimin e masave sanitare dhe fitosanitare, Monitorimin e zbatimit të PKV 2017-2020, Promovimi i konceptit të OEA në sektorin privat nëpërmjet një sërë takimesh Biznes-me biznes, B2B

2019

- Lehtësimin e masave sanitare dhe fitosanitare, Monitorimi i zbatimit të PKV 2017-2020 për të propozuar masa korrigjuese

Kosto për aktivitet

- 20.000 EUR për të forcuar kapacitetet e Komiteti Kombëtar për Koordinimin dhe Lehtësimin e Politikave Tregtare (NCTPF) me mbështetjen e USAID-it.
- 180.000 EUR për të përfshirë menaxhimin e riskut në Agjencinë Shqiptare të Sigurisë Ushqimore dhe zhvillimin e metodologjisë të menaxhimit të bazës së të dhënave dhe mjeteve për Agjencinë Shqiptare për Sigurinë e Ushqimit;
- 180.000 EUR për të lehtësuar kërkesat për masat sanitare dhe fitosanitare;

Aktivitete të tjera të propozuara në këtë reformë janë kosto administrative për personelin.

Impakti në buxhet

Ndikimi buxhetor nga buxheti i shtetit është vetëm kosto administrative e personelit.

Impakti i pritshëm në konkurrueshmëri dhe rezultatet sociale

Reformat e propozuara do të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e kohës dhe kostos të importit dhe eksportit, dhe do të ndikojnë pozitivisht tregtinë ndërkombëtare të Shqipërisë. Përveç kësaj, pritet që shkëmbimi elektronik i të dhënave në kuadrin e CEFTA-s do të zvogëlojë kohën e zhdoganimit me këto vende, me 1/3. Rritja e kapaciteteve të Agjencive të kufirit dhe sektorit privat, do të kontribuojë në zbatimin e qetë të praktikave të reja të tilla si OEA, etj. Hapja e tregtisë pritet të rritet në 60% në 2017 nga 58% në vitin 2015. Reforma e propozuar do të ketë ndikim të tërthortë në punësim për shkak të rritjes së tregtisë dhe reduktimet përkatëse të kostove. Kjo reforma do të kontribuojë në uljen e çmimeve për konsumatorët me cilësinë e kërkuar dhe siguri.

Risqet e mundshme

Kjo reformë mund të pengohet nga kapacitetet e kufizuara të Sekretariatit Teknik të NTPCF për të mbështetur zbatimin e PKV 2017-2020. Për më tepër, një pengesë tjetër e mundshme janë kapacitetet e sektorit privat për të mbështetur me ekspertizën e nevojshme agjendën e lehtësimit të tregtisë dhe përfshirjen e saj të përhershme. Zbatimi i disa masave të PKV-së janë detyrim ligjor dhe duhet të sigurohet përgatitja në kohë e ndryshimeve.

Reforma #15: Sigurimi i një regjimi të vetëm dhe transparent ligjor të investimeve në vend

Kjo reformë ka si synim krijimin e një kuadri ligjor gjithëpërfshirës të investimeve për investitorët e vendas dhe të huaj në përputhje me praktikat e mira ndërkombëtare, dhe në zhvillimin e një mekanizmi i cili do të adresojë në mënyrë sistematike ankesat e bazuara dhe për të rritur përthithjen e investimit.

Reforma e propozuar është pjesë e prioriteteve të Programit të Qeverisë, ERP 2017-2019 nën masën e reformës së fuqizimit të tregëtisë, Shtylla I "Rritja e Integruar e SEE 2020, BIDS 2014-2020 dhe kontribuon në rritjen e konkurrueshmërisë.

Ky ERP parashikon aktivitetet që vijojnë, të nevojshme për zbatimin e masës së reformës:

- Zhvillimi i një Ligji të unifikuar Investimesh duke zëvendësuar ligjet kyçe egzistuese, rregulloret dhe marrëveshjet institucionale që rregullojnë investimet, veçanërsiht Ligjin mbi Investimet e Huaja (1993) dhe Ligjin mbi Investimet Strategjike (2015) dhe ligje të tjera të lidhura me Investimet e Huaja Direkte e rregulloret në zbatim të tyre.
- Zbatimin e mjetit të gjurmimit për menaxhimin e ankesave të investitorëve (IGM), dhe një mekanizëm të menaxhimit sistematik të ankesave të investitorit në ndjekje të praktikave të mira për të adresuar shqetësimet dhe ankesat për problemet me të cilat përballen investitorët gjatë ushtrimit të biznesit të tyre në vend.

Masat e përmendura më sipër do të rrisin atraktivitetin e vendit lidhur me të gjitha llojet e investimeve, përfshirë investimet e huaja dhe ato vendase.

Kohëzgjatja
Gjatë tri viteve të ardhshëm janë planifikuar të zbatohen aktivitetet si vijon:
2017
- Rishikimi i ligjeve kyçe, rregulloreve dhe marrëveshjeve institucionale që udhëheqin investimet.
- Zhvillimi i një harte udhëzuese për zbatimin e mekanizmit të menaxhimit të ankesave të investitorëve.

2018
- Miratimi i ligjit të unifikuar të Investimeve
- Miratimi i hyrjes ligjore në fuqi të kuadrit operacional për menaxhimin e Ankesave të Investitorëve (IGM).

2019
- Zbatimin e Mekanizmit të Ankesave të Investitorëve dhe sigurimin e konsultimeve me aktorët e interesit.

Kosto për aktivitet
70 milion USD – Kredi nga Banka Botërore, (shuma totale e Programit "Huadhënia për Politikën e Zhvillimit të Konkurrueshmërisë" për Shqipërinë).

Impakti në buxhet
Nuk ka impakt të parashikuar në buxhet.

Impakti i pritshëm në konkurrueshmëri dhe rezultatet sociale
Ligji i ri mbi investimet do të sigurojë përputhjen me standardet e punës, sigurisë dhe ato mjedisore dhe rregulloret në brendinë e tyre në legjislacionin vendas dhe në traktatet përkatëse ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria është pjesëmarrëse. Përfitimi I niveleve më të larta të IHD bazuar në kuadrin e ri ligjor, do të rrisë punësimin dhe fuqizojë rolin e Shqipërisë në zinxhirët globalë të vlerës.
Përpjekjet Qeveritare për të zgjidhur problemet me ankesat e investitorëve do të fuqizojnë besimin e investitorëve, ndihmojnë në përthithjen e investimeve dhe inkurajkojnë investitorët aktualë për të zgjeruar operacionet e tyre, ndërkohë që do të adresojnë çështjet në mënyrë sistematike në institocionet e sektorit publik.
Përmes Mekanizmit të Zgjidhjes së Ankesave të Investitorëve pritet që të absorbohen rreth 60 milion USD në investime.

Risqet e mundshme
Duke marrë në konsideratë se kjo është një reformë gjithëpërfshirëse e cila angazhon institucione të niveleve të ndryshme të politikëbërjes dhe një sërë palësh të interesuara, nevoja për një bashkëpunim më të ngushtë mes palëve të përfshira mund të konsiderohet si një proces kritik dhe mjaft kompleks.

4.3.7. Arsimi dhe aftësitë

1. *Gjendja aktuale dhe pengesat kryesore në konkurrueshmëri*

Sistemi arsimor në Shqipëri përballet me disa sfida në të gjitha nivelet, sfida të cilat pritet të vazhdojnë edhe gjatë periudhës 2017-2020. Një nga sfidat kryesore në këtë drejtim, e cila është dhe një ndër objektivat kryesore të "Strategjisë për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2015-2020", lidhet me përmirësimin e kurrikulës, cilësisë së arsimit dhe me aftësimin profesional të mësueseve në të gjithë nivelet arsimore.

Një nga sfidat kryesore të sistemit arsimor shqiptar është përputhja e kurrikulës me kërkesat e tregut të punës. Për të përmirësuar cilësinë e arsimit dhe për të shmangur boshllëkun ndërmjet aftësive të kërkuara dhe programeve arsimore të ofruara, Qeveria shqiptare ka ndërmarrë një reformë kurrikulare. Kjo reformë synon riorganizimin e kurrikulës për të mundësuar një sinergji horizontale dhe vertikale ndërmjet lëndëve dhe gjithashtu për të mundësuar që nxënësit të jenë të aftë të zgjidhin probleme të ndryshme në situata komplekse. Reforma në fjalë synon zhvillimin e kurrikulës bazuar në kompetencat kryesore evropiane të të mësuarit. Mundësimi i një kurrikule të re me bazë kompetencat do të ketë kështu një ndikim pozitiv si në cilësinë ashtu edhe në përfshirjen në sistemin arsimor, për çdo anëtar të shoqërisë. Aktualisht reforma e re kurrikulare është edhe pjesë e "Strategjisë për Zhvillimin e arsimit parauniversitar 2015-2020".

Gjatë vitit 2016, Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) ka realizuar një sërë aktivitetesh lidhur me zbatimin e reformës kurrikulare dhe aftësimin profesional të mësueseve. Gjatë vitit 2016, është zbatuar kurrikula e re me bazë kompetencat fillimisht në klasat e para dhe të gjashta në të gjithë institucionet arsimore në nivel kombëtar. Gjithashtu po zbatohet edhe kurrikula e re për arsimin e mesëm të përgjithshëm (Klasat X-XIII). Gjatë zbatimit të kësaj reforme, Instituti për Zhvillimin e Arsimit (IZhA) ka ndërmarrë trajnime për rritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin profesional të mësueseve duke mundësuar trajnime për mësuesit e klasave të dyta, të shtata dhe të dhjeta. Gjatë periudhës maj-shtator 2016 janë trajnuar rreth 3000 mësues nga klasat e dyta dhe të shtata.

Kjo reformë është në përputhje me qëllimet e "Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020" për sa i përket arsimit parauniversitar si edhe në vijim të zbatimit të qëllimeve të "Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2014-2020".

Prioritizimi i trajnimit profesional, si një objektiv i qeverisë, ka patur rezultat në ofrimin e mundësive më të mira për punësim dhe në një regjistrim më të lartë të të interesuarve. Kjo pasqyrohet edhe në të dhënat e Anketës së Forcës së Punës të INSTAT-it, për tremujorin e dytë të vitit 2016. Këto të dhëna tregojnë se shkalla e punësimit për personat e arsimit të mesëm profesional është 64.6% dhe për personat me arsim të përgjithshëm është 52%. Kjo tregon se punësimi për personat të cilët janë diplomuar në shkollat e arsimit të Mesëm profesional, është 12.6% më i lartë në krahasim me ata që mbarojnë shkollat e Mesme të përgjithshme. Gjatë vitit 2016, u finalizua hartimi i ligjit të ri për AFP, i cili synon të mbështesë reformën në Arsim dhe Formim Profesional - nwpwrmjet përshtatjes me nevojat e tregut të punës dhe përmirësimit tw elementeve të rëndësishëm të sistemit të menaxhimit, financimit, decentralizimit etj.

Projekt-Ligji i ri është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, partnerët socialë dhe me mbështetjen e donatorëve (si ETF, GIZ, etj). Task Force ka vijuar punën për zhvillimin e mëtejshëm dhe implementimin e Kornizws Shqiptare tw Kualifikimeve (KSHK). Në mënyrë të veçantë, ajo është duke hartuar një manual për Kornizwn Kombwtare tw Kualifikimeve, e cila do të shërbejë si një udhërrëfyes për zhvillimin e qëndrueshëm dhe zbatimin e këtij instrumenti. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe AKAFPK, si një nga institucionet përgjegjëse, ka vijuar me zbatimin e Kornizws Kombwtare tw Kualifikimeve shqiptare, duke zhvilluar dhe duke zgjeruar kualifikimet në Listën Kombëtare të Kualifikimeve Profesionale. Bazuar në rishikimin e Listës Kombëtare e tw Profesioneve e pwrfunduar në vitin 2015, AKAFPK wshtw rishikuar dhe zgjeruar me kualifikime të reja të niveleve 2 deri në 5 të KSHK.

Bazuar në Urdhrin e Përbashkët "Për Krijimin e Task Force për implementimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të Strukturës të Kualifikimeve Shqiptare", datë 29.9.2015, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë janë angazhuar për të rishikuar legjislacionin mbi Kornizwn Shqiptare tw Kualifikimeve ; për të zhvilluar një manual pwr KSHK, i cili do t'i shërbejë institucioneve, por edhe qytetarëve (si përdoruesit përfundimtarë të sistemit të kualifikimeve); për tw zbatuar nw vahdimwsi referencimin e Kornizws Shqiptare tw Kualifikimeve mw Kornizwn e Kualifikimeve Evropiane.

Në vitin e ri shkollor 2016 - 2017, në shkollat e arsimit profesional kishte rreth 6,300 studentë të regjistruar në vitin e parë në të gjitha shkollat e mesme profesionale, më shumë se 550 studentë në krahasim me vitin e kaluar.

Numri i përgjithshëm i studentëve që ndjekin arsimin me kohë të plotë në shkollat profesionale publike pwr këtë vit ishte rreth 18.500 studentë ose 10.8% më shumë se vitin e mwparshwm. Duke iu referuar të dhënave të Institutit Kombëtar të Statistikave, numri i përgjithshëm i nxënësve të regjistruar në shkollat e arsimit profesional (private dhe publike) është afërsisht 27,300 studentë.

Për vitin shkollor 2016-2017, përqindja e nxënësve që ndjekin shkollat profesionale është në rritje, rreth 19.5%, krahasuar me rreth 14% -15% që ishte dy vjet më parë.

Janë futur degë të reja duke marrw parasysh kërkesat e tregut të punës, si peshkimi, ekonomia e detit, gjeologjisë, minierave.

Në mënyrë që të rritet pjesëmarrja e nxënësve në shkollat e mesme profesionale janë dhënë bursa, të cilat

bazohen në pwrparwsitw e degëvetw ekonomisw, vendbanimin e nxënësve, gjendjen e tyre ekonomike, etj.
Wshtë rritur mbështetja financiare për shkollat profesionale për të përmbushur si shpenzimet operative ashtu edhe për sa i përket investimeve për laboratorë dhe kabinete me qëllim përmirësimin e kushteve për të ofruar një shërbim cilësor. Do të punohet për trajnimin e stafit menaxhues dhe mësuesve për të pwrditwsuar aftësitë dhe njohuritë e tyre rreth zhvillimeve të fundit teknologjike.
Gjatë vitit 2016, është bërë një punë e vazhdueshme për përmirësimin e imazhit të AFP. Kështu, Shqipëria ka zhvilluar takimet e para nw nivel qarku dhe panaire tw AFP në (Vlorë, Shkodër, Fier, Berat) dhe finalizimin me ngjarjen më të madhe të organizuar në kuadër të AFP: Panairin dhe Olimpiadën e Aftësive 2016, zhvilluar në datat 20- 22 maj 2016, me moton # Unw zgjedharsimin profesional. Krijimi i qendrave multifunksionale të AFP dhe shkollat e ekselencës janë prioritet i Ministrisë. Ka pasur mbështetje nga projekti IPA 2013 në këtë drejtim si edhe në zhvillimin e shkollave të ekselencës nga Qeveria Zvicerane, Qeveria Gjermane, Italiane, Austriake, etj. Vazhdon bashkwpunimi me donatorët (BE, GIZ-Gjermani, Zvicër-SDC, ADA-Austri, Kooperacioni Italian-Itali, etj) për të mbështetur shkollat më të mira profesionale, me qëllim për t'i transformuar këto shkolla në shkolla të ekselencës.
Bordet e Shkollave tw AFP janë duke u përmirësuar, por duhet akoma më shumë punë në kuadër të autonomisë dhe metodologjisë së planifikimit financiar.Trajnimi i mësuesve për "Bazat e didaktikës për mësuesit e AFP" është një nga hapat e Task Force që është ngritur me urdhër të përbashkët me Ministrin esë Arsimit dhe Sportit, Nr. Prot.7340 / 1, Datë 29/09/2015 dhe Nr. Prot. 4906, Datë 29/09/2015, që ka filluar punë për zbatimin e strategjisë e cila duhet të intensifikohet edhe më tej. Nw Drejtoritw Rajonale tw Formimit Profesional Publik wshtw rritur nw vitet e fundit numri i pwrfituesve tw kurseve të formimit profesional. Së fundi, numri i personave të certifikuar është 13, 000. Në vitin 2015, ka pasur 17,524 persona gjithsej të certifikuar. Gjatë muajve janar-shtator të vitit 2016, numri i personave të regjistruar ishte 13,915 persona në total; 12,609 persona u certifikuan; 4423 prej tyre, i përkasin gjinisë femërore.
Ka një zhvillim të konceptit të trajnimit të mësueseve para dhe gjatw shërbimit nw AFP. Përveç kësaj, një program trajnimi 24-ditor është zhvilluar me mbështetjen e Programit të GIZ për AFP-në. Ky program ka filluar zbatimin e tij në pjesën e parë si trajnimit pwrtrajnerëve, ndjekur nga një grup prej 24 mësiuwsishe. Gjithsej 42 arsimtarë i janë nënshtruar këtij trajnimi në periudhën korrik 2015- korrik 2016. Organizimi i fushatave mediatike dhe ndërgjegjësimi për rëndësinë dhe mundësitë nga AFP dhe procesi i të mësuarit për vajzat, djemtë, gratë dhe burrat në zonat urbane dhe rurale,ka vijuar çdo vit me qëllim rritjen e numrit të nxënësve të regjistruar në shkollat profesionale, si dhe rritjen e numrit të punëkërkuesve të papunë të regjistruar në zyrat e punësimit për të ndjekur kurse trajnimi në qendrat publike të formimit profesional. Gjatë vitit 2016, u organizuan shumë aktivitete në këtë drejtim.
Vlen të përmenden: Ditët e Hapura të organizuara nga çdo shkollë profesionale në bashkëpunim me shkollat 9-vjeçare në rajonin ku këto shkolla veprojnë; Ditët e hapura (duke përfshirë edhe Ditë tw vecanta pwr Vajzadhe ditë të veçanta për zonat rurale) për AFP në Kamzë; Transmetim filmin për kujdesin shëndetësor social; Fushatë Sociale mediatike për AFP (spot televiziv në Facebook, YouTube); Broshura MfC Kamza.
Kurrikula e rishikuar e AFP synon të përfshijë grupet vulnerabël si Romët/EEgjiptianët pwr ndjekur shkollat profesionale duke u mbështetur përmes bursave dhe teksteve shkollore falas.
Ndërhyrje në ndërtesa janw bërë nga ofrues të AFP-së për të qenë tw aksesueshme pwr grupet apo personatme aftësi të kufizuara. Për më tepër, personat vulnerabël marrin mësim falas në qendrat e trajnimit publik. Janë zbatuar një numër projektesh me fokus në: a) përmirësimin e sasisë dhe cilësisë së skemave të stazhit të punës (bazuar në të mësuarit e AFP) b) futjen e skemave stazh që angazhojnwdrejtpërsëdrejti punëdhënësit. Iniciativa e parë e futjes së programe tw stazheve (Apprenticeship Schemes) ka filluar me projektin "Programe pwr Stazhe për Punësimin e të Rinjve në Shqipëri ", financuar nga Programi Erasmus +. Në kuadër të këtij projekti, është zhvilluar një udhërrëfyes për futjen e prograjme tw stazheve në Shqipëri dhe është duke u testuar modeli në bashkëpunim me ndërmarrjet e ndryshme në sektorin e mikpritjes dhe turizmit si dhe në bashkëpunim me tri shkollat profesionale në Tiranë, Kamzë dhe Durrës.

2. Raportim mbi zbatimin e politikave udhëzuese nga Maj 2016

Rekomandim: ERP jep pak informacion lidhur me përmbajtjen e ndryshimeve në kurrikula dhe nuk ka orientim të qartë për institucionet zbatuese në sistem që do të përdoren për monitorimin e progresit dhe efektet përkatëse. Për zbatimin e suksesshëm të kurrikulës, "Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Paraunversitar 2015-2020", ngarkon institucionet e mëposhtëm: Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Institutin për Zhvillimin e Arsimit, Agjencinë Kombëtare të Provimeve, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore dhe shkollat.
Rritja e numrit të regjistrimit të studentëve në shërbimin publik të AFP-së.

Transformim i shkollave të AFP në shkolla multifunksionale dhe "ekselencës" me mbështetjen e donatorëve.
Rritja e bashkëpunimit me biznesin.
Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional. Rekomandimet në lidhje me ERP 2016-2018: Nuk ka rekomandime specifike.

3. Reformat dhe masat e propozuara

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, thekson se përmirësimi i cilësisë së arsimit nëpërmjet reformës kurrikulare është një nga sfidat kryesore të sistemit arsimor në vend. Në këtë kuadër, Strategjia për Arsimin Parauniversitar 2015-2020, parashikon bazuar në objektivin B: "arsim gjithëpërfshirës", krijimin e kurrikulave të reja në bazë të kompetencave për të gjitha nivelet e arsimit të krahasueshme me standardet e BE. Rrjedhimisht janë propozuar në këtë ERP masat vijuese:

Reforma #16: Hartimi dhe implementimi i kurikulave bazuar në kompetenca dhe trajnimi i mësuesve

Përmirësimi i kurrikulës bazuar në kompetenca sipas standardeve të BE-së përmes:

- Hartimit të kurrikulës së re në arsimin parauniversitar për klasat e IV, V dhe VI bazuar në kompetenca

Në vijim të parashikimeve të "Strategjisë për zhvillimin e arsimit parauniversitar 2015-2020" dhe të reformës kurrikulare, kurrikula e bazuar në kompetenca, do hartohet dhe për klasat IV, V dhe VI.

- Pilotimi i kurrikulës së re

Kurrikula e re do të pilotohet në disa shkolla, lista e të cilave po hartohet.

- Zbatimi i kurrikulës së re

Kjo masë parashikon zbatimin e kurrikulës së re në rang kombëtar për nivelet e sipërpërmendura. Ofrimin e trajnimit të mësuesve përmes:

- Trajnimit dhe kualifikimit të mësuesve me kurrikulën e re.

Kohëzgjatja

2017

- Hartimi i kurrikulave për klasat IV, V dhe VI

2018

- Hartimi i kurrikulave të reja për klasat IV, V dhe VI;
- Pilotimi i kurrikulës së re.

2019

- Trajnimi i mësuesve për kurrikulën e re.

Impakti në buxhet

Impakti buxhetor është 926,649 EUR për vitin 2017; 1,000,405 EUR për vitin 2018 dhe 920,649 EUR për vitin 2019.

Impakti i pritshëm në konkurrueshmëri dhe rezultatet sociale

Sigurimi i aksesit të barabartë në arsim për të gjitha grupet dhe përmirësimi i shërbimeve arsimore ndikon drejtpërdrejt tek pasojat sociale. Një ndërhyrje e duhur në arsim dhe një përfshirje më e madhe në këtë sektor sidomos për grupet vulnerabël, zgjeron shanset e tyre për një integrim më të mirë në shoqëri dhe rrit mënyrë indirekte mundësitë e tyre për punësim.

Risqet e mundshme

Nuk parashikohen risqe në këtë fazë.

Reforma #17: Përmirësimi i cilësisë dhe përfshirjes se AFP duke synuar lidhje me tregun e punës

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në përputhje me udhëzimet e programit të qeverisë, ka zhvilluar Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 - 2020, e cila ka në fokus punësimin dhe aftësitë. Objektivat do të arrihen përmes disa veprimtarive që lidhen me modernizimin e përfshirjes së AFP duke synuar zhvillimin e tregut të punës. Ofrimi i një arsimi cilësor profesional dhe trajnim për të rinjtë dhe të rriturit janë prioritetet strategjike të AFP, në Strategjinë Kombëtare për periudhën 2014-2020.

Kohëzgjatja

2017

- Miratimi i Ligjit për VET dhe hartimi i akteve përkatëse nënligjore në zbatim të ligjit deri në fund të vitit 2017;
- Implementimi i Kornizës së Kualifikimeve shqiptare është i vazhduar;
- Aftësim për zhvillimin e mësimdhënësve dhe trajnerëve të AFP (duke hartuar politika për rekrutimin, zhvillimin profesional, vlerësimin e kompetencave dhe trajnimin e mësimdhënësve të AFP dhe trajnerëve); është një proces i vazhdueshëm;
- Shtrirja e mbulimit të AFP në zonat rurale dhe në grupet e margjinalizuara;
- Krijimi i lidhjeve me sektorin privat për të ofruar trajnime/ programe stazhi.

2018

- Kuadri i ri ligjor dhe institucional në fushën e AFP, rindërtimi i ofrueseve publik të AFP, rindërtimi i mjediseve të ofruesve publik të AFP, përmirësimi i pajisjeve të shkollave, zgjerimi dhe konsolidimi i partneritetit me biznesin, etj.
- Sigurimi i cilësisë së ofrueseve të AFP-së dhe përmirësimin e cilësisë së inputeve nga AFP (laboratorë dhe pajisje, kurrikula mësimore) dhe proceseve.
- Aktet nënligjore në zbatim të ligjit do të hartohet.
- Aftësi për zhvillimin e mësimdhënësve të AFP dhe trajnuesve (duke hartuar politika për rekrutimin, zhvillimin profesional, vlerësimin e kompetencave dhe trajnimin e mësimdhënësve të AFP dhe trajnuesve).
- Shtrirja e mbulimit të AFP-së në zonat rurale dhe grupet e marxhinalizuara.

2019

- Zhvillimi i kornizës ligjore dhe institucionale në fushën e AFP, rindërtimi i mjediseve të ofrueseve publikë të AFP-së, përmirësimi i pajisjeve të shkollave, zgjerimi dhe konsolidimi i partneritetit me biznesin, etj.
- Sigurimi i cilësisë së ofrueseve të AFP dhe përmirësimin e cilësisë së AFP-së inputeve (laboratorë dhe pajisje, kurrikula mësimore) dhe proceseve.
- Aftësi për zhvillimin e mësuesve të AFP dhe trajnuesve (duke hartuar politika për rekrutimin, zhvillimin profesional, vlerësimin e kompetencave dhe trajnimin e mësimdhënësve të AFP dhe trajnuesve).
- Shtrirja e mbulimit të AFP-së në zonat rurale dhe grupet e margjinalizuara.

Kosto për aktivitet dhe impakti në buxhet

Zbatimi i masave dhe kostoja për AFP është parashikuar në buxhetin afatmesëm. Për vitin 2017, rritja e buxhetit ka qenë 30% për AFP, në krahasim me vitin e kaluar. Kostoja e vlerësuar për masën dhe alokimin e buxhetit dhe / ose me mbështetjen e donatorëve: Gjithë buxheti i nevojshëm është planifikuar në Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 - 2020. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 - 2020 do të mbështetet nga IPA 2015 me Mbështetjen me Buxhetim për Reformën e Sektorit të të Punësimit të Aftësive. Mbeshtetja Buxhetore për Reformën e Sektorit të Punësimit dhe Aftësive, financuar nga IPA 2015 nga Bashkimi Evropian është 30 milion EUR për periudhën 2016-2018.

Impakti i pritshëm në konkurrueshmëri dhe rezultatet sociale

- Gjenerata e të rinjve të trajnuar dhe të kualifikuar me aftësitë e nevojshme, të cilat janë të kërkuara nga tregu i punës dhe komuniteti i biznesit.
- Rritje e mundësive për punësimin e tyre.

Risqet e mundshme

- Mungesa e trajnimit të vazhdueshëm për mësuesit me teknologjinë e re;
- Nivel i pamjaftueshëm i koordinimit me biznesin për mbështetje më të mirë të AFP;
- Mungesa e vlerësimit të veçantë rajonal për aftësitë e munguara në tregun e punës;
- Lidhje më të mira dhe përgjigjshmëri nga qeverisja lokale për administrimin e shkollës.

4.3.8. Punësimi dhe tregu i punës

1. *Gjendja aktuale dhe pengesat kryesore në konkurrueshmëri*

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (2014-2020) ka filluar të zbatohet që prej hyrjes në fuqi, në fund të vitit 2014.

Disa nga arritjet e kësaj strategjie janë si më poshtë: 19 zyra punësimi të rinovuara dhe funksionale sipas modelit të ri të shërbimeve të punësimit. Modeli i ri i shërbimeve do të përdoret në të gjitha zyrat e punës.

Disa nga arritjet që kanë të bëjnë me promovimin e përfshirjes sociale dhe kohezionin territorial janë:

- Politika të reja punësimi për personat me aftësi të kufizuar janë implementuar, gjatë kësaj periudhe;
- Program i ri për gratë shtëpiake dhe vajzat me fëmijë nën moshën 18 vjeç, është implementuar gjatë kësaj periudhe (2016);
- Program i ri për nxitjen e punësimit për jetimët, të moshës 16-30 vjeç, është implementuar gjatë kësaj periudhe;
- Forcimi i qeverisjes së tregut të punës dhe sistemeve te kualifikimit.

Një hap tjetër shumë i rëndësishëm është miratimi i Ligjit të zejeve (30 Qershor 2016). Ky ligj rregullon ushtrimin e veprimtarisë zejtare në Republikën e Shqipërisë, kualifikimin profesional në këtë fushë, si dhe organizimin e subjekteve zejtare nëpërmjet krijimit të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, sipas modelit gjerman te arsimit profesional.

Arritje të tjera janë si më poshtë:

- Projektligji për "Nxitjen e Punësimit" pritet të aprovohet në KM-ve dhe në parlament.

Projektligji për "Nxitjen e Punësimit" do të rregullojë bazën ligjore për sa i përket shërbimeve të reja të punësimit ku përfshihen:

- Informacion për punëkërkuesin dhe punëdhënësin, i cili do të administrohet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit , sipas kërkesës dhe ofertës në tregun e punës.
- Ndërmjetësimi për punësim si një instrument i cili ka për detyrë gjetjen e një pune të përshtatshme për punëkërkuesit, trajnime, aftësim dhe kualifikime të cilat përputhen me kërkesat e përshkruara sipas punëdhënësit.
- Këshillim karriere dhe udhëzime, e cila synon të ndihmojë punëkërkuesit në zgjedhjen e tyre dhe formimin e një profesioni të përshtatshëm me cilësi të veçanta dhe që kërkon tregu i punës.

Gjatë kësaj periudhe, përmes zbatimit të ligjit nr 146/2015 "Për punëkërkuesit[18]", numri i punëkërkuesve ka rënë në nivel kombëtar. Zyrat e punësimit kanë pastruar listat e punëkërkuesve të papunë, duke identifikuar ata të papunë të cilët janë të interesuar në gjetjen e një pune. Kështu, numri i të papunëve ka rënë nga 145 147 në dhjetor të vitit 2015 në 115.548 në gusht 2016. Më 20 korrik 2016, në Ministri (MMSR) u mbajt takimi i Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave të Punësimit dhe Sektorit Social, i cili prezantoi edhe raport-progresin e pare të kësaj strategjie. Gjatë raportit u vlerësuan si të domosdoshme shumë rekomandime dhe u cilësuan hapat që do të ndërmerren gjatë periudhës 2016-2017. SKPA (2014-2020) përbëhet nga 52 veprime, të cilat do të zbatohen në një periudhë të përcaktuar 7-vjeçare. Nga këto 52 veprimet, 42 janë iniciuar (80% e totalit) dhe 20% e veprimeve janë ende për t'u nisur. Duke pasur parasysh informacionin e vetë-raportuar, 58% ishte niveli mesatar i zbatimit për 42 veprimet tashmë në zbatim.

Sipas statistikave të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP), papunësia për periudhën janar-korrik 2016 ishte: 119.922 persona të regjistruar si punëkërkues dhe të papunë, pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit, dhe 49% prej të cilëve janë femra.

- Prej tyre, 39% janë përfitues nga ndihma sociale
- 4.4% përfitojnë nga ndihma e papunësisë
- 56% janë të papunë afatgjatë
- 26% janë të rinj, të moshës 15- 30
- 7% romë dhe egjiptianë

Të dhëna të tjera nga zyrat e punësimit për periudhën janar-korrik 2016:

- Rritja e numrit të të rinjve, ose e atyre që kanë përfunduar arsimin e lartë, dhe që kërkojnë shërbime të reja në zyrat e punësimit.
- 13.211 punëkërkues të papunë në nivel kombëtar janë punësuar nga zyrat e punësimit.

2. *Raportim mbi zbatimin e politikave udhëzuese nga Maj 2016*

[18] Ky Ligji ka për qëllim të përmbush misionin e zyrave të punësimit për të siguruar sa më shumë mundësi punësimi dhe trajnime për punëkërkuesit, në mënyrë të veçantë për përfituesit e mbështetjes me të ardhura, integrimin e tyre në tregun e punës, kryesisht duke kaluar nga skemat pasive në skemat aktive, duke rritur në këtë mënyrë punësimin e tyre.

Përmirësimi i qeverisjes së tregut të punës ka qenë vazhdimisht në qendër të vëmendjes së institucioneve shtetërore dhe partnerëve socialë. Për më tepër, janë bërë përpjekje për të rritur punësimin, me fokus të veçantë, grupet rinore dhe grupet vurnerabël të rrezikuar; për të përmirësuar sistemin e arsimit dhe aftësimin profesional (AAP); për të fuqizuar ekonomikisht gratë dhe të forcojë sistemin e mbrojtjes sociale dhe e gjithë kjo, në një mënyrë të përgjegjshme gjinore.

Rekomandimet në lidhje me ERP 2016-2018.

Rekomandimi Nr. 6. Rritja e veprimit të politikave aktive të tregut të punës dhe përmirësimi në aktivizimin e personave të papunë, veçanërisht të rinjtë, gratë dhe të papunët afatgjatë. Shtimin e përpjekjeve aktuale për të arritur një qasje gjithëpërfshirëse për reduktimin e punës në të zezë ose të padeklaruar.

3. *Reformat dhe masat e propozuara*

Reforma #18: Modernizimi i shërbimeve publike të punësimit, rritja e punësimit të grave, të rinjve dhe njerëzve vulnerabël

Objektivat e kësaj reforme do të arrihen përmes një numri veprimesh që lidhen me modernizimin e arsimit dhe trajnimit profesional dhe forcimin e masave aktive të nxitjes së punësimit me fokus gratë, të rinjtë si edhe me anë të veprimeve specifike për të mbështetur grupet më pak të favorizuara të shoqërisë shqiptare.

Objektivat specifike të reformës janë të bazuara në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (2014 - 2020) dhe do të mbështesin në mënyrë të veçantë:

- rritjen e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe sigurimin e mundësive të punësimit për të gjithë;
- rritjen e cilësisë së arsimit dhe formimit profesional;
- përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të institucioneve dhe shërbimeve të tregut të punës.

Buxheti që do të mbështesë këto çështje është në shumën 30 milionë euro.

Rritja e financimit sipas kontratës për sektorin është pasqyruar në buxhetin e vitit 2016 dhe parashikuar në projekt buxhetin për vitin 2017[19] dhe 2018. Buxheti afatshkurtër dhe afatmesëm është i lidhur ngushtë me zhvillimin e planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi dhe me treguesit e vendosur në planin e saj të veprimit.

Programet e Nxitjes së Punësimit[20], të cilat janë duke u implementuar për 2016, janë si më poshtë:

Nxitja e punësimit për grupet vurnerabël[21]

- Trajnimi në punë
- Nxitja e punësimit e të diplomuarve të rinj (Bachelor ose Master) deri në 30 vjeç
- Nxitja e punësimit të grave kryefamiljare me fëmijë në ngarkim dhe nënat e reja
- Nxitja e punësimit të personave me aftësi të kufizuara
- Praktika (internship) për të diplomuarit e rinj
- Nxitja e punësimit për jetimët

Në vitin 2016, buxheti i shtetit për Programet e Nxitjes së Punësimit ishte 490 milionë Lek. Këto programe janë realizuar gjatë periudhës 2016 dhe deri tani 5211 punëkërkues të papunë janë përfshire në këto programe, të ndara sipas kategorive të ndryshme, të cilat janë si më poshtë:

- 469 studentë të diplomuar janë duke ndjekur praktikat profesionale në 94 subjekte, ku pjesa më e madhe janë institucionet e administratës publike, arsimit, shëndetësisë, banka, etj.
- të përfshirë në këto programe janë 53 persona me aftësi të kufizuar, kryesisht të moshës deri në 40 vjeç dhe me arsim të mesëm[22].

---

[19] Të gjitha reformat e ndërmarra në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (2014 - 2020), do të vazhdojnë në 2017 dhe 2018 dhe do të çojnë në arritjen e: (i) Riorganizimi i zyrave të punësimit dhe shërbimeve të punësimit; (ii) Miratimi i Ligjit të ri "Për nxitjen e punësimit" dhe hartimin e paketave të akteve nënligjore që ky ligj autorizon; (iii) Zbatimi i programeve për nxitjen e punësimit me përfshirjen e grupeve të veçanta në këto programe.

[20] Sipas planifikimit për vitet 2017-2019, Zëri "Programet e nxitjes së punësimit", është parashikuar 640 milionë lekë dhe në "investim" është parashikuar 315 milionë lekë.

[21] Sipas Ligjit "Për Nxitjen e Punësimit" grupe të veçanta janë punëkërkuesit si psh. nënat me shumë fëmijë, personat të moshës mbi 50 vjeç, të rinjtë nën 18 vjeç, të papunët afatgjatë, persona të cilët jetojnë nën nivelin e varfërisë, viktima të trafikimit, vajzat-nëna të papuna, femra të divorcuara me probleme sociale, personat që kthehen nga emigracioni me probleme ekonomike, njerëz të diplomuar jo të orientuar në tregun e punës, personat që janë dënuar me burgim, personat me aftësi të kufizuara; komuniteti Rom, jetimë që kanë fituar këtë status

[22] Vetëm 4.3%, nga 120 mijë punëkërkues të papunë kanë përfituar nga programet e nxitjes së punësimit në vitin 2016

- nga programi i ri për punësimin e të diplomuarve të rinj, realizuar rishtazi gjatë vitit 2016, kanë përfituar 31 punëkërkues të papunë nga kjo kategori.
- Janë përfshirë në programe 394 punëkërkues të papunë nga skemat e mbështetjes me të ardhura ose 9% e totalit të pjesëmarrësve.
- personat e papunë afatgjatë të përfshirë në program janë 896 ose 19% e totalit të pjesëmarrësve.
- për sa i përket grupeve të tjera janë 152 persona të papunë, duke përfshirë romët, emigrantët dhe 2 jetimë punëkërkues të papunë.

Risi për këtë vit në programet e nxitjes së punësimit janë:

- Zbatimi i Programe të reja për jetimët, për gratë dhe vajzat në vështirësi dhe për punësimin e punëtorëve të papunë me arsim të lartë
- Zhvillimi dhe zbatimi i programeve duke i dhënë prioritet kombinuar subjektet që aplikojnë për programet e trajnimit së bashku ose të punësimit subvencionimit tradicionale profesional shprehur interes për të punësuar persona me aftësi të kufizuara, jetimët apo të grave kryefamiljare vajzat në të njëjtën kohë.
- Zhvillimi i një sistemi të pikëve që do të synojë për të shpërndarë më mirë fondin në dispozicion.

Në 2 vitet e fundit, angazhimi i qeverisë për axhendën e punësimit ka rezultuar në një rritje të konsiderueshme të fondeve të destinuara për Programet e Nxitjes së Punësimit. Për vitin 2016, fondet janë 5 herë më të larta se në vitin 2013.Numri i përfituesve është në një rritje të vazhdueshme që nga viti 2013. Përveç kësaj, në vitin 2016, programi mbështetës i buxhetit IPA 2 do të fillojë zbatimin dhe pjesa e punëkërkuesve të papunë, që përfitojnë nga programet e nxitjes së punësimit, mendohet të jetë një nga indikatorët e planit të veprimit.

Rritja e kapaciteteve të stafit

Trajnimi i stafit të zyrave të punësimit[23] për zbatimin efektiv të të gjitha aktiviteteve që përfshin reformën e zbatimit të modelit kombëtar të punësimit ka vazhduar si më poshtë:

- Zbatimi i ligjit të ri "Për Punëkërkuesit" dhe udhëzuesi në zbatim të tij, ndryshimet në regjistrat e sistemit informatik si dhe realizimi i ndërveprimit të tij me sistemet e tjera të platformës qeveritare, solli në planifikimin dhe realizimin e 7 trajnimeve për gjithë stafin e Zyrave të Punës në të gjitha nivelet, gjithsej, 200 vetë.
- Trajnimi specifik 2 vjeçar për specialistët e këshillimit që do të punojnë individualisht me grupet vulnerabël (niveli i tretë i shërbimit të specializuar) i mbështetur nga projekti "Këshillim drejt Punësimit dhe Sipërmarrjes" Swisscontact, po vazhdon edhe në 2016.
- Në kuadër të zbatimit të modelit kombëtar të shërbimit lindi e nevojshme që të përgatiten elementë shpjegues në interpretim të këtij modeli që të bëjë të mundur zbatimin e të gjitha standardeve strukturore dhe funksionale që ai përmban. Gjatë muajit Mars – Maj 2016 u hartua një manual mbi ''Organizmin Funksional dhe Strukturor të Zyrave të Punësimit'' për zbatimin e modelit të ri të shërbimeve të punësimit. Manuali është një udhëzues për zyrat e punësimit në lidhje me organizimin, funksionimin, strukturimin e zyrave rajonale ose lokale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, si edhe për planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e objektivave, ndarjen e aktiviteteve dhe detyrave në tri nivele, në përputhje me nivelin e shërbimeve të ofruara.

Në periudhën qershor - korrik 2016 u realizuan takime rajonale trajnimi me specialistë dhe menaxherët e zyrave të punësimit për përvetësimin dhe zbatimin e këtij manuali.

Këto programe kanë qenë duke u zbatuar gjatë vitit 2016 dhe deri më tani 5211 punëkërkues të papunë janë të angazhuar në këto programe, nga të cilat 58% janë femra.

Risi për këtë vit në programet e nxitjes së punësimit janë:

Zhvillimi i një sistemi të pikëve që do të synojë për të shpërndarë më mirë fondin në dispozicion[24].

---

[23] Reforma e re territoriale parashikon 61 komuna. Shërbimet e punësimit do të përfshijnë këto 61 komuna dhe kjo gjithashtu kërkon rritjen e numrit të stafit në SHKP.

[24] Komisioni I miratimit të projekteve në SHKP udhëheq procesin e vlerësimit sipas një sistemi pikësh, i cili bazuar në 8 kategori:

Potenciali ekonomik; Plan biznesi; Ndikimi social dhe/ose mjedisor; Kohëzgjatja e programit; Numri i të papunëve në program; Kostoja për punëkërkuesit; Vlerësimi i fushës së subjektit; Historia e pjesëmarrjes në programet e punësimit. Komisioni vendos të miratojë të gjitha projektet që janë vlerësuar me më shumë pikë. Numri i përfituesve për çdo

Kohëzgjatja
Përqindja e punëkërkuesve të regjistruar si të papunë që do të përfitojnë nga Programet e Nxitjes së Punësimit (EPP), në vitin 2017 do të arrijë në 4.5% dhe në vitin 2018 do të arrijë në 5%.

Kosto për aktivitet
Kjo strategji do të mbështetet nga IPA 2015 "Mbështetje nga Buxheti i Kontratës për Reformat Sektoriale". Reformat për Sektorin për Punësimin dhe Aftësi financohen nga IPA 2015 nga BE-ja, 30 milion euro për periudhën 2016-2018.

Impakti i pritshëm në konkurrueshmëri dhe rezultatet sociale
Rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe ofrimin e mundësive të punësimit për të gjithë. Rritja e cilësisë së arsimit dhe formimit profesional. Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të institucioneve dhe shërbimeve të tregut të punës.

4.3.9. Përfshirja sociale, ulja e varfërisë dhe shanset e barabarta

1. *Gjendja aktuale dhe pengesat kryesore në konkurrueshmëri*

Shqipëria ka shtuar përpjekjet për të reduktuar varfërinë, për të implementuar objektivat për përfshirje dhe mbrojtje sociale. Zhvillimi njerëzor dhe kohezioni social është një shtyllë e rëndësishme e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, e cila ka për qëllim rritjen ekonomike dhe konkurrencën. Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015-2020 dhe Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale 2016-2020, si dhe Strategjia për Punësim dhe Aftësi 2014-2020 kanë si synim përmirësimin e qasjes në arsim dhe trajnim cilësor, kalimin në tregun e punës, mundësi punësimi të shtuara dhe të përmirësuara për grupet vurnerabël.
Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015-2020 ka në qendër luftën ndaj varfërisë përmes politikave specifike për të reduktuar efektet e saj nëpërmjet pagesave në para cash apo programeve. Strategjia e Mbrojtjes Sociale është një mbështetje e fortë për politikat sociale dhe ekonomike për të forcuar familjet dhe për të ndërtuar një rrjet shërbimesh të integruara. Në zbatim të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale, Regjistri Kombëtar Elektronik për Menaxhimin e Ndihmës Ekonomike në nivel kombëtar është funksional dhe rritja e efektivitetit të këtij regjistri do të përmirësojë identifikimin e asistencës ekonomike (cash) në të gjithë vendin. Masat e mbrojtjes sociale kanë për qëllim që deri në vitin 2020, çdo fëmijë dhe/ose i rritur të mund të ketë akses dhe të mund të përfitojë nga shërbimet sociale të nevojshme përmes një sistemi të integruar shërbimesh, i cili kombinon shërbime të kujdesit social kundrejt pagesës me të holla (cash), duke ofruar një paketë të integruar të shërbimeve.
Nevojat e personave me aftësi të kufizuara, do të vlerësohen në bazë të modelit biopsikosocial për të rritur. Shpërndarja e pagesës së ndihmës ekonomike tek gratë ishte një masë për të ndihmuar në administrimin efektiv të të ardhurave familjare. Mbështetja ekonomike për familjet në nevojë realizohet me programet kombëtare të Ndihmës Ekonomike, të cilat kanë si qëllim mbështetje me ndihma financiare dhe ofrimin e shërbimeve sociale në nivel Bashkie/Komune. Qeveria do të reformojë sistemin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, do të rrisë transparencën e përfituesve nga skemat e përfitimeve monetare për të gjithë personat me aftësi të kufizuar përmes sistemeve me dhëna, do të lidhë skemat e përfitimit monetar me shërbime sociale dhe do të zhvillojë një Sistem të Menaxhimit të Informacionit të integruar. Një formulë e re e pikëzuar e saktë është përdorur për shpërndarjen e ndihmës ekonomike tek përfituesit. Shërbimet Sociale kanë nevojë për t'u zgjeruar dhe për t'u diversifikuar në procesin e decentralizimit dhe transformimit të institucioneve. Përfshirja e grupeve në nevojë në programet e mbrojtjes sociale dhe ofrimi i shërbimeve do të përqendrohen në mirëqenien e individit dhe të familjes. Duke marrë parasysh reformën territoriale në bazë të Ligjit Nr.115/2014 "Për njësitë administrative dhe territoriale të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", ndryshimet strukturore brenda Reformës së Shërbimeve Sociale do të përmirësojnë mbulimin kombëtar me shërbime sociale.
Reforma e pensioneve ka për qëllim forcimin e lidhjes midis kontributeve individuale dhe shumës së pensionit. Ky opsion parashikon ndryshimin e formulës së llogaritjes së pensioneve, duke reflektuar thjeshtësinë dhe transparencën, duke e lidhur masën e përfitimit me kontributin e paguar. Zbatimi i reformës do të zvogëlojë

lëndë/tematik përcaktohet në bazë të një formule që merr parasysh fondet në dispozicion, në varësi të kërkesës së personave të papunë dhe reflektimin e pikave të performancës. Formula është ndërtuar me qëllim (i) maksimizimin e numrit të përgjithshëm të përfituesve të punëkërkuesve të papunë (favorizojnë projektet që kërkojnë mjete më pak në dispozicion); (ii) sigurimin e proporcionalitetin në shpërndarjen e fondeve në dispozicion; (iii) dhënien e përparësisë projekteve të cilat janë vlerësuar me më shumë pikë.

deficitin e skemës së pensioneve, do të përmirësojë situatën financiare që rrjedh nga modeli i skemës së financimit të pensioneve dhe do të zvogëlojë subvencionet shtetërore. Efekti pozitiv i zbatimit të reformës së pensioneve është edhe qëllimi për të cilin është ndërmarrë kjo reformë, e cila synon rritjen e qëndrueshmërisë financiare të skemës së sigurimeve shoqërore duke ulur kontributin e buxhetit të shtetit. Sistemi i pensioneve synon gjithashtu të reduktojë pabarazitë. Pensionet shoqërore mund të përfitohen për personat mbi 70 vjeç pa të ardhura. Digjitalizimi i skemës së sigurimeve dhe skemës së kontributeve me qëllim rritjen e transparencës dhe të kontrollit përmirëson gjithashtu llogaritjen dhe pagesën e pensioneve online. Numri i pensioneve të paguara online është në rritje.

Shqipëria ka miratuar zyrtarisht Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020. Ekzistojnë programe për nxitjen e punësimit të femrave nga grupet e veçanta, ku përfituese janë gratë kryefamiljare dhe nënat e reja me fëmijë deri në moshën 18 vjeç.

Minimizimi i dhunës me bazë gjinore është pjesë e kësaj strategjie.

Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve (2016-2020) ka vendosur gjashtë fusha prioritare për qeverinë, duke përfshirë regjistrimin civil, arsimin dhe dialogun ndërkulturor, punësimin dhe arsimin e formimin profesional kujdesin shëndetësor, strehimin dhe integrimin urban si edhe sigurimet shoqërore. Agjenda Kombëtare për Fëmijët është në proces hartimi; kujdesi ndaj fëmijëve dhe qasje në shërbimet themelore për më të varfrit dhe më të margjinalizuarit dhe një mekanizëm i përforcuar për mbrojtjen e fëmijëve. Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale identifikon objektivat për adresimin e nevojave të individëve në prag të varfërisë dhe përjashtimit social nëpërmjet qasjes më të mirë në arsim, punësim dhe mbrojtje sociale. Reduktimi i varfërisë në Shqipëri do të matet nga Anketa për të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës. Strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale që synojnë reduktimin e varfërisë dhe rritjen e aksesit për grupet në nevojë trajtojnë familjet në nevojë, gratë, të rinjtë , të papunët afatgjatë, komunitetet Rom dhe Egjiptian, gratë e trafikuara, ish-të burgosurit, jetimët, personat me aftësi të kufizuar dhe emigrantët e kthyer. Banorët e zonave rurale, veçanërisht në zonat e thella rurale dhe zonat malore, kanë standard më të ulëta të jetesës se sa njerëzit që jetojnë në pjesë të tjera të vendit, sipas të dhënave nga studimi i fundit Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës. Mundësitë e punësimit janë të pakta dhe të ardhurat nga punësimi janë relativisht të ulëta.

Mbështetje me të ardhura të mjaftueshme dhe përfitimet familjare parandalojnë varfërisë e të miturve dhe përjashtimin social. Në përgjithësi, varfëria kërkon një përgjigje politike gjithëpërfshirëse duke koordinuar sigurimet sociale dhe ndërhyrje në tregun e punës.

Qeveria ka vazhduar përpjekjet për të garantuar në mënyrë të koordinuar monitorimin dhe qasjen strategjike për të realizuar politikat ndër-sektoriale. Grupi i Menaxhimit të Politikave të Integruara i cili shqyrton ndikimin e strategjive sektoriale dhe ndër-sektoriale ka shqyrtuar strategjitë sektoriale në Punësim, Aftësim dhe Sektorin e politikave sociale. Ministritë e linjës dhe institucionet publike janë pjesë e IPMG-së. Grupi i për Integritetin e Treguesve dhe Statistikave është krijuar me qëllim përmirësimin e mbledhjes se të dhënave, për të përcaktuar indikatorët bazë dhe për të siguruar pajtueshmërinë me futjen dhe kalimin në Anketën e Matjes Së të Ardhurave dhe Kushteve të Jetesës së BE (EU SILC European Union Statistics on Income and Living Conditions). SILC është pilotuar në mënyrë që të zgjerohet shtrirja në të gjithë vendin. Janë hedhur hapa në drejtim të përmirësimit dhe përmbajtjes dhe cilësisë së monitorimit të barazisë gjinore, aftësisë së kufizuar dhe të drejtave të pakicave. Koordinimi ndërmjet programeve të ndihmës ekonomike dhe reformave në tregun të punës do të lejojë aktivizimin e strategjive. Institucionet duhet të forcojnë koordinimin e mëtejshëm të dokumenteve të politikave të miratuara për të krijuar një bazë të qëndrueshme dhe të besueshme monitorimi me përshtatshmërinë dhe saktësinë e të dhënave në përfshirjen dhe mbrojtjen sociale dhe tregun e punës dhe formimin profesional

Ligji i ri për ndërmarrjet sociale është miratuar duke përcaktuar aktivitete qëllim promovimin e zhvillimit të komuniteteve lokale.

Nëpërmjet akteve nënligjore që do të hartohen për ligjin e Ndërmarrjeve Sociale do të promovohet rritja e mundësive për qasje në tregun e punës dhe promovimit të një klime të përgjegjësisë sociale. Ngritja e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë ka në shënjestër edhe mbështetjen për zejtarët ve, sidomos ata që jetojnë në zonat rurale.

2. Raportim mbi zbatimin e politikave udhëzuese nga Maj 2016

Nuk ka rekomandime ERP që në mënyrë specifike adresojnë mbrojtjen dhe përfshirjen sociale. Koordinimi ndërsektorial ka vazhduar përmes IPMG-së për monitorimin e Planeve Kombëtare të Veprimit dhe SIIG është themeluar me përfshirjen e INSTAT-it, në mënyrë që t'i përgjigjet natyrës shumëdimensionale të varfërisë dhe përjashtimit. Strategjitë me fokus social që veprojnë në nivel lokal, nxisin përfshirjen sociale dhe barazinë gjinore, janë fokusuar në përmirësimin e pozitës së grupeve në nevojë; përmirësimin e qasjes në shërbimet e mbrojtjes

sociale në zonat e thella rurale; po ashtu në rritjen e ndërgjegjësimit të të drejtave të personave të moshuar. Në veçanti, qasja në kujdesin shëndetësor (duke përfshirë promovimin e shëndetit, parandalimin dhe trajtimin e sëmundjes) dhe politikat e shërbimeve sociale dhe të punësimit (si skemat e sigurimeve shoqërore, shërbimet e asistencës sociale, banesat sociale, kujdesi ndaj fëmijëve ose përkujdesi shoqëror afatgjatë, shërbime për punësim dhe trajnim janë kritere bazë për grupet e rrezikuara pasi këto shërbime forcojnë kapacitetin e individëve për të marrë pjesë plotësisht në shoqëri dhe për të përfituar nga mundësitë e barabarta.

3. Reformat dhe masat e propozuara

Reforma #19: Forcimi i mbrojtjes sociale dhe masat e përfshirjes sociale

Kohëzgjatja

2017

- Regjistri Kombëtar Elektronik për administrimin e ndihmës ekonomike do të zgjerohet në të gjitha bashkitë dhe komunat gjatë 2017;
- Skema e asistencës financiare, kalimi nga nje skemë passive në një skemë aktive nëpërmjet programeve të reintegrimit dhe alternimi me skemat e papunësisë;
- Shërbime shoqërore funksionale dhe efektive duke u bazuar tek parimi i shumëllojshmërisë;
- Gjatë vitit 2017, në skemën e reintegrimit social mbi 5% e përfituesve do të përfshihen ne politikat aktive të tregut të punës, duke krijuar paketa me shërbime të integruara dhe mundësi punësimi;
- Rritje e qëndrueshmërisë financiare për skemat e pensioneve dhe të sigurimeve shoqërore;
- Grupi i treguesve dhe integritetit të statistikave për të siguruar konsistencën në përkufizimin dhe përdorimin e indikatorëve.

2018

- Rritja e efektivitetit të regjistrit elektronik në rajone / qeverisjen vendore;
- Rritja e qëndrueshmërisë financiare të skemës së pensioneve dhe sigurimeve shoqërore;
- Rritjen e efikasitetit dhe saktësisë në identifikimin e përfituesve nga programet e transferimit të parave *cash* nëpërmjet themelimit të Regjistrit Kombëtar Elektronik për menaxhimin e ndihmës ekonomike;
- Rritja e efiçiencës së skemës së ndihmës financiare, duke kaluar nga një skemë pasive në një skemë aktive përmes programeve të reintegrimit dhe duke i alternuar ato me skemat e punësimit;
- Shërbime shoqërore funksionale dhe efektive bazuar në parimin e diversifikimit. Masa të integruara në modelin social për të vlerësuar aftësinë e kufizuar.

2019

- Zhvillimi i transparencës dhe llogaridhënies për sa kohë përfshirja sociale matet dhe përdoret për t'u informuar mbi performancën e shërbimeve publike;
- Rritja e transparencës së përfitimeve për Personat me Aftësi të Kufizuara përmes krijimit të Regjistrit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, duke e bërë këtë regjistër efektiv në 90% të njësive të qeverisjes vendore në rajonet e përzgjedhura;
- Rritja e qëndrueshmërisë financiare për skemat e pensionit dhe sigurimeve shoqërore;
- Forcimi i administrimit të programit të ndihmës për personat me aftësi të kufizuar duke futur në veprim regjistra automatik dhe duke reformuar sistemin e vlerësimit, zhvillimin e sistemit për monitorimin dhe matjen e përfshirjes sociale në të gjithë fushat e politikave të reduktimit të varfërisë dhe mbrojtjes sociale, punësimit dhe aftësive, arsim dhe trajnim, shëndetësi, nevojat themelore, pjesëmarrjes dhe të drejtave të njeriut.

Impakti në buxhet

Buxheti për Kujdesin dhe Përfshirjen Sociale parashikohet në Buxhetin Afatmesëm 2017-2019.

Buxheti për Strategjinë për Mbrojtjen Sociale

Buxheti i Shtetit	514,213,850 Lek
Mbështetja e Donatorëve	180,944,790 Lek

Buxheti për përfshirjen sociale është i shpërndarë në Strategji sektoriale dhe ndër-sektoriale të ndryshme dhe programe politike. Kuadri i monitorimit dhe vlerësimit të përfshirjes sociale është i përfshirë në Dokumentin Politik

për Përfshirjen Sociale.

Impakti i pritshëm në konkurrueshmëri dhe rezultatet sociale
Një rrjet i mirë-adresuar dhe i shumëllojshëm i shërbimeve sociale do të rrisë numrin e përfituesve. Modeli i ri i shpërndarjes së ndihmës ekonomike ka për qëllim identifikimin e familjeve me të ardhura të ulëta, duke ndikuar drejtpërdrejt tek familjet në nevojë më të varfëra.
Aplikimi i modelit të ri për caktimin e ndihmës për personat me aftësi të kufizuara sipas klasifikimit ICF dhe në përputhje me modelin social të vlerësimit, do të mundësojë vlerësime gjithëpërfshirëse multidisiplinare duke pasur parasysh integrimin e ardhshëm në punësim.
Legjislacioni për ndërmarrjet sociale do të rrisë mundësitë për individët me të ardhura të ulëta që të jenë të përfshirë në tregun e punës, pas miratimit të akteve nënligjore përkatëse. Mekanizma të përmirësuar për matjen e mbrojtjes sociale me qëllim një vlerësim më të mirë dhe analizimin e politikës për përfshirjen sociale

Risqet e mundshme
Pengesat kryesore për zbatimin lidhen me kapacitetet e pamjaftueshme në njësitë e qeverisjes vendore për të menaxhuar dhe për të ofruar tipologji të shërbimeve sociale të diversifikuara. Një çështje tjetër është lëvizshmëria e lartë e popullsisë e cila kërkon ndërhyrje të përmirësuara për nevojat e ndryshueshme të familjeve në nevojë dhe grupeve të margjinalizuara.
Shpërndarja e të ardhurave, por edhe të shërbimeve ndikojnë në qasjen e grupeve më të rrezikuara. Ekziston një nevojë e identifikuar për mbledhjen e të dhënave dhe kategorizimin e tyre me fokus grupet vulnerabël, me qellim trajtimin e shkaqeve dhe efekteve të varfërisë. Kjo analizë nuk është e plotë pa të dhëna statistikore mbi përfshirjen në tregun e punës.
Krijimi i një sistemi për monitorimin dhe matjen e përfshirjes sociale në të gjithë fushat e politikës të reduktimit të varfërisë dhe mbrojtjes sociale, punësimit dhe aftësimit, arsimit dhe trajnimit, shëndetësisë, nevojave themelore, pjesëmarrjes dhe të drejtave të njeriut janë të rëndësishëm me qëllim që të nxitet transparenca dhe llogaridhënia për sa kohë që përfshirja sociale matet dhe përdoret për t'u informuar mbi performancën e shërbimeve publike.

5. IMPLIKIMET BUXHETORE TË REFORMAVE STRUKTURORE

REFORMA NË SEKTORIN E UJIT

Burimet e ujit të pijshëm konsiderohen si një nga burimet natyrore kryesore të vendit tonë. Kapaciteti aktual i burimeve ujore në Republikën e Shqipërisë është 500 milion/m³ në vit. Ky kapacitet tejkalon 2 herë nevojën e furnizimit me ujë për të gjithë popullatën, e cila shkon në 217 milion/m³ në vit. Aktualisht prodhohet rreth 277 milion/m³ në vit[25], e cila e tejkalon me rreth 28% (60 milion/m³ në vit) nevojën aktuale për ujë të pijshëm.

❖ Problematika e sektorit

Sektori i ujit aktualisht karakterizohet nga një sërë problematikash të lidhura së pari, me ofrimin e shërbimit në mënyrë tepër të copëzuar dhe së dyti, ofrimi në disa raste i shërbimit në mënyrë të palicensuar. Kjo e fundit lidhet me periudhën përpara realizimit të reformës territoriale administrative, kur komunat, si njësi të qeverisjes vendore, ofronin këtë shërbim, ndaj popullsisë në juridiksionin e tyre në shumicën e rasteve në mënyrë të palicensuar.

Më poshtë renditen në mënyrë të detajuar problematikat e sektorit:

- Nga prodhimi prej 277 milion/m³ në vit, vetëm 92 milion milion/m³ në vit gjenerojnë të ardhura. Pjesa tjetër, që përbën 67%, është humbje shpesh e pajustifikuar.
- Aksesi me Shërbimet Ujësjellës – Kanalizime – Trajtim i ujrave të ndotura, rezulton i pamjaftueshëm:
  - Mbulimi me Ujësjellës rreth 80%
  - Mbulimi me kanalizime 62%
  - Mbulimi me ITUN 13%
- Performanca financiare, paraqitet përgjithësisht e dobët:
  - Mbulimi i Kostos Totale të Operimit (KTO) me të ardhurat 75%
  - Mbulimi i KTO me arkëtime 69%
  - Mbulimi i KTO me subvencione 5%
  - KTO e pambuluar (1.2 miliardë Lek) 20%
- Niveli i matjes së prodhimit 36% dhe niveli i shitjes 61%, rezulton shumë i ulët.
- Kohëzgjatja mesatere e furnizimit me ujë 12.1 orë/ditë.
- Ekzistojnë kategori të konsumatorë, që nuk paguajnë 100% për shërbimet që marrin.
- Investime të orientuara politikisht e të pa bazuara në performancë.
- Janë licensuar edhe shoqëri që nuk zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale dhe financiare.
- Tarifa aktuale të vendosura nuk janë në përputhje me kostot dhe shpesh karakterizohen nga diferenca të pajustifikuara.
- Mënyra e organizimit dhe administrimit të sektorit, jo efikas.

❖ Nevoja për Reformë

Nevoja për reformimin e sektorit bëhet e domosdoshme jo vetëm për shkak të riorganizimit territorial dhe administrativ, por edhe si pasojë e mospasjes së një reflektimi të përmirësimit të dukshëm të shërbimit ndaj qytetarëve, pavarësisht nivelit të investimeve. Konkretisht, niveli i investimeve në sektorin e ujit nga periudha 2005-2015 paraqitet i detajuar në tabelën e mëposhtme:

Në mijë Lek

Investimet në sektor	***Periudha 2005-2015***
Investimet në Ujësjellesa	36.183.624
Investimet në Kanalizime	28.608.197
Investimet në Impiante	15.186.999

[25] Nga kjo sasi rreth 120 milion/m³ në vit prodhohen me rrjedhje të lirë dhe 157 milion/m³ në vit prodhohen me ngritje mekanike.

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve	5.604.831

Pavarësisht rritjes në nivelin e investimeve, dy nga treguesit e performancës së sektorit që prekin drejtpërsëdrejti qytetarët dhe shoqëritë aksionerë të UK vazhdojnë mbeten në nivele të ulëta:

- Humbjet vazhdojnë të larta: 67 %
- Kohëzgjatja e furnizimit me ujë konsiderohet e ulët: 12 orë/ditë

Nga një analizë e detajuar e sektorit rezulton se shkaqet e nivelit të ulët të performancës së sektorit të ujit janë:

- Niveli i ulët i matjes (matja e prodhimit 36% dhe shitjes 61%);
- Amortizimi i rrjetit;
- Lidhjet e paligjshme;
- Mos faturimi i të gjithë klientëve të identifikuar, që marrin ujë nga rrjeti i ujësjellësit;
- Mos-zbatimi i normativës së konsumit, në mungesë të matësit;
- Humbjet e lejuara të projektimit;
- Natyra e sistemit të pompimit;
- Mungesa e kapaciteteve të duhura menaxhuese. Vlerësohet se më shumë se gjysma e humbjeve vjen si pasojë e keqmenaxhimit.

❖ Reforma e Sektorit

Duke analizuar problematikën e sektorit, si dhe shkaqet e humbjeve, reforma e propozuar mbështetet në dy shtylla kryesore:

- Investime publike;
- Përmirësim rrënjësor i menaxhimit të shoqërive aksionere të ujësjellës kanalizimeve, duke standardizuar parimet e qeverisjes së sektorit.

Reformimi i bazuar në shtyllat e mësipërme, kërkon ndërmarrjen e ndryshimeve përkatëse ligjore dhe institucionale të nevojshme për përmirësimin e sistemit aktual. Konkretisht, hapat e ndërmarra deri tani kanë sjellë:

- Ndarje të qartë kompetencash dhe përgjegjësish për secilin aktor në nivel qendror dhe lokal ku kryetari i njësisë së qeverisjes vendore është përgjegjës i drejtpërdrejtë për ofrimin e shërbimit. Kjo është siguruar nëpërmjet parashikimeve të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe me anë të VKM nr. 63, datë 27.01.2017 "Për riorganizimin e operatorëve, që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura".
- Riorganizimi i shërbimit të ujësjellës kanalizimeve në përputhje me Reformën administrative territoriale.
- Standardizimi i mënyrës së organizmit dhe operimit të shoqërive aksionere të UK. Këto shoqëri organizohen si shoqëri aksionere, me një shkallë administrimi, si dhe unifikohet dhënia e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe i kanalizimeve, unifikohet zona e juridiksionit me zonën e shërbimit.
- Qasje e re në parashikimin dhe ndarjen e investimeve:
    - Masteplani Kombëtar mundëson, përdorimin e tij si instrument për planifikimin e investimeve, duke u mbështetur në një matricë prioritizimi të qartë.
    - Investimet do të planifikohen dhe shpërndahen edhe në bazë të performancës individuale të sh.a. të UK. Secila sh.a. të ujësjellës kanalizime, që përmbush objektivat e dakortësuar në kontratën e performancës, do të konkurojë për të përfituar nga granti i performancës, i cili ka një formulë të qartë të shpërndarjes së fondeve.
- Qasje e re ndaj mënyrës së subvencionimit të shtresave në nevojë. Subvencionimi i shtresave në nevojë do të ndihmojë shoqëritë për arkëtimin e faturave, të cilat më parë ishin të pamundura për shkak të paaftësisë paguese, por dhe do të heqë çdo justifikim për mospërshirjen si abonentë të çdo familje brenda zonës së juridiksionit/shërbimit.
- Gjithashtu, do të subvencionohet diferenca e kostos, vetëm për ato shoqëri, të cilat edhe pse arrijnë maksimumin e performancës, për shkak të natyrës së sistemit apo shkaqeve të tjera objektive, e kanë të pamundur mbulimin e kësaj kostoje.
- Futja e konceptit të menaxhimit nëpërmjet arritjes së objektivave;

Kontratë performance në dy nivele:
- Midis qeverisjes qendrore dhe qeverisjes lokale;
- Midis kryetarit të bashkisë dhe drejtorit të sh.a. UK.

Kontratat do të negociohen me secilën shoqëri UK dhe stafet respektivë do të shqyrtojnë situatën aktuale teknike - financiare të shoqërisë UK, si dhe do të vendosin objektivat për vitin pasardhës dhe vitet në vazhdim, në përputhje me biznes-planet.

- Aplikimi i instrumentave të unifikuara dhe standardizuara për mirëmenaxhimin e shërbimit.
- Parashikimi i mundësisë së marrjes së administrimit në mënyrë të përkohshme, në rast mosperformimi.
- Rregulla teknike të unifikuara për projektimin dhe ndërtimin e të gjithë ujësjellësave, pavarësisht mënyrës së financimit.
- Është krijuar Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve (AKUK) e organizuar në drejtori rajonale e cila, do të koordinojë dhe mbikqyrë sigurimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime, si dhe mbarëvajtjen e shoqërive, në mënyrë që të sigurohet ofrimi i shërbimit sipas standardeve optimale.
- Koordinim i stafeve për identifikimin dhe marrjen e masave konkrete për lidhjet e paligjshme.
- Koordinim i stafeve për marrjen e masave për rritjen e arkëtimeve, duke organizuar një qendrim të bashkërenduar publik mbi nevojën për pagimin shërbimit të furnizimit me ujë, si çdo shërbim dhe mall tjetër si dhe respektimin e ligjit, që parashikon se faturat e ujit janë tituj ekzekutiv.

❖ Financimi i Reformës

Në Projekt-buxhetin e vitit 2017, si dhe në projeksionet e tavaneve buxhetor për vitet 2018-2019, në mbështetje të Reformës së Ujit janë parashikuar:

- Subvencion për ndërmarrjet e UK në shumën 1.000.000.000 Lek/vit për vitet 2017-2019.
- Mbështetje për zbatimin e reformës për Sha UK (investime publike) në shumën 144.609.000 Lek për vitin 2017.
- Investime në bazë performance për shoqëritë UK sipas Bashkive në shumën 441.240.000 Lek për vitin 2018 dhe 689.922.000 Lek për vitin 2019.

REFORMA NË DREJTËSI

Në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit është ndërmarrë iniciativa për të reformuar sistemin e drejtësisë nëpërmjet miratimit të një paketë ligjore, e cila synon një reformim tërësor, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt parimeve europiane për një gjyqësor të paanshëm.

❖ Problematikat e Sistemit Aktual të Drejtësisë

Problematikat e hasura në Sistemin e Drejtësisë përgjatë 25 viteve të fundit i atribuohen ndërveprimit të një sërë faktorësh ku më përcaktuesit identifikohen si më poshtë:

